

LEDHATIMI I ARIUT	5
A MOS I KEMI HARRUAR?!	6
INTEGRIMI I MUSLIMANËVE NË BE	7
KUSH PO MANIPULON TË DREJTAT E NJERIUT	10
TRYEZË E RRUMBULLAKËT ME RASTIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	13
NËN HIJEN E SHTËPISË SË SHENJTË	14
TRI PËRMBAJTJET THELBËSORE TË KURBAN BAJRAMIT	17
MORALI ISLAM - BAZAT DHE VEÇORITË E TIJ	20
OBJEKTIVAT E SHERIATIT ISLAM (2)	24
PYETJE DHE PËRGJIGJE (10)	26
PREJ ERRËSIRËS NË DRITË	28
KUR'ANI BURIM I UDHËZIMIT	30
SFIDAT NË RRUGË	33
AHMEDITË DHE QËLLIMET E TYRE	34
PERSONALITETE - EBU ALA EL MEVDUDI	38
EUTANAZIA - VDEKJA E MËSHIRSHME	41
LAJME KOMPJUTERIKE	44
RISI SHKENCORE	46
NGA BOTA	48
POEZI	50



INTEGRIMI I MUSLIMANËVE NË BE



KUSH PO MANIPULON TË DREJTAT E NJERIUT



NËN HIJEN E SHTËPISË SË SHENJTË

Boton: Shoqëria për veprimtari botuese "Furkan ISM"

Drejtor & Kryeredaktor: Muhamed MURTEZI, muhamed@furkan.com.mk

Këshilli redaktues: redaksia@furkan.com.mk

Zija ABDIU, Bashkim ALIU, Agim ABAZI, Rufat SHERIFI, Jusuf SALIU,
Sali SHASIVARI, Hasan BAFTIJARI, Fevzi MUSLIU

Web master: Zija ABDIU, webmaster@furkan.com.mk

Redaktor teknik: Jusuf SALIU

Shtypi: Print ISM - Shkup

Fotografite dhe dorëshkrimet nuk kthehen

Sipas mendimit të Ministrisë së Kulturës nr. 07-5055/2 të datës 17.09.1998 për revistën VEPRÀ bëhet pagesë e lehtësuar tatimore

Llogaria rrjedhëse: 300000000516464 - Numri tatimor: 4030995149134

Deponent: "Banka Komerciale" SHA Shkup

VEPRA

<http://www.furkan.com.mk/vepra>

e-mail: furkan@furkan.com.mk

furkanism@mt.net.mk

furkan@mol.com.mk

Adresa:

"II Makedonska Brigada" lok.22 - 1000 SHKUP

Tel/Fax (02) 2622 393; 2622 360

**“VEPRA E NJË PERSONI NË MESIN E NJËMIJË NJERËZVE KA MË TEPËR
NDIKIM SE FJALËT E NJËMIJË NJERËZVE DREJTUAR NJË PERSONI”**

Hasan EI-BASRIU



VEPRA

Po e lëmë pas vetes edhe një vit plot ngjarje nga më të ndryshmet. Për jo pak njerëz ishte ky një vit ankti; për disa të tjerë madje edhe vit tmerri; sigurisht ka edhe të atillë që e kujtojnë për të mirë; ndoshta më të shumtë janë ata që e jetuan dhe përcollën me shpresë. Me shpresë për një jetë më të mirë dhe më dinjitoze, për një kafshatë bukë më tepër, për më pak lotë e më shumë gëzime, për më pak dhunë e më shumë të drejta.

Vit i shpresës ishte ky edhe për Maqedoninë dhe Kosovën.

Maqedonia, për të fituar datën e bisedimeve për hyrje në Bashkimin Evropian. Kosova, për të shumë priturën pavarësi.

Për Maqedoninë shpresa u kthye në dëshpërim, pritjet pompoze në zhgënjim, premtimet megalomane në dështim. Asgjë nga pritjet e qeveritarëve se një datë për bisedime do të vijë deri në fund të 2007. Kjo mbetet çështje e përcjellë në vitin e ardhshëm, edhe një vit ky i shpresës. A mund të ndodh që edhe ky vit të jetë vit i një shprese të rrejshme? Sigurisht që po. Posaçërisht nëse vazhdon kjo politikë dështuese dhe kokëfortësi tipike ballkanase e politikanëve tanë. Nëse shumë shpejt nuk etablohet një dialog i mirëfilltë politik, nëse reformat gjyqësore e administrative nuk shkojnë deri në fund, nëse nuk ndërpritet loja me zjarr në raportet ndëretnike, nëse qasja ndaj fjalës së dhënë dhe premtimeve të bëra nuk marrin kuptimin e vërtetë që duhet të kenë, nëse politikanët tanë nuk këndellen dhe vërejtjet që u jepen nga liderët evropianë nuk i marrin për shaka apo si lojëra fëmijësh...

Përndryshe, do të mbetet edhe viti në të cilin po hyjmë vetëm një vit i shpresës së kotë, kurse integrimet evro-atlantike ëndërr e porealizuar e shndërruar në ankth.

Ndërsa kur jemi te Kosova, punët duken sikur ecin kah fundi i vet, gjegjësisht realizimi i shpresës që mbajti gjallë popullin e saj, pavarësisë së shumëpritur. Kjo shpresë që bëri të harrohet ekonomia e shkatërruar, korrupsioni marramendës, gjendja katastrofale me energji elektrike...

Tani kur përfunduan edhe 120 ditët shtesë të bisedimeve shqiptaro-serbe, me rezultatin dështues për të cilin edhe ashtu të gjithë kanë qenë të vetëdijshëm, si dhe kur u kryen në mënyrën më të qetë dhe demokratike të mundshme edhe zgjedhjet parlamentare edhe ato në nivel lokal, kosovarët me plot të drejtë presin që durimi i tyre shumë dekadash të kurorëzohet me mundësinë e qeverisjes së vetvetes dhe marrjes së fatit të shtetit të tyre në duart e veta. Shpresa e tyre e madhe është se komuniteti ndërkombëtar kësaj radhe nuk do të bie nën ndikimin e pazarllëqeve politike dhe nuk do të tradhtojë sërish popullin shqiptar si në të kaluarën.

Sido që të jetë, konstituimi i Parlamentit dhe formimi i qeverisë mbeten puna e parë që duhet kryer. E pastaj edhe shpallja e pavarësisë. Ndonëse në koordinim me ata për të cilët kemi nevojë, pa shumë vonesë e zvarritje do të ishte më mirë.

Dashtë Zoti që shpresat e vitit të cilin po e përcjellim të bëhen realitet në këtë që po vjen.

LEDHATIMI I ARIUT

Data 10 dhjetor shënoi fundin e negociatave shtesë për statusin e Kosovës, po edhe fillimin e një koordinimi më serioz të qëndrimit të shteteve të Bashkimit Evropian për të ardhmen e saj. Ç'është e vërteta, negociatat shtesë edhe janë organizuar për të blerë kohë pikërisht Bashkimi Evropian, sepse pas dorëzimit të planit të Marti Ahtisarit dhe rekomadimit të tij për një pavarësi të mbikëqyruar për Kosovën, në këtë organizatë pati mospajtime të dukshme. Zhurmën më të madhe e bënë disa shtete të pranuar rishtas në Bashkimin Evropian, si Qiproja, Rumania e Sllovakia, duke treguar sheshazi se ato vetë nuk kanë qenë të përgatitura për të marrë përgjegjësi serioze në një kontekst evropian. Mirëpo, diversionin më të madh u përpoq të luante Rusia, e cila me çështjen e Kosovës bëri përpjekje të mëdha që ta përçante Bashkimin Evropian, ta rikthente Ballkanin në një skenë jostabiliteti e konflikti, për ta mbajtur pastaj të gozhuar NATO-n në këto hapësira. Në tërë këtë lojë gjeopolitike ruse, Serbia u përdor dhe po përdoret ende, si një figurë shahu, e cila në një moment edhe mund të sakrifkohet për një pozicion më të mirë taktik. Serbia e ka pranuar dhe po e luan edhe më tutje këtë rol, ngase ideologjia mbizotëruese në atë vend është nacionalizmi irracional, i cili në rastin serb e ka një shtresë të theksuar antiperëndimore.

Edhe pse në këtë kontekst mjaft të komplikuar, takimi i 10 dhjetorit i ministrave të jashtëm të shteteve të Bashkimit Evropian konfirmoi se kjo organizatë tashmë pothuajse e ka miratuar një qëndrim unik lidhur me pranimin e pavarësisë së Kosovës sipas planit të Marti Ahtisarit. Ka mbetur vetëm Qiproja që ta luajë edhe pak rolin e një kali të Trojës. Por mundësia e Qipros për ta penguar unitetin evropian vërtet është e papërfillshme.

Megjithatë, si edhe më herët, tash kanë dalë disa pengesa në formën e detajeve, të cilat ka rrezik të shndërrohen në shtyrje të afatit të shpalljes së pavarësisë së koordinuar të Kosovës. Në këto detaje bie edhe mbajtja e zgjedhjeve presidenciale në Serbi, që sipas gjasave do të mbahen gjatë janarit të vitit të ardhshëm (me mundësi që të barten edhe në shkurt, në rast të balotazhit.) Nëse është e vërtete ajo që thonë mediat, se ministri i jashtëm francez, Bernar Kushner,



Milazim KRASNIQI

ka propozuar që të priten edhe ato zgjedhje në Serbi para se të pranohet pavarësia e Kosovës, kjo do të thotë edhe një komplikim i ri i situatës. Procesi negociator ka pasur në zhagjitje disamujore për shkak të zgjedhjeve parlamentare në Serbi, gjë që u tregua krejt e panevojshme, sepse në procesin e riaktivizuar negociator, e ashtuquajtura “qeveri demokratike” e Serbisë, të cilën Bashkimi Evropian e kishte ëndërruar si kalë gare, mbeti e lidhur me mijëra fije me Rusinë. Akuzat e Vojislav Koshtunicës, kreut të qeverisë serbe që doli nga ato zgjedhje, nuk kanë ndonjë dallim thelbësor nga akuzat që lëshon drejt Perëndimit Vojislav Shesheli dhe fashistët e tjerë të sërës së tij. Prandaj, kurrfarë shtyrjesh nuk do të ndihmojnë që Serbia të bëhet demokratike dhe kooperuese me Perëndimin. Përkundrazi, nëse i jepet ky favor i pamerituar Serbisë, gjasat më të mëdha janë që në zgjedhjet presidenciale të janarit 2008 të fitojë eksponenti i radikalëve serbë. Në atë rast Bashkimi Evropian do t’ia lidhte vetes duart, sepse monstrumi fashist në krye të shtetit serb do të ishte legjitim. Atëherë do të mund të kishte komplikime shumë më të mëdha, ngase një kryetar i mundshëm fashist në krye të Serbisë do të vepronte në mënyrë radikale për destabilizimin e Kosovës dhe të rajonit. Prandaj, për rajonin dhe për Evropën shumë më mirë është që në krye të Serbisë, nëse kjo është e pashmangshme, të vjen një kryetar fashist pasi që Kosova të jetë pavarësuar, e jo para pavarësisë së saj. Ndërsa rreziku që Serbia ta ketë fatkeqësinë që të udhëhiqet nga fashistët është real, ngase në zgjedhjet e fundit parlamentare radikalët e Sheshelit kanë dalë partia më e madhe në Serbi. Ndërsa Bashkimi Evropian duhet të mësohet të jetojë më këtë realitet, e të mos përshejtojë pranimin e këtij shteti problematik në gjirin e vet. Ledhatimi i ariut, sado i vogël e ulok që të jetë, nuk është një punë e urtë. Para se t’i hiqen të gjithë dhëmbët. Prandaj Bashkimi Evropian tashmë duhet të ndjekë një agjendë më dinamike, të bazuar në unitetin e arritur në takimin e 10 dhjetorit, e të mos hezitohet sërish, sepse hezitimi mund të sjellë komplikime të reja. Fjala vjen, pritja për zgjedhjet presidenciale në Rusi në mars të vitit 2008. Me këso logjike, zyrtarizimi i statusit të Kosovës mund të shtyhet deri sa të mbahen edhe zgjedhjet “demokratike” në Kinë. Ndoshta edhe në Kubë!

A MOS I KEMI HARRUAR?!?

Autobusi kishte edhe ca minuta për t'u nisur. "A është kjo ulëse e lirë?" - mu drejtua një zë i thellë gruaje. "Po" - iu përgjigja. Ishte një plakë e mbajtur, me një shami të bardhë të lidhur mbrapa, rrudhat i flisnin shumë në fytyrën e saj të ëmbël. Sytë e përbotur i fshihnin dhimbjen që kishte kaluar...

Isha duke lexuar një libër sa për të thyer monotoninë. Vëreja kërksherinë e saj dhe nevojën për t'i folur dikujt. E mbylla librin dhe me zë të ulët e pyeta se ku shkonte. "Ehh!... mori frymë thellë. Do të shkoj të vizitoj djalin në spital, ka pësuar një aksident. Mjekët kanë përmendur se më ka lindur për së dyti". "Mirë që e paska ruajtur Zoti" - i thashë unë. "Po elhamdulillah, mirë që nuk më shkoi edhe ky. Në luftë ma rrëmbyen djalin nga duart, mendja nuk del nga sprovat", vazhdoi plaka. "Pak hapa para nesh bombardohet konvoji i njerëzve në kolonë nga NATO -ja". I mbylli sytë, sikur iu përfytyrua e tërë ngjarja dhe prapë me një frymëmarrje të thellë vazhdoi. "Njëzet e shtatë anëtarëve të familjes së burrit u kam mbledhur me këto duar tërë pjesët e shkapërderdhura dhe i kam varrosur krejt me duart e mia. Të gjitha këto i kam përjetuar, po mendtë kishin rrënjë. Para kësaj kam pritë në shtëpinë time mjaft njerëz të fshatrave të ndryshme. Iu kam gatuar bukë, larë rrobot ushtarëve të lirisë, iu kam dërguar ushqim deri afër që të mos rrezikohet jeta e tyre. Tani kam dëshirë t'i takojë të gjithë" - flet e mallëngjyer. "I kam shikuar si djemtë e mi... Ehh!...", u mbush frymë dhe sytë e tradhtuan, filloi të lotonte. "Tani - belbëzoi ajo - tani kam nipin jetim. Kur i mbushi 2 vjet i vdiq edhe e ëma. E kam rritur me lot, zemra më qan për të, sa krejt dhimbja më peshon ky djalë. Nuk janë bërë ende dy vjet kur m'i kthyen eshtrat e djalit, edhe një provë tjetër. Po mirë, prapë mbasi ia di varrin - ngushëllohej ajo. Nipi nuk ishte në dijeni deri atëherë, përveç thashethemeve që ka rastisë t'i dëgjojë. Shfrytëzova rastin edhe e ula pranë. Shpirti i nënës, e di pse qan gjyshja?" "Gjyshja?!" - pyet djali i habitur. Deri vonë ishte mësuar të dëgjonte fjalën nënë. Djali i

Burbuqe REXHA

shtangur priste se çka do t'i thuhej. "Babanë ta kanë rrëmbyer gjatë luftës, tani ia sollën eshtrat", mezi i nxjerrja fjalët nga goja. "E nëna të ka vdekur kur ti i kishe dy vjet. Të kujtohet ai varri që shkonin shpesh dhe i linim lule? Është varri i nënës tënde që të ka lindur e rritur, deri sa i mbushe dy vjet" - fliste plaka. "E unë jam gjyshja jote". Zemra sa nuk më çahet nga dhimbja, më pikonte helm, tani edhe më shumë për jetimin.

U mundova ta ngushëlloja gruan plakë, por lotët nuk më linin të flisja edhe gjatë. Mblodha forcat dhe i tregova për gjyshen time që ishte sprovuar me humbjen e djalit në luftë, të cilin nuk e kishte parë 14 vite më parë, e veç një kohë të shkurtër i bie të rrijë me të. Ajo është shembulli më i mirë i durimit. "Të All-llahut jemi dhe tek All-llahu do te kthehem", ishin fjalët që përmbyllnin dhimbjen e saj...

Ishte një udhëtim i përbotur, më bëri të kujtoj shumëçka.

A mos i harruam njerëzit që më së shumti i dhuruan Kosovës?! A mos kemi harruar se çka përjetuam!?

A mos i kemi harruar jetimët e mbetur?! A mos harruam t'iu falim një buzëqeshje, një përkëdhelje kokës së tyre, një copëz bukë të ngrohtë, një kulm mbi kokë...



INTEGRIMI I MUSLIMANËVE NË BE

- qasje gjenerale -

PROLOG

Zhvillimi i paparë deri më tani i mjeteve të komunikimit, ashtu që botën e shndërruan, siç thuhet, në “fshat të vogël” apo “fshat global”, dhe ndërthurja e interesave të njerëzve, dinamika e jetës, lëvizjet gjithnjë e më të mëdha të njerëzve dhe vendosja e tyre në vende të ndryshme, i thyen paradigmat e shoqërive të izoluar dhe mbylljes së njeriut në lëvoren e tij si formë mbrojtëse nga ndikimet e jashtme. Së këndejmi, sot kemi shoqëri multikulturore dhe multinacionale, e jo shoqëri homogjene në kuptim të përkatësisë nacionale dhe fetare. Për këtë, që të mund të kemi një rrjedhë normale të proceseve shoqërore dhe zhvillimeve të gjithmbarshme ekonomike, politike, kulturore, sociale etj., lypset pasur një qëndrim integrist e jo izolues ndaj shoqërisë, unifikues e jo shpërndarës dhe pozitiv normalizues e jo negativ frustrues ndaj komuniteteve të ndryshme nacionale dhe kulturore që e ndërtojnë shoqërinë përkatëse. Do të thotë, komunikimi, mirëkuptimi dhe sinqeriteti janë elemente që duhet instaluar në mendësinë e njeriut të kohës së sotme. Përndryshe, si do të shprehet edhe mendimtari i shquar gjerman Jyrgen Habermas, nga mos komunikimi, keqkuptimi dhe moskuptimi, lindin konflikte. “Spiralja e dhunës fillon me një spirale të komunikimit të çoroditur, e cila përmes spirales së mosbesimit të papërmbajtur e të ndërsjellë çon në ndërprerjen e komunikimit”.¹ Kjo na jep të drejtë të konstatojmë se integrimi është i pashmangshëm për një jetë solide shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Pra, asnjë shoqëri apo shtet nuk mund të llogarisë për një zhvillim gjithëpërfshirës nëse ua kthen shpinën procese integruese, përcaktimit integrues dhe vënies së integritimit për qëllim të vet strategjik.



Mr. Bashkim ALIU

Trendet aktuale botërore flasin qartë se integrimi paraqet realitet të pamohueshëm dhe përcaktim parimor e prioritet të shoqërive bashkëkohore dhe filozofisë politike të qarqeve vendimarrëse, si në planin kombëtar po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Politika globale ecë shtigjeve të promovimit të vlerave dhe forcave me orientime prointegrative dhe marginalizimit të elementeve me orientime dezintegruese dhe frymë izolacioniste.

Në këtë prizëm duhet shikuar edhe integrimin e muslimanëve në shoqëritë ku jetojnë, në veçanti në kontinentin e Evropës, gjegjësisht në vendet e Bashkimit Evropian, marrë parasysh prezencën e tyre të konsiderueshme në këto vende dhe ndikimin gjithnjë e më të theksuar të vendeve të BE-së në arenën ndërkombëtare, si në planin ekonomik, po ashtu edhe në atë politik, social, kulturor etj.

Nocioni integrim

Përkitazi me nocionin “integrim” apo “integrim evropian” nuk është dhënë ndonjë definicion i caktuar unik, por definicionet e njohësve të kësaj lëmie kanë ndryshuar varësisht prej lëmisë në të cilën diskutohet çështja e integritimit, gjegjësisht a bëhet fjalë për integrim ekonomik, politik, kulturor etj.

Për këtë, në vazhdim do të mundohemi ta përfrojmë këtë nocion, për ta kuptuar më mirë edhe çështjen e integritimit të muslimanëve.

Në fjalorin e Gjuhës së sotme shqipe, folja “integroj” është sqaruar si vijon: “Lidh pjesët ose anët e diçkaje në një të tërë si pjesë përbërëse e të pandarë të saj”.²

Nisur nga kompleksiviteti i definimit të nocionit “integrim” apo “integrim evropian”, mund të thuhet se, shikuar në përgjithësi, bazament i



integritit është krijimi i lidhjeve më të ngushta kulturore, ekonomike dhe politike në mes shteteve, gjegjësisht “Integrimi Evropian” është “nacioni i cili nënkupton ndërtim të unitetit në mes shteteve dhe popujve evropian. Në BE ky nocion është shprehje e bashkimit të resurseve nacionale të shteteve dhe marrje e një varg vendimeve në mënyrë kolektive”³

Sipas Michael Hodges, integrimi është “krijim i sistemeve të reja politike nga ato sisteme që deri tani kanë qenë të ndara”.⁴

Sipas Blerim Rekës, ekspert i së drejtës evropiane, me nocionin integrim rajonal nënkuptohet lidhja e dy a më shumë shteteve të një rajoni të caktuar në një formë institucionale.⁵

Integrimi i muslimanëve

Pas asaj që përmendëm për nocionin “integrim”, mund të konstatojmë se edhe për integrimin e muslimanëve nuk ka ndonjë definicion përmbledhës të caktuar, por si zakonisht përmes definicioneve përkitazi me nocionin “integrim” përsëritet procesi i integritit duke u nënvizuar disa veçori kryesore të tij.

Kështu, integrimi i muslimanëve në BE nënkupton inkuadrimit aktiv të muslimanëve në jetën shoqërore, politike, ekonomike etj., si në dhe institucionet evropiane, duke i konsideruar këto institucione të tyre dhe si të tilla duhet të mirëmbahen dhe zhvillohen në frymën e multikulturalizmit.

Në këtë mënyrë ata do të tregojnë se i takojnë asaj shoqërie dhe ajo u takon atyre, dhe se ata nuk kanë vend tjetër ku do të jetojnë dhe do të kontribuojnë

aktivisht. Ata nuk do të izoloohen prej shoqërisë dhe nuk do të jenë larg rrjedhave shoqërore, nuk do të jenë të mbyllur në kornizat e të drejtave dhe veprimtarisë fetare, por do të lënë gjurmë në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë evropiane.⁶ Thënë shkurt, integrimi i muslimanëve aludon në përpjekjet e muslimanëve për të ndikuar në segmente të ndryshme të realitetit evropian, duke vënë theks në atë që është e lidhur për ata si bashkësi fetare, gjegjësisht realizimin e të drejtave dhe lirive të tyre kulturore.⁷

Çështja e integritit të muslimanëve në BE nuk është pyetje e vullnetit të mirë, por detyrë nga realizimi i së cilës varet ajo se muslimanët evropianë a do të jenë subjekt aktiv në rrjedhat e Unionit. Integrimi është proces i cili rrjedh dhe varet shumë nga muslimanët si komunitet se a do të arrijnë të inkuadrohen aktivisht në rrjedhat integruese dhe të kenë rol të dukshëm në institucionet e Unionit.

Islami nuk është pengesë për integrimin e muslimanëve në BE, por në frymë të pasimeve dhe natyrës së tij është ndërtuar korniza integruese dhe orientimi integrues i muslimanëve, që në thelb nënkupton rolin aktiv të muslimanëve në të gjitha segmentet e jetës.

Në këtë drejtim, funksion fundamental ka koncipimi i BE jo vetëm si Union i shteteve, por edhe i qytetarëve. Po ashtu, nënvizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, me theks të veçantë të drejtat e pakicave kulturore, hap horizonte të gjëra të integritit të komuniteteve të ndryshme kulturore. Së këndejmi, zhvillimi i të drejtave të njeriut dhe proceseve demokratike në vendet e BE-së, nga

njëra anë, dhe Islami me kornizën e tij ideore për qëndrimin ndaj të ndryshmit dhe dialogun me tjerët, nga ana tjetër, ndikojnë dukshëm dhe kënaqshëm në integrimin e muslimanëve në BE. Krahas postulateve parimore integriste të konceptit Islam mbi besimtarin dhe raportit të tij me komunitetet tjera, e qëndrimit të tij pozitiv ndaj të ndryshmit dhe tjetrit, orientime konkrete integriste mund të eksploatojmë edhe nga historia e muslimanëve të Ballkanit.

Kështu, shteti osman ka qenë një shembull i rëndësishëm i integritit të tjerëve në shoqërinë islame, që flet qartë se mbështetet nga koncepti integrist i kësaj feje, si për tjerët në shoqërinë islame, ashtu edhe për muslimanët në shoqëritë tjera, duke i pasur parasysh çdo herë parimet bazë të botëkuptimit islam për besimin dhe jetën. Kështu, në shtetin osman, “secila nga bashkësitë fetare... gëzonte të drejtën që të ushtronte besimin e saj. Akoma më e veçantë ishte e drejta që bashkësitë kishin për të pasur institucionet e tyre përfaqësuese, të drejtuara nga udhëheqësit e tyre fetarë, të cilët organizonin shkollimin dhe jetën shoqërore, sipas traditave, duke zbatuar ligjet e tyre, me kushtin që ato të mos binin në kundërshtim me ligjet bazë të perandorisë. Sigurisht, muslimanët kontrollonin fuqinë politike dhe atë ushtarake, por dhe jomuslimanët kishin nën kontroll një pjesë të mirë të ekonomisë, çka bënte që jo rrallë edhe ata të luanin një rol jo të vogël në jetën politike të Perandorisë Otomane”.⁸

Një shembull që mund të përdoret në këtë kontekst është edhe angazhimi i mbretit Zog në Shqipëri ndërmjet dy luftërave botërore, që të riformatohej roli dhe funksioni i bashkësive fetare në Shqipëri. Kështu, “ndër detyrat kryesore në të cilat angazhohej bashkësia muslimane në bazë të statuteve ishin, çka vlen të theksohet, ato të inkurajimit të muslimanëve për t’iu konformuar qytetërimit modern dhe të ndihmesës për të zhvilluar vëllazërimin kombëtar ndërmjet shqiptarëve të çdo besimi”.⁹

Ndërmjet integritit dhe shkrirjes

Për mos të mbetur borxh në këtë qasje të përgjithësuar koncize rreth problemit të integritit të muslimanëve në BE, duhet shënuar edhe një çështje që kërkon qasje dhe trajtim shumë më të zgjeruar dhe më analitik se sa kaq, gjegjësisht dallimit ndërmjet integritit dhe shkrirjes.

Kur flas për integrimin e muslimanëve, synoj komunitetin musliman me veçoritë e tyre

kulturore dhe thesarin madhor fetar, gjegjësisht bëj identifikimin e tyre me identitetin fetar, që nënkupton se nuk vjen në shprehje heqja dorë nga ndonjë parim bazë të pandryshueshëm në favor të integritit.

Integrimi nuk është shkrirje, sepse shkrirja nënkupton humbjen e identitetit, ndërkaq integrimi nënkupton luftën për identitet dhe ideale. Për këtë, kur flasim për integrimin e muslimanëve, kemi për qëllim kyçjen e tyre në rrjedhat shoqërore duke u mbajtur për parimet e tyre fetare, e jo duke i lënë apo shkelur mbi to.

Nisur nga ndarja e dispozitave në të drejtën islame, gjegjësisht dispozita unanime të prera dhe diskutabile jo të prera, mund të flasim për diskutim rreth ndonjë dispozite në frymë të burimeve fetare që i takon fushës së dytë, ndërkaq parimet bazë janë të paprekshme.

LITERATURA E KONSULTUAR:

БОЈЧЕВ, Душан. (2007). *Европска Унија Лексикон*. Скопје: МИ-АН.

REKA, Blerim dhe IBRAHIMI, Arta. (2004). *Studime evropiane*. Tetrovë: Universiteti i EJL.

HABERMAS, Jurgen. (2006). *Perëndimi i përçarë*. Shkup: Asdreni.

HODGES, Michael. (ed) (1972). *‘Introduction’, in European Integration*. London: Penguin.

LEWIS, Bernard. (2004). *Ku është gabuar? Islami, Perëndimi dhe Moderniteti*. Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit.

ROKA, Roberto Moroco dela. (1994). *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*. Tiranë: Elena Gjika.

SHAKER, Hosam. (2007). *Muslims of Europe and their Political Participation*. Brussels: European Council for Fatwa and Research.

Fusnota:

1 Jurgen Habermas, *Perëndimi i përçarë*, f. 23-24.

2 *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, f. 724.

3 Душан Бојчев, *Европска Унија Лексикон*, стр. 79.

4 Michael Hodges, ‘Introduction’, in *European Integration*, p. 13.

5 Blerim Reka & Arta Ibrahim, *Studime Evropiane*, f. 41.

6 Hosam Shaker, *Muslims of Europe and their Political Participation*, 17-18.

7 *Ibid.*, p. 222.

8 Bernard Lewis, *Ku është gabuar? Islami, Perëndimi dhe moderniteti*, f. 60

9 Roberto Moroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, f. 33.

KUSH PO MANIPULON TË DREJTAT E NJERIUT

Jeta e njeriut dhe e drejta e tij për të jetuar i lirë në rrethin ku

gjendet është çmuar nga çdo sistem juridik botëror. Kjo liri është një shenjtëri e njeriut dhe nëse humbet apo ndotet shenjtëria e këtij ndërtuesi të familjes dhe shoqërisë atëherë e kemi mbytur dhe humbur gjithë bashkësinë njerëzore. Duke u nisur nga ajo se individit e formon shoqërinë dhe shoqëria bashkësinë, popullin e kështu me radhë, në një vend ku jetojnë krijesat njerëzore, pa dyshim se do të ketë edhe besime dhe fë të ndryshme. Por, për fat të keq, nga mesi i këtyre njerëzve del dikush që këto ide të besimeve njerëzore dëshiron t'i pengojë apo asgjësojë. Nuk ekziston asnjë gjykatë botërore që do të mund ta gjykonte një individ se pse ai beson në diçka apo pse nuk beson fare. Nuk ka asnjë normë juridike e cila e kufizon apo pengon individin në veshjen dhe pëlqimin e veshjes së rrobave në jetën e lirë vetëm pse dëshiron të plotësojë kushtin e fesë që i beson.

Kur ndalemi dhe flasim apo i bëjmë një vështrim zhvillimit të teknologjisë dhe ndërtimit të botës, shohim se shumica njerëzve apo gati të gjithë janë lënë të lirë në punët e tyre. P.sh. mjekët, mësuesit, gazetarët, futbollistët, regjisorët, gjuetarët etj. Këta, kur nisen për të shkuar në punët e tyre, askush nuk del t'ua ndal rrugën e t'i thotë: *“Nдалu! Nuk lejohet që me këtë veshje të shkosh në punë. Po e ndërrove këtë veshje, mund të vazhdosh punën, në të kundërtën je i larguar nga ky institut”*. Këtë as që ka të drejtë t'ua bëjë dikush sepse kjo është e drejt personale e secilit.

Për krijesën njeri janë mbushur bibliotekat me vëllime librash, sepse njeriu është më i mençuri

Zymer RAMADANI

dhe më i përsosuri në sipërfaqen e tokës. Andaj morali dhe sjellja

e mirë i takon vetëm njeriut. Një gjë e tillë nuk kërkohet tek gjallesat tjera. Asnjë shkencëtar, sociolog, filozof, psikolog etj. nuk ka pretenduar se në këtë botë gjendet ndonjë krijesë më e përsosur dhe moralshme se njeriu. Në anën tjetër, kur i kthehemi anës religjioze, shohim se edhe të këta si qendër kryesore është njeriu me virtyte të larta. All-llahu i Madhërishëm atë e ka krijuar në mënyrën më të përsosur dhe më të bukur që mund t'i përshtatet natyrshmërisë së njeriut:

“Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur”.¹ Pejgamberët e All-llahut, qysh nga Ademi [alejhisselam] gjer tek Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem], janë munduar që ta përsosin moralin e njeriut. Pasi që njeriu është predikues, zëvendës (halife) i shpalljes së All-llahut², ai është nderuar dhe çmuar më shumë se çdo krijesë tjetër që ekziston. Shihet se njeriu e ka nën pushtet çdo gjallesë tjetër sepse këtë ia ka mundësuar All-llahu dhe kjo është një nderë dhe shpërblim i madh për të. All-llahu thotë:

“Më të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit,



atyre u mundësua të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam me ushqime të mira, i vlerësuaam ata (i lartësuaam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.³

Por edhe me gjithë këtë, sot edhe pse bëhen luftëra vetëm për lirinë dhe të drejtat e njeriut, prapëseprapë dikush është duke manipuluar me jetën e kësaj krijese të ndershme. Këtë moral, në vend se ta ndihmojnë që të qëndrojnë në këmbë, janë duke e pesimizuar shoqërinë, rininë e sidomos femrën tonë dhe virtytet që ajo ka.

Në shtetet e vogla, sikur që janë këto të tonat, paraqiten dhe krijohen probleme dytësore që aspak nuk ndikojnë në të mirë të shoqërisë. Viset ku jetojmë ne janë vise ku me vite të tëra janë bërë luftëra dhe gjithmonë është luftuar për të drejtat e etniteteve. Në këto vise ku ne jemi vëllezër dhe mundohemi për të arritur të ashtuquajturën liri kombëtare e fetare. Por ende pa i rregulluar këto probleme parësore e themelore, është duke u luajtur me fatin e njerëzve, duke ua penguar jetesën e fesë që i përkasin. Sikur të analizojmë pak më mirë gjendjen, vijmë në përfundimin se sikur ne çdo problem tjetër e kemi rregulluar dhe tanimë na kanë mbetur vetëm problemet e ndjenjave njerëzore - besimeve të tyre. Çfarë kuptimi do të kishte demokracia për një popull pasi t'i ndalohet feja atij?

Për të gjithë është fort mirë e ditur se në trevat tona shumica e popullatës janë muslimanë dhe i takojnë Fesë Islame, e cila fé e obligon femrën që të bartë mbulesën për të mos treguar trupin e saj. Rreth çështjes së obligueshmërisë së mbulesës për femrat nuk ka asnjë paqartësi.⁴ Parashtrahet pyetja, pse në këtë vend të vogël me kaq probleme të mëdha dhe shumë çështje jetësore të pazgjidhura po aktualizohen probleme që aspak nuk janë në rend për t'u diskutuar? Pse pengohet femra muslimane që të mbulojë vetveten me dëshirën e vet, kur dihet se në shtetet më të mëdha të botës ka nene të posaçme për lirinë besimit dhe shkollimit të të gjithëve.⁵ A thua çfarë problemi sjell femra e mbuluar në një vend, apo çfarë rreziku mund të pritet nga një femër e shkollës mesme e cila juridikisht ende llogaritet e mitur? Cilat janë dëmet që i janë sjellë vendeve tona nga këto femra? Mbulimi i trupit të femrat nuk është një fenomen i ri në popullin tonë. Gjatë gjithë historisë sonë femra shqiptare ka qenë e mbuluar. Pse ne tani jemi kundërshtarë të një tradite shumëvjeçare që kemi pasur?!

Nuk duam të fajësojmë askënd, por vetëm duam

të cekim atë se, nëse kthehemi dhe shikojmë problemet që janë paraqitur nga lakuriqëzimi, shohim se nëpër shkollat e mesme, klubet e natës, kopshtet e qytetit etj. zhvillohet prostitucioni, incizohen akte jo morale nëpër kamera, bëhet pornografi etj. Sikur të ishin marrë me kohë iniciativa për parandalimin e këtyre sjelljeve shkatërruese të rinisë, sigurisht që gjendja jonë do të ishte më e favorshme në aspekt pozitiv. Përveç nëse dikush veprimet e lartpërmendura nuk i konsideron si një ecje e jonë në hap me kohën, civilizim, përparim, qytetërim...

Veshja e femrës muslimane - shamia, aspak nuk e ngadalëson apo pengon zhvillimin e një populli. Përkundrazi, ajo do të ndihmonte në pengimin e të këqijave dhe amoralitetit që sot ka arritur gati kulminacionin. Kush po u jep të drejtë disa udhëheqësve tanë që ta ndalojnë hyrjen në mësim, spital etj. të një vajze e cila nuk ka asnjë faj? Përderisa në njërin anë dalim me moton se duhet të bashkohemi dhe të jemi tolerantë ndaj njëritjetrit, në anën tjetër mundohemi t'ia humbim jetën dikujt vetëm pse mbanë shaminë në kokë. Pse nuk na pengon aspak lakuriqësia e tepruar, kur e dimë se ajo është shkaktare e humbjes së dinjitetit të gruas dhe prishjes së moralit të rinisë sonë?

Feja Islame i ka dhënë një rëndësi të veçantë moralit të femrës, sepse ajo është çerdhja e parë e zhvillimit dhe edukimit të fëmijës. Përveç kësaj, në Kur'anin Famëllartë gjendet një sure e tërë që u dedikohet femrave dhe që mban emrin En-Nisa (Gratë). Pse ndalohet një femër e cila e mbulon nderin dhe trupin e saj, në mënyrë që nesër ta edukojë një gjeneratë të shëndoshë? Tek e fundit, femrat e mbuluara nuk janë duke kërkuar nga askush ndihmë për ta ndërtuar jetën e tyre fetare. Ajo që ato nga ne kërkojnë është që vetëm t'i lëmë



të lira në zgjedhjen që kanë bërë dhe t'i konsiderojmë të barabarta në shoqëri; t'i lëmë të lira dhe të qeta në mësimet dhe punët e tyre dhe mos t'u bëjmë padrejtësi.

Shqiptarët janë të njohur për nga toleranca fetare mes vete dhe respektimi i të tjerëve. Ata i festojnë bashkërisht festat. Në një apartament jetojnë familje me besime të ndryshme dhe kjo aspak nuk e prish komshillëkun e tyre. Ose jetojnë bashkërisht në një fshat pjesëtarë të fesë islame dhe asaj krishtere. Bajramet, Kërshëndellat, Viti i Ri etj. gjithmonë kanë kaluar në qetësi dhe asnjëherë nuk ka ndodhur ndonjë problem nga aspekti religjioz. Bashkëjetesa shihet sikur e arsyeshme dhe preferuar edhe nga Kur'ani Famëllartë:

*"... Thuaju (o i Dërguar): "O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush..."*⁶

Problemet janë paraqitur dhe paraqiten për shkak të përdorimit të alkoolit, drogës, plaçkitjes, amoralitetit apo të diçkaje të ngjashme. Këto janë gjërat negative prej të cilave duhet t'i largojmë të rinjtë tanë. Të pengojmë hapjen e shtëpive publike dhe ardhjen e femrave të huaja në vendin tonë për shkatërrimin e rinisë përmes ushtrimit të amoralitetit; të dënojmë emetimin e serialeve erotike dhe filmave pornografik; të ndërmarrim masa më të rrepta kundër alkoolit, drogës dhe dhunës së çfarëdo lloji. Këto gjëra duhet gjykuar dhe duhet të jenë në shënjestër për t'u ndaluar dhe penguar nga institucionet tona, e jo shamia e vajzave muslimane. A nuk po na shohin sytë se çfarë po ndodh me rininë tonë dhe si është gjendja e saj në raport me duhanin, alkoolin dhe substancat narkotike? A nuk jemi dëshmitarë të bredhjes së fëmijëve tanë tërë natën nëpër kafene e internet klube? A nuk po dallojmë se si ka filluar të paraqitet një veti shkatërruese në shoqërinë tonë - vetëvrasja, si rezultat i humbjes së lumturisë shpirtërore?⁷

Femrat muslimane duhet të jenë të lira që ta bartin shaminë e tyre edhe në xhami, edhe në shkollë, edhe në universitet, edhe në institucione, gjithandej ku ajo gjendet me angazhimin e saj privat, shoqëror apo profesional, sikur që edhe motrat e nderit duhet të jenë të lira për veshjen e tyre në kishë dhe ku kanë nevojë për të. Ky do të ishte hapi i parë i lirisë së vërtetë, demokracisë së mirëfilltë, përparimit dhe civilizimit, gjëra këto që po na mungojnë me dekada e shekuj. Vështrimi i

feve nga këndvështrimi i njëjtë dhe respektimi i përfaqësuesve të tyre. Kjo është liria e besimeve të ndryshme në një vend. Sepse asnjë fé nuk nxit në ndarje, probleme dhe në shkatërrim të tjetrit. Kur'ani nuk urdhëron që muslimanët të jenë armiq të atyre që nuk i besojnë Islamit. Ai shumë qartë thekson se besimi është vetëm sipas dëshirës, andaj ajeti "***në fe nuk ka dhunë***"⁸ e mbyll çdo polemikë rreth perceptimit të fesë. Sikurse që muslimanët, për shembull, duhet t'i kenë të drejtat që të shkojnë në vizitë të Qabesë, po ashtu edhe jomuslimanët kanë të drejtë të shkojnë në Vatikan apo në vendet tjera të shenjta që kanë. Të mos harrojmë se pengimi i të drejtave të njeriut vetëm se e rritë dhe përhapë problemin, e assesi nuk do ta ndalojë atë.

Jemi duke jetuar në një kohë kur nuk mund të kemi shpëtim, përpos duke bashkëpunuar njëri me tjetrin. Andaj duhet që sa më parë t'u ofrojmë mundësinë e zhvillimit, përparimit dhe shkollimit njerëzve tanë, sepse, për ndryshe, përfundimet do të dalin në favorin e tjetërkujt. Duhet të ndihmojmë çdo të ri, femër apo mashkull, qofshin musliman apo të krishterë, që të ecë përpara në studimet e tij, në veprimtarinë dhe synimet e tij, pa ia cenuar aspak të drejtën e besimit që ka. Sepse feja është një gjë e natyrshme për cilën njeriu ka nevojë. Nëse do të sulmohet feja e njërit apo tjetrit, në të ardhmen mund të paraqitet një urrejtje dhe konflikt fetar. Andaj të mos përgatisim kurthe me duart tona, pa pasur asnjë shkak e asnjë arsye, por të ndihmohemi mes vete në të mira dhe të respektojmë njëri-tjetrin dhe parimet që kemi, në mënyrë që të kemi sukses në anën politike, ekonomike, fetare, kulturore etj. Në këtë kontekst mesazhi i Kur'anit na drejtohet:

*"... mos hidhni veten tuaj në rrezik..."*⁹ dhe *"... Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e jo në mëkate e armiqësi..."*¹⁰

Fusnota:

1 Tin, 95/3

2 Njeriu gjegjësisht Pejgamberët, ishin vetëm bartës të misionit të Tij e jo edhe zëvendës të All-llahut në tokë.

3 Isra, 17/70

4 Shih suren Nur, ajeti 31.

5 Lidhur me këto nene shih: Zymer Ramadani, "*Toleranca dhe e Drejta Fetare*", Revista Etika, nr. 8.

6 Ali Imran, 3/64.

7 Rexhep Suma, "*Vetëvrasja fenomen që e shqetëson shoqërinë Kosovare*", Dituria Islame, nr. 200.

8 El-Bekare, 2/256.

9 Bekare, 2/195.

10 Maide, 5/2.

TRYEZË E RRUMBULLAKËT ME RASTIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Me rastin e Ditës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, 10 dhjetorit, Forumi Rinor Islam, organizoi një tryezë të rrumbullakët me temë “Të drejtat e njeriut mes ligjeve dhe jetësimit praktik”. Në këtë tryezë ishin të pranishëm një numër i konsiderueshëm i intelektualëve, i organizatave joqeveritare dhe institucioneve të ndryshme. I pranishëm ishte edhe përfaqësuesi i Bashkësisë Evropiane në Republikën e Maqedonisë, Ervan Fuere.

Hapjen dhe udhëheqjen e kësaj tryeze e bëri Sali Shasivari, nënkryetar i Forumit Rinor Islam, kursen në emër të organizatorit, FRI-së, fjalën e rastit e pati nënkryetari tjetër i këtij asociacioni rinor, Milazim Mustafa.

Ligjërues të ftuar në këtë tryezë të rrumbullakët ishin:

- Prof. dr. Zejnullah Gruda, profesor i të drejtës ndërkombëtare dhe ligjërues në UEJL, i cili foli mbi temën “*Deklarata universale e të Drejtave të njeriut mes idealit dhe praktikës*”.

- Prof. dr. Biljana Vankovska, profesoreshë e shkencave juridike pranë Institutit për studime paqësore në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, e cila u paraqiti me temën “*Të drejtat e njeriut në botën e Hobsit - liri në këmbim të sigurisë*”.

- Prof. dr. Osman Kadriu, profesor i së drejtës kushtetuese në Universitetin FON, me diskutimin në temë “*Kushtetuta e Maqedonisë, e reja e vjetër*”.

- Magjistër Jeton Shasivari, profesor i së drejtës kushtetuese në UEJL, i cili shtjelloi temën “*Sfidat e Maqedonisë në raport me të drejtat e njeriut*”.

Fjalën përshëndetëse dhe të rastit pati edhe përfaqësuesi i BE në Republikën e Maqedonisë, Ervan Fuere, i cili foli mbi rëndësinë dhe nevojën e respektimit të të drejtave të njeriut. Ai përmendi synimin e Bashkimit Evropian për përmirësimin e mëtejshëm të nivelit të të drejtave, si dhe qasjen pozitive që duhet ta ketë Maqedonia ndaj këtyre të drejtave me qëllim të anëtarësimit sa më të shpejtë të saj në BE.

Në debatin që pasoi më vonë pati shumë pyetje dhe inkuadrime nga të pranishmit.

Në fund të tryezës përfaqësuesit e Forumit Rinor Islam njoftuan se kjo tryezë paraqet vetëm fillimin e një fushate që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, e cila do të kurorëzohet me aktivitete të ndryshme gjatë vitit 2008, i cili vit edhe u shpall si vit i të drejtave të njeriut në agjendën e aktiviteteve të FRI-së.

Krejt në fund Forumi Rinor Islam doli edhe me një deklaratë përfundimtare, ku thuhet:

Forum Rinor Islam mbështet qëndrimin se liritë dhe të drejtat e njeriut mbeten një nga postulatet kryesore mbi

të cilat duhet të sendërtohet një shoqëri e shëndoshë dhe demokratike.

FRI konstaton se, përkundër gjithë akteve dhe dokumenteve të miratuara në favor të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, akoma pothuajse në tërë botën kemi të bëjmë me shkeljen e këtyre të drejtave dhe lirive.

FRI vlerëson se në Maqedoninë e pavarur, prej fillimit të viteve të 90-ta e deri tani, e veçanërisht pas vitit 2001 dhe miratimit të kushtetutës së re, është bërë një progres i dukshëm në sferën e të drejtave të njeriut. Megjithatë, mbetet edhe shumë punë për t’u bërë dhe shumë angazhime për t’u realizuar në këtë drejtim.

FRI konkludon se gjatë këtij viti që po e përcjellim (2007) janë shënuar disa raste drastike të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, individuale dhe kolektive, andaj edhe fton organet kompetente për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për ndriçimin e rasteve të këtilla dhe nxjerrjen e autorëve para drejtësisë.

FRI fton të gjithë faktorët relevant, qofshin ata qeveritarë apo joqeveritarë, për një angazhim të përbashkët dhe të mirëfilltë, në funksion të afirmimit dhe mbrojtjes së të drejtave universale të njeriut, të drejta këto të garantuara nga Zoti, si dhe me të gjitha konventat ndërkombëtare.

FRI mbron me ngulm ushtrimin e të drejtave dhe lirive fetare, dhe dënon çdo shkelje dhe cenim të këtyre të drejtave. Në këtë drejtim, FRI përkrah fuqimisht iniciativën e filluar kohë më parë për respektimin dhe garantimin e të drejtës që femra muslimane të ketë të drejtën e fotografimit me mbulesë për dokumentacionet e duhura.

FRI e shpall vitin 2008 si vit të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në agjendën e aktiviteteve të veta.

FRI nxit për bashkëpunim intelektualët, organizatat joqeveritare dhe subjektet tjera në drejtim të avancimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Për më tepër, ftojme për formimin e një ombrelle të organizatave joqeveritare në vend, me qëllim të avancimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

NËN HIJEN E SHTËPISË SË SHENJTË

Haxhxi është një nga pesë shtyllat e Islamit. Ai është bazë shoqërore dhe shpirtërore, është pastrues i gjoksit të njeriut, shmangie nga joshjet dhe veprat e shëmtuara; njëkohësisht është edhe bosht i ummetit, njoftim i muslimanëve dhe bashkim i shpirtave të besimtarëve. Tërë kjo realizohet në vendin e shenjtë dhe nën hijen e shtëpisë së shenjtë të All-llahut.

All-llahu i Lartmadhëruar thotë:

“Përkujtoje kur Ne e udhëzuam Ibrahimin për në vendin e shtëpisë (Qabes): të mos më përshkruajë Mua shok, pastroje shtëpinë Time për ata që e vizitojnë (bëjnë tavaf), që qëndrojnë në këmbë duke u falur, përkulur dhe që bëjnë.” (Es-Sexhde: 26)

Për të ekzistuar njerëzimi, patjetër duhet të ketë parime dhe baza mbi të cilën do të qëndrojë, si barazia, vëllazëria, dashuria e paqes dhe të mirës, lufta ndaj të keqes dhe lidhja e mirë me All-llahun e Madhërishëm.

Islami që nga fillimi thërret në këto baza dhe parime madhështore dhe po këto i bëri obligim për muslimanin. Pikërisht për këto gjëra në shumë vende flet Kur’ani Famëlartë, si dhe hadithet e të Dërguarit [sal-lall-llahu alejhi ve sellem].

Mirëpo gjithmonë ajo që është teorike për t’u shfaqur dhe për të qenë efektive, është e nevojshme të materializohet ose të praktikohet, ashtu që të shijohet kuptimi dhe të depërtojë thellë në zemrën dhe shpirtin e njeriut. Mëshiruesi, për ata të cilët kanë mundësi, e bëri obligim këtë ritual madhështor:

“Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo.” (Ali Imran: 97)

Vet veshja e ihramit nga musafirët e All-

llahut sinjalizon madhështinë që ka ky adhurim i veçantë, të cilin All-llahu e bëri obligim për besimtarët një herë gjatë jetës, për ata që kanë mundësi të udhëtojnë drejt kësaj shtëpie të shenjtë. Që në momentin e parë shihet barazia ndërmjet tyre, duke larguar nga trupi i tyre çdo petk dhe duke mbuluar trupin e tyre me dy copa, izarin (copa e poshtme) dhe ridanë (copa e sipërme). Me këtë rast të gjithë i sheh të barabartë për nga pamja e tyre, të bardhin dhe të ziun, të Lindjes dhe të Perëndimit, të voglin dhe të madhin, kryetarin dhe masën e përgjithshme; të gjithë marrin një pamje të re që nuk i dallon njërin nga tjetri, të gjithë bëhen të barabartë.



Nuk ka gëzim më të madh se kur haxhiu thotë telbijen:

“Iu përgjigjëm thirrjes Tënde o Zot! Iu përgjigjëm thirrjes Tënde se Ti je i vetëm dhe i pashoq. Gjithë lavdërimi, mirësia dhe pushteti të takojnë vetëm Ty. S’ka dyshim se Ti je i vetëm dhe i pashoq”.

Siç shihet edhe nga përmbajtja, kjo frazë në mënyrë të qartë shpreh njohjen e një Zoti të vetëm, besimin e kulluar vetëm në Të dhe nënshtrimin e plotë vetëm ndaj Tij.

Nga ky moment haxhiu është në paqe dhe solidaritet me njerëzit, bimët, insektet etj. Atij nuk i lejohet të shkaktojë as gjakderdhjen më të vogël, as të mbyttë mushkonjën apo mizën më të vogël, as t’i shkurtojë thonjtë dhe flokët e tij gjatë kësaj periudhe. Kjo është praktika dhe ky materializim i teorisë e nxjerr në pah paqen, barazinë, duke u thelluar në shpirt dhe duke i trajnuar pjesët e trupit drejt vlerave dhe respektit.

Haxhiut, që në momentin e parë kur ballafaqohet me shtëpinë e shenjtë, Qaben, i ngjallen emocionet kur mendon se pranë kujt gjendet dhe mysafir i kujt është. Njëkohësisht fillon të mendon se kjo shtëpi e shenjtë është qendër dhe qëllim. Është caku që i bashkon të gjithë muslimanët e botës. Të gjithë në namaz drejtohen nga Qabja. Është simbol i solidaritetit dhe i bashkimit. Ajo luan një rol të rëndësishëm në forcimin e vëllazërimit, harmonisë, marrëdhënieve reciproke, afrimit dhe njohjes së popujve, vendeve dhe bashkësive të ndryshme muslimane.

Gjithashtu, ky tempull i shenjtë mundëson jo vetëm bashkimin fetar, shpirtëror, moral dhe ideor, por edhe atë hapësinor. Prandaj Qabja, në krahasim me të gjitha xhamitë e botës, është qendra shpirtërore, morale, fetare e hapësinore në drejtim të së cilës janë të kthyerat dhe pas së cilës janë të lidhura të gjitha xhamitë, mihrabet dhe shtëpitë e besimtarëve muslimanë kudo në botë. Kudo që janë, muslimanët, kur falin namazin, kthehen drejt Kibles (Qabes). Besimi në Një Zot (iman), të nënshtruarit vetëm Atij (islam), të robëruarit ndaj Tij (ibadet) dhe të kthyerit nga Kibla në namaz, bëjnë unitetin islam dhe bashkësinë muslimane botërore të pandashme dhe unike deri në Ditën e Gjykimit.

Kjo shtëpi e shenjtë gjatë tërë historisë ka luajtur rolin e krijimit të paqes dhe ibadetit. Ajo ka qenë e tillë madje edhe në ato momente kur përreth saj janë zhvilluar luftëra e vrasje. Kur’ani e tregon këtë fakt duke thënë:

“A nuk e kanë vërejtur ata se Ne e kemi bërë

vendin e shenjtë (Meken) të sigurt, e njerëzit përreth tyre rrëmbehen (plaçkiten e vriten). Po, a i besojnë ata të kotës, e të mirat e All-llahut i përbuzin?” (Ankebut: 76)

Ajo është një bekim dhe udhërrëfyes (kible) për njerëzit. Ajo është një shtëpi të cilën e cakton dhe garanton All-llahu i Madhërishtëm se do të jetë shtëpi përparimi, vatër e dashurisë së vërtetë, drejtësisë dhe solidaritetit.

Qaben e ndërtoi Ibrahim [alejhis-selam] me Ismailin [alejhis-selam]. Ata ishin dy njerëz të lirë dhe njëkohësisht edhe të dorëzuarit e të nënshtruarit e All-llahut të Madhërishtëm.

Dhe kur Ibrahim dhe Ismaili [alejhimus-selam] i vendosën themelet e tempullit, u lutën:

“Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di! Zoti ynë, na bëj neve të dy besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit tonë dhe na fal neve, vërtet, Ti je që fal shumë, je Mëshirues! Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre, të dërguar që t’ua lexojë atyre ajetet e Tua, t’ua mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë ata (prej idhujtarisë). S’ka dyshim se Ti je Ngadhënyyesi, i Dijshmi.” (El-Bekare: 127-129)

Nuk do të harrojmë aspak edhe prekjën apo puthjen e gurit të zi, gjë që është dëshirë e flaktë e haxhiut, me ç’rast ngjallen ndjenjat njerëzore dhe vëllazërore, sepse kush e prek atë sikur i ka përshëndetur të gjithë vëllezërit që na tejkaluan me vepra të mira dhe ndoshta më veç e kanë takuar Zotin e tyre. Po ashtu, në çdo tavaf (rrotullim rreth Qabes) që haxhiu bën dhe e prek gurin e zi, i besatohet All-llahut se do të jetë një ushtar i Tij dhe nuk do të jetë një njeri siç ishte përpara së të bëjë këtë udhëtim, si dhe kurrë nuk do ta lejojë veten që të harrojë All-llahun dhe urdhrat e Tij, sepse ai e ka prekur këtë gurë të cilin i Dërguari [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e quajti ndryshe edhe: *“e djathta e All-llahut në tokë”*.

Kjo është madhështia e qëndrimit të haxhiut nën hijen e këtij tempulli të shenjtë duke përkujtuar madhësinë e All-llahut, kur njerëzve të mirë dhe të devotshëm u shtohet edhe më tepër besimi dhe bindja, shpresa dhe shpëtimi, vetëdija dhe vizioni i qartë, humaniteti dhe solidariteti, vëllazëria islame dhe uniteti.

Prej simboleve të haxhit është edhe Saji (kodrat Safa dhe Merva). Ndërmjet Safa-së dhe Merva-së i përkujtohet njeriut drama në mes jetës dhe vdekjes. Aty nëna (Haxherja) luftoi për të

shpëtuar jetën e fëmijës së saj (Ismailit). Nuk iu dorëzua as rërës së shkretëtirës, as vapës diellore. Këtu besimi mbizotëroi dëshpërimin, jeta ngadhënjeu mbi vdekjen. Ky vend është dëshmitar i triumfit të dashurisë së nënës, besimit dhe jetës. Vallë, ai që e shkel me këmbën e tij dheun e këtij vendi a nuk do të mendojë për obligimet ndaj prindit? Kur'ani flet për Safa-në dhe Merva-në dhe thotë:

“Safa” dhe “Merva” janë nga shenjat e All-llahut, e kush kryen haxhxin apo umren, nuk është mëkat për të që t'i vizitojë ato të dyja. E kush bën ndonjë të mirë nga vullneti, s'ka dyshim se All-llahu është Shpërblyes i Gjithë-dijshëm.” (El-Bekare: 158)

Kodra e Safa-së na përkujton edhe një biografi që e regjistroi historia me shkronja të arta. Fjala është për shtëpinë e Erkam bin Erkamit, e cila ishte foleja e parë ku Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe shokët e tij, në ditët e para të shpalljes, tuboheshin për të mësuar fjalët e All-llahut dhe diskutonin për shumë çështje.

Qëndrimi në Arafat është dita me e lumtur e mysafirrit të All-llahut. Arafati është kurora e të gjitha aktiviteteve të Haxhit. Në këto vende, jo pa arsye, haxhiu beson se All-llahu i Madhërisëm do t'ia falë gjynahet ashtu siç ia fali babait të tij Ademit [alejhis-selam]. Ai e ndjen mundësinë që të përmirësohet dhe që të hapë një faqe të re të pastër të jetës së tij. Njeriu aty e njeh veten, ashtu si thotë dijetari Raziu në tefsirin e tij se në atë vend All-llahu i Madhërisëm i tha Ademit dhe gruas së tij:

“Tani e njohët veten tuaj”.

Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] thotë: *“Haxhxi është Arafati”*. Ibadeti kryesor në atë ditë është lutja dhe pendimi para Mëshiruesit; por jo se nuk bëhet fjalë vetëm për lutje dhe dëshira të njëjta, por edhe fjalët, të folurit dhe qëndrimet janë unike. Në hutben e njohur në Arafat, në vitin 630, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] unitetin dhe bashkimin ua la si amanetin më të madh gjeneratave të ardhshme të Islamit. E para-ndjeu se ai ishte fjalimi i tij i fundit dhe paraqitja e lamtumirës para masës. E pa se ishin hapur dyert e ngadhënjimit e të përhapjes së Islamit. Ishte i vetëdijshëm se po u drejtohet gjeneratave të ardhshme, prandaj edhe e theksoi në mënyrë të veçantë që ta dëgjojnë me kujdes. E paralajmëroi ummetin e tij që të ruhen nga rreziku i intolrancës etnike, religjioze, sociale, nga kamata, gjakmarrja, përcarja brenda radhëve të tyre, që të

mos ndahen e përçahen në çështje të fesë dhe të mos krijohen fraksione prej saj të cilat do t'i rrënonin themelet e godinës së bashkësisë muslimane.

Riti i gjuajtjes së guralecëve në Mina përmban në vete një domethënie të madhe përkaj ngjarjes ku këtu njeriu (Ibrahimi) iu nënshtrua sprovimit më të vështirë. All-llahu i Madhërisëm e urdhëroi atë që të flijojë djalin e tij, kurse, nga ana tjetër, shejtani përpiquej që ta pengojë në zbatimin e këtij urdhri hyjnor duke iu paraqitur në formën e njeriut. Por Ibrahimi [alejhis-selam], bashkë me të birin, vendosën ta zbatojnë urdhrin e All-llahut të Madhërisëm, e pastaj All-llahu ia zëvendësoi të birin me një dash, sepse Ai nuk lejon të sakrifkohet jeta e njeriut me bindjen se po i bëhet mirë Zotit.

Ky ishte një hap civilizues, kur dihej se para Ibrahimit [alejhis-selam] ndër shumë popuj ishte bërë zakon flijimi i njerëzve. Ibrahimi i ndërpreu zakonet e tilla dhe vendosi një traditë tjetër.

Në këto momente, haxhiu, pasi që pastrohet nga mëkatet gjatë qëndrimit në Arafat dhe pas përkujtimit të ngjarjes, përplot bindje dhe qëndrim ka një qëllim, duke e parë se forca e së keqes është grumbulluar tek Iblisi, e lufton të keqen dhe atë që e nxit të keqen, dhe kjo bindje dhe qëndrim duhet të shndërrohet në pjesë e jetës së tij.

Pastaj së bashku ata të cilët kanë për të prerë kurban shkojnë dhe i therin në emër të All-llahut. Edhe aty manifestohet solidariteti dhe bujaria e muslimanëve kur ata ua dhurojnë mishin e kurbaneve të varfërve.

Janë këto përjetime shpirtërore para të cilave lapsi ngel i paaftë për të përshkruar realitetin e tyre.

Pas gjithë kësaj më qartë mund të kuptojmë përgëzimin e madh që bëri i Dërguari i All-llahut, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], për haxhiun i cili kështu e përjeton këtë vizitë: *“Ai person kur kthehet nga haxhxi, kthehet në familjen e tij i pastër dhe i falur nga mëkatet, ashtu siç e ka lindur nëna e tij”*.

Lusim All-llahun e Madhërisëm që të na thellojë në diturinë dhe urtësinë me të cilat Ai i ka pajisur robërit e Tij dhe të na bëjë prej atyre: **“Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.”** (Ez-Zumer: 18)

All-llahu e pranofte dhe le të jetë i kënaqur nga ky ibadet madhështor prej robërve të Tij.

TRI PËRMBAJTJET THELBËSORE TË KURBAN BAJRAMIT

Kurban Bajrami është festë e muslimanëve, është festa e një miliardë e gjysmë njerëzve të botës.

Të kremtuarit e këtyre ditëve përkujton ditët e lavdishme të së kaluarës së ndritshme islame dhe nxit besimtarët muslimanë në angazhime më të vendosura për detyra të reja dhe energji më të mëdha në organizimin dhe krijimin e një ardhmërie të mirë e të lumtur.

Kur'ani, Haxhi dhe Kurban janë përmbajtje themelore të Kurban Bajramit, të cilët paraqesin tri ideale të larta islame. Kur'ani paraqet arsimimin dhe devotshmërinë, Haxhi solidaritetin reciprok dhe Kurban sakrificën për të tjerët.

Prandaj porosia e parë e këtij bajrami për të gjithë besimtarët muslimanë është të kërkuarit e diturisë dhe shfrytëzimi i mendjes dhe i trurit nga ana e tyre. Feja Islame, edhe në burimet e saja fetare por edhe në traditën historike, shumë qartë e ka theksuar faktin që faktori intelektual është bartës i afirmimit të njeriut në çdo aspekt të jetës së tij. Jo vetëm kaq, por edhe fuqia e fesë në Islam matet me arsyen. Profeti ynë, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], thoshte :

“Feja e një njeriu është arsyeja e tij; ai që nuk ka arsye nuk ka fë”.

Kur'ani dhe Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] lavdërojnë çdo punë fizike e mendore që i sjell dobi individit, familjes, bashkësisë, shtetit, njerëzimit. Janë disa citate të cilat do të bëjnë të qartë obligimin e muslimanëve për punë fizike e mendore (për shkencë, filozofi, tregti, zanate, bujqësi etj.)

“Thuaj, o Muhammed, a mund të jenë njësoj ata që dinë me ata që nuk dinë”.

“All-llahun e kanë frikë nga robërit e Tij vetëm shkencëtarët”.

“Shkencëtarët janë trashëgimtarët e profetëve të Zotit”.

“Në Ditën e Gjykimit do të matet ngjyra e lapsit të dijetarit me gjakun e dëshmorit - shehidit”.

Konstatimi që “Shkenca dhe të mësuarit është farz - detyrim për të gjithë pjesëtarët e Islamit” (Ibni

Muhidin AHMETI

Maxhe), vë në dukje vlerën e madhe të thirrjes islame për këtë, aktivitetin më human dhe më të rëndësishëm të të gjithë njerëzve. Kërkimi i diturisë, mësimi dhe studimi është aktiviteti më i pëlqyeshëm i cili nuk duhet të pushojë deri në fund të jetës. Thirrja për arsimimin e gruas është thirrja e parë në histori se me dituri duhet të armatohet njësoj si mashkulli dhe femra. Ky që një hap deri te barazia e plotë midis mashkullit dhe femrës.

Lidhur me çështjen në fjalë dhe situatën që po kalojnë trojet shqiptare, duhet vënë në dukje gjithashtu edhe rolin e intelektualëve me qëllime dhe vullnete të mira.

Ata janë shpresa më e madhe e njerëzimit. Sikurse është thënë, dijetarët - intelektualët janë kripa e kësaj bote, në qoftë se prishet kripa, do të prishet bota. Ata janë zemra e kombit! Nga intelektualët kërkohet të flasin më shumë, duhet të dëgjojnë zëri i tyre, mendimi dhe qëndrimi i tyre, sepse kjo është në dobi të të gjithë njerëzve. Në qoftë se ata heshtin, hesht njerëzimi ose flasin ata që nuk janë kompetent. Shenjë e shkatërrimit të kësaj bote është kur flet injoranti ndërsa hesht i mençuri. Mendimet e intelektualit nuk duhet të jenë të programuara me interesat e individëve apo grupeve, madje as me interesat personale. Ata duhet të flasin për hir të së vërtetës dhe drejtësisë, për hir të atdheut, kombit dhe ata duhet të jenë inkurajuesit dhe luftëtarë të këtyre idealeve. Kështu u shpreh Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke thënë:

“Kontributi më i madh që i bëhet të vërtetës është që njeriut të padrejtë t’ia thuash të vërtetën në fytyrë”. Po ashtu, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Pasardhësit e mi do të përparojnë dhe me ta do të jetë ndihma e All-llahut gjithnjë derisa bartësit e pushtetit nuk u nënshtrohen (nuk dëgjojnë fjalën) bartësve të diturisë (intelektualëve)”.*

Të kuptuarit drejtë të domethënies së dispozitave dhe institucioneve islame në mënyrë të domosdoshme kërkon arsimim. A është e mundur, vallë,

që një njeri i paditur të kuptojë domethënien e lartë të dispozitave islame, me të cilat admirohen edhe shkencëtarët më të mëdhenj? Islami është fë e jetës, i cili gjithmonë zhvillohet, shkon përpara duke e ndërruar stilin dhe formën e vet. Çdo musliman e muslimane në përgjithësi dhe të rinjtë e të rejat në veçanti duhet patjetër të pranojnë e përvetësojnë shkrim - leximin, arsimimin dhe shkencën, si mjete të domosdoshme për afirmimin më fisnik dhe progresin jetësor në gjirin e fesë së tyre të lartë...

Porosia e dytë e Kurban Bajramit është Haxhi dhe ne përsëri jemi në ditët e tij. Përsëri jemi dëshmitarë të mbajtjes së manifestimit numerikisht më të madh njerëzor që mban mend historia. Miliona njerëz nga vendet më të ndryshme të botës, me mund e sakrifica të mëdha, u nisën në udhëtimin më të gjatë dhe më të dashur, udhëtimin i cili shpie në takim me Zotin, historinë dhe njeriun. Haxhi është takim i muslimanëve nga gjithë bota. Më se 14 shekuj muslimanët nga të gjitha anët e botës i përgjigjën thirrjes së All-llahut dhe me nxitim nisen me mjetet më të përshtatshme drejt Qabes.

Haxhi, sikurse e thamë, është manifestim i unite-it, harmonisë dhe vëllazërisë së vërtetë islame. Sipas dispozitave fetare, të gjithë haxhinjtë gjatë kohës së bërjes së haxhit kanë të njëjtën uniformë (ihramin) dhe që të gjithë, pavarësisht nga profesioni, pozita e klasa, kanë të drejta të barabarta, për të hyrë në faltoren e Zotit në Qabe. Titujt e nderit dhe famës së kësaj bote aty nuk merren parasysh, jo më t'i jepet vendi i parë. Para dyerve të mëshirës se Zotit të gjithë janë të barabartë. Aty në mënyrë të veçantë manifestohen fjalët kur'anore: **"Besimtarët janë vëllezër"**. Ndoshta vetëm në këtë vend dhe vetëm në këtë rast mund të shohim si ofiqarët e lartë muslimanë të vendeve të ndryshme futen në bashkësi me të tjerët. Këtu na jepet shembulli më i mirë se si njerëz me ngjyrë, gjak dhe gjuhë të ndryshme mund të jenë vëllezër kur në mjedisin e tyre i japin pak më shumë vend njerzshmërisë dhe të menduarit. Këtu mund të shihet mirë se si muslimanët arabë, shqiptarë, gjermanë, amerikanë, japonezë, kinezë etj. në mënyrë vëllazërore i shtrëngojnë dorën njëri-tjetrit dhe me lot në sy përqafohen. Ata bëjnë kështu sepse gjenden në vendin ku egoizmi dhe interesat materiale të kësaj bote nuk kanë ndikim, ku flet ndërgjegjja e pastër, zemra e dëlirë dhe morali i lartë, ku vëllazëria dhe paqja nuk lidhen me fjalë dhe kushte, por me ndjenjën e sinqertë të

zembrës së kalitur me shkencën e pastër islame.

Këtu njeriu ka rastin më të mirë që të njihet me popujt e tjerë dhe me kushtet e tyre, ndërsa nëpërmjet njohjeve të tilla reciproke duhet të vijë deri te solidariteti i ndërsjellë për të cilin gjithmonë ka nevojë të domosdoshme njerëzimi. All-llahu i Madhërishëm në Kur'an thotë:

"O njerëz. Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe ju kemi bërë të ndarë në popuj që të njiheni mes vete. Më i miri tek All-llahu është ai i cili bën vepra të mira." (Huxhurat: 13)

Fjalimi i fundit i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në Haxhin lamtumirës është një mesazh i mirë edhe për popullin shqiptarë dhe për gjendjen nëpër të cilin ai po kalon.

Duke festuar Bajramin ne i konfirmojmë dhe i përtërimë këto porosi dhe qëllime të larta, duke sakrifikuar çdo gjë, për të mirën, paqen, harmoninë dhe mirëqenien ndërnjerzore. Meqë flasim si muslimanë, atëherë duhet të nisemi nga vetja, duhet të dimë cilat janë themelet e paqes sonë, si e përjetojmë atë dhe si arrijmë deri te përbërja shpirtërore e paqes në vete. Përndryshe, paqe të vërtetë nuk do të ketë përderisa paqja nuk ngadhënjën qënien njerëzore, përderisa nuk bëhet dimension i shpirtëror i njeriut. E kjo do të arrihet kur të jetojmë plotësisht sipas dispozitave të Zotit Fuqplotë. Nëse nuk e përfillim fjalën e Zotit, në qoftë se krahas ligjeve njerëzore nuk përfillim edhe ligjet hyjnore dhe normat e përcaktuara në to, do të jemi të detyruar t'i përjetojmë sanksionet e ligjit natyror si ndëshkim dhe goditje paralajmëruese për moszbatimin e ligjit të parë. Këtë e shpjegon qartë Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] duke thënë: **"Pesë për pesë. Kur një popull nuk e kryen obligimin ndaj Zotit, Ai do t'ju dërgoj armikun për sundimtar. Në qoftë se gjykojnë ndryshe nga ajo që ka urdhëruar Zoti, do t'ju shfaqet varfëria. Kur të përhapet në popull imoraliteti e prostitucioni, pritni shtimin e sëmundjeve e të vdekjeve. Nëse heqin në peshë (mashtrojnë në peshë), nuk do të ketë bereqet në të mbjella dhe do të jetë vit i lig. Dhe kur të pengojnë dhënien e zeqatit, do t'i zëjë thatësia"**.

Çështja e paqes dhe e pajtimit të njerëzve është çështje e shpirtit njerëzor. Paqja e vërtetë ekziston në shpirtin e njerëzve ose nuk ekziston fare. Marrëdhëniet reciproke në mes njerëzve janë pasqyrë dhe reflektim i cilësive shpirtërore e morale. Ajo që zihet dhe vlon në shpirtin e njeriut patjetër do të shfaqet në veprat dhe raportet

ndërnjerëzore. Atje ku ka paqe në shpirt, atje është e vendosur, ndërsa atje ku nuk ka paqe në shpirt, atje duhet mbrojtur. Nuk duhet filozofi e madhe për të treguar sa e keqe është një luftë. Vetëm një përfytyrim i një lufte të mundshme është i mjaftueshëm për ata që kanë mend, të kuptojnë sa fisnik është ai zë i cili ngrihet në mbrojtje të paqes dhe marrëdhënies të mira ndërmjet popujve, feve dhe racave të ndryshme.

Antagonizmat që lindin në mes besimtarëve të feve të ndryshme tregojnë për mosnjohjen e fesë. Ata të cilët kanë raporte të tilla antagoniste, nuk e kanë kuptuar esencën e fesë, shpalljen e urdhëresave e porosive dhe ligjeve të Zotit të cilat kanë zbritur sipas etapave në pajtim me zhvillimin shpirtëror e intelektual të njerëzimit.

Ardhmëria e njerëzimit është në maksimum: “Beso Zotin dhe bën vepra të mira”.

Duke i festuar ditët e madhnueshme të Bajramit ne përkujtojmë sakrificat e mëdha që janë bërë gjatë historisë për realizimin e atyre qëllimeve e synimeve sublime të jetës njerëzore. Për parimin e bashkëjetesës, për atë që të realizohet atmosfera e lirisë dhe e dashurisë, shumë popuj të botës kanë dhënë sakrificat e mëdha. Pa sakrificat nuk mund të ketë as vepra të mëdha. Njerëzimit do të bëhen të shquar dhe të pavdekshëm vetëm nëse janë të gatshëm të sakrifikojnë, ndërsa popujt bëhen të mëdhenj dhe të fuqishëm vetëm nëse stolisën me virtyte e ndjenja sakrifikuese për të mirën e përgjithshme për të mirën e kombit të atdheut.

Ditët e gëzuara të këtij Bajrami na përkujtojnë Ibrahimin dhe Ismailin [alejhimus-selam] dhe gatishmërinë e tyre për të sakrifikuar çdo gjë për hir të Zotit dhe veprës së mirë.

Vendosmëria e Ibrahimit të bëjë sakrificë dhe gatishmëria e Ismailit të bëhet sakrificë ka qenë sprovë shumë e madhe dhe e pa precedent në histori. I gatshëm të flijojë djalin, lindja e të cilit ka qenë fryt i lutjes dhe i shpresës modeste në pleqëri, gëzim i prituri gjithë jetën. Dhuratë e Zotit që duhej kthyer Zotit. Ta bësh kurban atë, mendja njerëzore do të thoshte ta presësh palmën e gjelbër që shkretëtirës së vdekur i premtonte shpresë në zgjatjen e jetës, ndërsa për mendjen profetike do të thotë të vërtetuarit e nënshtrueshmërisë ndaj përcaktimit të Zotit.

Kjo është ngritja e njeriut deri tek dashuria më e lartë, dashuria që shkrin çdo dashuri tjetër, deri te vullneti i çeliktë i cili eviton çdo gjë që rrezikon dorëzimin e plotë ndaj Zotit. Ai na jep çdo të mirë, e në shenjë mirënjohjeje falim namazin dhe

presim kurbanin. Ai që nuk na do, do të mbetet i pa përkujtuar, ndërsa përkujtimi i ynë është Ibrahimit për brezat e vonshëm.

Nga sa u tha më lartë, mund të përfundojmë që sakrificat është ajo rruga kryesore e cila çon te



mëshira e Zotit, pse jo edhe te miqësia e Zotit, ashtu si e fitoi Ibrahimit [alejhis-selam] dhe u bë Halilullah (Mik i All-llahut).

Çdo musliman e ka për detyrë ta ndjekë këtë rrugë, rrugën e atyre prijësve shpirtërorë të cilët i ndihmuan popujt e tyre sa herë që ata e sillnin vetën buzë greminës. Rrugën e profetit të Zotit, Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], i cili thoshte se drejtimi i popujve është amaneti dhe përgjegjësia më e madhe në këtë botë dhe se popujt kanë prijës ata që i meritojnë.

Trashëgimtari i parë i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], Ebu Bekri [radijall-llahu anhu], duke e pasur parasysht këtë iu drejtua popullit dhe i tha: “Më vendosët si udhëheqës tuajin, por kjo nuk do të thotë se unë jam më i miri prej jush. Në qoftë se do të punoj mirë, më ndihmoni, nëse gaboj, më korrigjoni. Jini të bindur ndaj meje derisa unë i bindem Zotit dhe Profetit të Tij. Në qoftë se unë heq dorë nga ajo bindshmëri, më braktisni edhe ju mua”.

Një halif tjetër, Malik ibn Hervan, i nxitur nga halifët e mëparshëm, tha: “Njerëzimit më të mirë janë ata të cilën falin kur kanë mundësi të dënojnë, të cilët janë modestë kur janë në pozita të larta, dhe kur janë në piramidën e pushtetit sillen me drejtësinë më të madhe”.

MORALI ISLAM – BAZAT DHE VEÇORITË E TIJ

Morali - domosdoshmëri njerëzore

Nëse morali, sipas përkufizimeve, është tërësia e parimeve dhe vlerave që njeriu ka në veten e tij, e pastaj në mënyrë të natyrshme, madje ndoshta dhe të pavullnetshme, mbi këto vlera ai ndërton sjelljet e tij... atëherë ai (morali) qenka me të vërtetë i rëndësishëm. Një sistem moral shoqëror, sidoqoftë ai, është gjëja më e pakët që duhet të ekzistojë për të garantuar vazhdimin e jetës së një shoqërie. Nisur mbi këtë bazë nuk do të ishte e tepërt të pohonim që madje dhe një bandë mafiozësh apo hajdutësh kanë një sistem të tyrin moral, të cilin duhet ta respektojnë për të vazhduar jeta e atij grupi si psh.: besnikëria ndaj grupit, ndarja e plaçkës sipas rregullave paraprake, të mos tradhtohesh e spiunohesh grupi etj., gjëra të cilat i dinë më mirë vetë ata të këtyre specialiteteve.

Morali ka qenë dhe vazhdon të jetë objekt diskutimi ndërmjet filozofëve, sociologëve, apo dhe njerëzve të thjeshtë, kur në bisedat e tyre i qajnë hallin njëri - tjetrit për shthurjen e fëmijëve apo të shoqërisë në përgjithësi.

Fetë në përgjithësi, e sidomos ato hyjnore në veçanti, i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë çështjes së moralit, e pse jo në bazë të gjithçkaje ato duhet të kenë pasur përsosjen e moralit si treguesi kryesor i përmirësimit të përhershëm të njeriut.

Meqë moralet në përgjithësi janë çështje e brendshme, fetë hyjnore janë marrë me rregullimin e brendësisë së njeriut para rregullimit të së jashtmes së tij. Madje imam Gazaliu thoshte se, për çdo moral që ka zënë vend në zemër shfaqet një sjellje e caktuar në gjymtyrët e njeriut, domosdoshmërisht në përputhje me atë të zemrës pa u menduar personi gjatë”.

Veprat e njeriut nuk janë vetëm se përkthim viziv i asaj që është në thellësitë e shpirtit të tij. Ato janë si puna e rrënjëve të zhytura thellë në tokë, të cilat mbajnë dhe ushqejnë degët që janë përgjithësisht të prekshme nga të tjerët. Ja përse Zoti në Kur'an e shëmbëllën punën e mirë me pemën që ka rrënjë dhe degë: *“A nuk e sheh se si Zoti, për fjalën e mirë sjell për shembull atë pemën e mirë: rrënja e saj*



Ferid PIKU

është e thellë dhe e fortë dhe degët janë lart në qiell. Kjo pemë me leje të Zotit gjithmonë do t'i japë frutat e saj dhe kështu pra Zoti sjell shembuj për njerëzit që ata të kujtohen.” (Ibrahim: 24)

Çdo lloj shoqërie, e çfarëdolloj feje qoftë ajo, duhet ta kuptojë se me rënie dhe vdekjen e një morali bie dhe vdes një pjesë e saj, shkëputet një lidhje që e mbante atë në këmbë, e kështu njëra pas tjetrës derisa të rrëzohet gjithçka.

*Kombet do të jenë sa morali i tyre ekziston
Kur ai rrënohet mos pyet pse kombi mbaron*

“Dimensioni moral”- nervi që përshkon të gjitha elementet përbërëse të Islamit

Nëse do të ecnim me logjikën e dijetarëve islamë, do të gjejmë se ata e ndajnë Islamin (për efekt lehtësimi) në akide (besim), ibadet (adhurim) dhe muamelat (marrëdhënie).

Por nëse do ta analizonim më thellë çështjen e acides, do të gjejmë se ajo qëndron mbi mendjen e shëndoshë e të lirë, mendjen që mediton e pastaj vendos të zgjedhë besimin dhe të marrë përsipër çdo barrë që duhet mbajtur. Dhe e gjitha kjo është një moral më vete, është morali i mendjes i cili realisht qëndron në bazë të të gjithave moraleve tjera.

Për më qartë, nuk janë të pakta e as spontane ato thënie profetike që imanin e muslimanit e kanë matur me moralin e tij. Kur dikush e pyeti: “Cili është besimtari me besimin më të plotë?” Profeti [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] tha: *“Ai që ka moralin më të mirë”*. Po ashtu kur u pyet se ç'është feja, ai u përgjigj: *“Morali i mirë”*.

Ibadetet që në përgjithësi për ne janë riti i dukshëm dhe shpeshherë konsiderohen si kriteri i vetëm me të cilin vlerësohen njerëzit, kanë që të gjitha për qëllim përmirësimin e moralit të njeriut, e kështu automatikisht ngritjen e vazhdueshme të tij.

“Dhe fale namazin, se namazi të ndalon nga fjalët e pahijshme dhe punët e këqija.” (Ankebut: 45)

“Unë ia pranoj namazin atij që tregohet modest për hir të madhësisë Sime, që nuk tregohet

arrogant ndaj krijesave të Mija, nuk fle këmbëngulës ndaj mëkatit të tij dhe ditën e kalon në përkujtimin Tim. Atij që mëshiron të mjerin, të mbeturin në rrugë, vejushën dhe hallexhiun”. (Hadith kudsij. Transmeton Bezzar).

Agjërimi është frenim nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime nga agimi deri në perëndim. Por nëse kjo shtyllë e rëndësishme e Islamit do të ngelej në këtë përkufizim kaq skolastik, atëherë do të ishte me të vërtetë shumë padrejtësi. Agjërimi, për më tepër, është frenim i përkohshëm nga e lejuara legjitime për të lehtësuar ndalimin e përhershëm të së keqes ilegjitime. Prandaj fjalët profetike janë më se të qarta në këtë kontekst: *“Kush nuk braktis gënjeshtrën dhe punën e keqe, le ta dijë se Zoti nuk ka nevojë që ai të braktisë ushqimin dhe pijen e tij”.* (Buhariu)

Po kështu, zekati nuk është një barrë fiskale të cilës zakonisht njerëzit mundohen t'i largohen, por një mundësi pastrimi shpirtëror dhe moral para se të jetë një pastrim material.

“Merr zekat nga pasuritë e tyre që t'i pastrosh e t'i begatosh me të.” (Teube: 103)

Që njerëzit të mos e kufizojnë konceptin e së mirës vetëm me mundësitë materiale që kanë, Islami e zgjeroi rrethin e lëmoshës, duke e bërë deri dhe buzëqeshjen ndaj të tjerëve, këshillën për mirë, ndalimin për keq, largimin e pengesës nga rruga e njerëzve, udhëzimin e atij që nuk e di rrugën etj, një sadaka që meriton të shpërblehet.

Po kështu edhe haxhi nuk është aspak një turizëm për në tokat e shenjta, por një mundësi për të fituar si shpirtërisht dhe moralisht, një rast i mirë për të përmirësuar durimin, urtësinë, zemërgjerësinë para miliona e miliona njerëzve që janë ndryshe prej teje. **“Haxhi është në muaj të caktuar. Kush vendos të bëjë haxh në këta muaj duhet ta dijë se në haxh nuk duhet të ketë marrëdhënie bashkëshortore, nuk duhet të bëjë gjynahe dhe nuk duhet të bëjë debat (shamatë)...”** (Bekare: 197)

“Muamelat” quhen marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, që në Islam duhet të bazohen medoemos mbi drejtësinë, transparencën, besnikërinë etj. A nuk ishte ky shkaku që vende si Indonezia, Malajzia etj., hynë në Islam pa grupe ftuesish apo ushtarësh. Edhe në rast lufte është kërkuar ruajtja e këtyre rregullave dhe mos tradhtia me atë që më parë është lidhur një marrëveshje (siç Profeti [sal-lall-llahu alejhi ve sellem] nuk pranoi muslimanët e rinj në Medinë pas lidhjes së marrëveshjes së Hudejbijes). **“Nëse ata (muslimanët) ju kërkojnë ndihmë në fëmë, e keni për detyrë t'i ndihmoni, përveç se kur bëhet fjalë ndaj dikujt që ju i keni dhënë besën më parë.”** (Kur'an) Këto rite dhe rregulla që janë dhe shtyllat e fesë, janë

domosdoshmërisht edhe shtyllat e moralit.

Ashtu si dhe morali nuk mund të plotësohet larg këtyre obligimeve, po ashtu dhe ato nuk do të kenë vlerë larg moralit që është dhe qëllimi final i tyre.

Ja pra, si Islami ndërtohet mbi baza që për qëllim kanë përmirësimin e moralit dhe detyrimisht përmirësimin e njeriut.

“Ka shpëtuar kush e pastron veten e tij dhe ka humbur kush e njollos atë.” (Esh-Shems: 9-10)

Ibn Kajjimi thoshte: “Meqë feja përkufizohet si moral i mirë, kjo do të thotë se kush ta kalon në moral, ta ka kaluar në fëmë”.

Sikur fjalët e mësipërme të kishin dalë nga goja e ndonjë filozofi apo të një sociologu, ndoshta nuk duhet të na tërhiqnin vëmendjen, se kjo është dhe fusha e veprimtarisë së tyre, por kur dalin nga goja e Pejgamberit që ishte komandant ushtrie, kryetar shteti, diplomat dhe negociator, atij që përcolli një fëmë që hyri në të gjitha detajet e jetës... kjo duhet të na bëjë përshtypje, ashtu siç duhet ta shohim më seriozisht fjalën përmbledhëse të misionit të tij në tokë: *“Jam dërguar për të plotësuar moralet dhe virtytet e mira”.*

Burimet e moralit në Islam

Para se të flasim për këtë çështje, mendoj se duhet sqaruar se në konceptin islam morali ndahet në moral të trashëguar me burim “fitoren” dhe në moral të fituar.

Morali i fitres është morali që njeriu e ka të fituar pa mundin dhe përpjekjen e tij, e bën natyrshëm pa u sforcuar dhe Islami këtu vetëm sa e nxit dhe e sensibilizon njeriun që të mirën ta bëjë për Zotin dhe të keqen ta lërë për Zotin, pasi fitra mund të trashëgojë edhe morale negative. Këtu mund të përmendet kur Profeti [sal-lall-llahu alejhi ve sellem] i tha Eshexh ibn Kajsit: *“Ty të janë dhënë dy cilësi që Zoti dhe Profeti i Tij i duan: mençuria dhe mosnxitimi”.* Apo kur Ebu Bekri tregon se nuk e kishte pirë asnjëherë alkoolin sepse donte të ruante nderin dhe burërinë e tij.

Ndërsa morali i fituar është edhe fusha e betejës, por edhe tema e diskutimit tonë. Ai është më i vështiri, por dhe më i shpërblyeri. Ai kërkon vetëdije, përpjekje individuale, por edhe ndihmë shoqërore, e mbi të gjitha hyjnore. Për këtë u dërguan fetë, u lodhën pejgamberët, zbritën librat... për të mbështetur dhe zhvilluar anën e mirë të fitres njerëzore.

Në aspektin islam, morali i mirë është prej Zotit, pra me burim hyjnor. Fitra dhe mendja të bashkuara për mirë mund të shkojnë deri diku, por nuk e përshkojnë deri në fund rrugën për tek “njeriu i mirë”. Elementi i tretë i domosdoshëm është feja, pra ndërhyrja hyjnore. Prandaj edhe bazat e moralit

islam shihen pak më ndryshe nga që mund të jenë në filozofitë dhe teoritë tjera.

Kur'ani - burimi më i madh i moralit të mirë

Kur'ani është libri i Zotit i zbritur për njeriun që e ndjen veten të gjallë, për njeriun që mendon, që kërkon gjithmonë të vërtetën, kërkon atë që i përmbush emrin njeri: **“... për të paralajmëruar ata që janë gjallë dhe të përligjet dënimi për jobesimtarët.”** (Jasin: 70)

Me gjuhën e tij të qartë e tërheqëse, me ëmbëlsinë e tij që edhe kundërshtarët nuk i rezistonin, Kur'ani ndikoi fuqishëm në mbjelljen dhe ushqimin e moralit, diku në formë të përgjithësuar e diku tjetër në formë të detajuar. Prandaj dijetarët islamë thonë që kur të dëgjoni thirrjen kur'anore **“O ju që keni besuar”**, kini vëmendjen se bëhet fjalë ose për një moral të mirë që duhet ta zbatoni, ose për një moral të keq të cilit duhet t'i largoheni. **“Ky Kur'an udhëzon tek ajo që është më e mira dhe më e drejta.”** (Isra: 9)

Nëse ky Kur'an lexohet me mendje dhe zemër dhe jo vetëm me gojë, ai të dhuron urtësinë dhe peshoren me të cilat njeriu e matë më vonë të mirën dhe të keqen dhe pozicionohet ndoshta edhe pa u menduar gjatë.

Përderisa ky Kur'an është i pandryshueshëm, ai nuk pranon edhe ndryshimet në sistemin moral, sado që të ndryshojë jeta, ai nuk “dorëzohet” para një morali të keq me arsyetimin se është bërë pjesë e jetës moderne apo të lëshojë pe në një moral të mirë me arsyetimin se është démodé dhe një barrë e rëndë. (Shënim: Po flasim për moralin dhe jo për zakonet)

Shembuj nga Kurani famëlartë

“Trego butësi, urdhëro për të mirë dhe largohu prej të paditurve.” (A'raf: 199)

“Zoti urdhëron për drejtësi, punë të mira dhe ndihmë të afërmve, e ndalon imoralitetin, punët e këqija dhe padrejtësinë. Zoti ju këshillon me shpresë se do përkujtoheni.” (Nahl: 90)

“Dhe mos prishni në tokë pasi ajo është vënë në rregull...” (A'raf: 56)

(Për më shumë mund të lexohen ajetet e sures Mu'mininun 1-11; Furkan 63-76; Mearixh 19-35 etj.)

Tradita e Profetit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]

Tradita profetike është përkthimi praktik i Islamit dhe është modeli i gjallë i prekshëm i sistemit të tij moral.

Me veçorinë e tij si i edukuar prej Zotit, me morale të larta të dëshmuara nga miqtë dhe armiqtë e tij, Profeti [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ishte një shembull i gjallë i asaj që Islami kërkon të mbjellë

në tokë.

Fjalët domethënëse edhe pse shpesh koncize të profetit, sjellja, ecja e madje dhe heshtja apo fytyra e tij, u bënë burim frymëzimi për shumë e shumë dijetarë që më vonë patën një thesar të madh për ta sqaruar e për t'ua servitur njerëzve.

Një përshkrim i shkurtër i etikës profetike

Profeti i Zotit nuk ishte i ligë e as gojë pistë. Asnjëherë nuk kishte përdorur fjalë të rëndomta. Edhe atëherë kur donte të sqaronte diçka, huazonte fjalë të largëta që njeriu i mençur i kuptonte. Asnjëherë nuk u kishte bërë titur shokëve, shoqëruesve apo grave të tij, por thjesht mjaftohej duke u thënë: Sikur ta kishe bërë kështu.

Fëmijët e vegjël e merrnin për dore dhe e çonin ku të donin, e ai nuk mërzohej. Kur takonte dikë e shihte në sy dhe tjetrin e shoqëronte me shikim saqë i dukej se është njeriu më i dashur në zemrën e profetit. Nuk e hiqte dorën pa e hequr tjetri dhe nuk e shmangte fytyrën pa u larguar tjetri. Gjithmonë në mexhlisin e tij kishte vend për të ardhurin dhe kur dikush nuk kishte ku të ulej, profeti i zgjaste rrobën e tij. Nuk i kishte shtrirë asnjëherë këmbët para shokëve të tij. Ishte i butë, ftonte për butësi dhe thoshte se Zoti e shpërblet butësinë më shumë se çdo gjë tjetër. Ishte njeriu që buzëqeshte më shumë se të gjithë, por asnjëherë nuk kish qeshur me gojën plot.

Ishte bujar i rrallë dhe këtë e bënte pa u sforcur, duke thënë se ishte urdhëruar për bujari.

Ishte fytyrë ëmbël, natyrë e lehtë, jo i rëndomtë, jo i ashpër, as i rëndë në kritikë e as i tepruar në të lavdëruar. I pëlqente t'i thërrasë njerëzit me emrat që atyre ju pëlqenin; nuk ua priste fjalën derisa të mbaronin. Kur i erdhi për vizitë delegacioni i Abisinisë, u ngrit në këmbë duke iu shërbyer me dorën e tij, duke thënë se këta na i respektuan shokët.

Me një modesti të admirueshme i bënte njerëzit të ndiheshin mirë pranë tij, duke u thënë se ishte i biri i një gruaje që hante “kadiid” (një ushqim tradicional i Mekës).

Kur po çlironte Meken, koka e tij prekte shpinën e devesë nga modestia.

Kush e shihte nga larg, e madhëronte; kush e takonte, e donte dhe kush kishte qenë shoqërues i tij, e kishte të vështirë të jetonte pa të.

Ky është Pejgamberi që u kishte shkruar letra mbretërve persë e romakë, e nga ana tjetër, me dëshirën më të madhe, i veshur me rrobën e tij të thjeshtë, ulej në dyshemenë e shtëpisë që fëmijët të kënaqeshin të hipur mbi shpinën e tij.

Ky është njeriu të cilin Zoti e solli shembull dhe model për besimtarët.

Jeta e njerëzve të mirë - burim frymëzimi në çdo kohë

Gjithmonë ka pasur njerëz që janë munduar të përmirësohen për çdo ditë. Gjithmonë ka pasur njerëz që kanë kuptuar se ka më shumë rëndësi të bësh një gjest të thjeshtë të mirë sesa të mbash disa leksione për moralin dhe teoritë e tij që janë të pafundme. Në këtë grup mund t'i rendisim fare mirë shokët e Profetit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe njerëzit e mirë të brezave pasardhës, të cilët vunë në jetë një parullë shumë domethënëse: "Vepra e një njeriu para një mijë të tjerëve ka më shumë vlerë se fjalët e një mijë njerëzve drejtuar një njeriu".

Kur e pyetën Muavijun se pse sillte mësuës për t'i lexuar fëmijës së tij të vogël historitë e heronjve, u përgjigj shkurt: "Sot i dëgjon, nesër i zbaton".

Me sa duket, njeriu gjithmonë ka nevojë për një model dhe nëse nuk frymëzohet nga njerëz të mirë, ai do të frymëzohet nga njerëz që nuk mund të quhet të tillë.

Familja dhe shoqëria - edukator që nuk neglizhohet

Ndoshta kur rritet njeriu e sheh veten shpesh të panevojshëm për familjen e tij, e cila tani për të "nuk merr erë nga jeta", apo dhe për shoqërinë e cila sikur e kufizon me gjykimin moral që i bën atij. Por nuk duhet të harrojmë se familja ka një vend të veçantë në sistemin moral të këtij njeriu edhe pse ai nuk e ndjen diçka të tillë, ndoshta për faktin se pjesa më e madhe e vlerave dhe virtyteve formohen tek njeriu në moshën e fëmijërisë. Prandaj edukimi i një fëmije për familjen e tij është amanet dhe korigjimi i një sjelljeje të individit për shoqërinë është obligim dhe tek e fundit feja është këshillë.

Veçoritë e moralit islam

Nuk bëhet fjalë për një moral krejt ndryshe nga ç'flasin njerëzit, apo për një sistem moral që funksionon vetëm brenda muslimanëve. Bëhet fjalë për veçoritë e moralit në këndvështrimin islam, si dhe për kriteret që e mbajnë atë në kufijtë e duhur.

Moral hyjnor

Këto morale e kanë burimin në fenë e Zotit, prandaj edhe quhen hyjnore dhe për qëllim kanë lartësimin e njeriut dhe kënaqësinë e Zotit dhe prapë mund të quhen hyjnore.

Moralet islame duhet të jenë në përputhje me misionin për të cilin u krijua njeriu (mëkëmbës i Zotit) dhe në harmoni me "dorëzimin universal" të krijesave para Zotit.

Njeriu i këtij morali e ka të qartë objektivin e tij: kënaqësia e Zotit.

Ky njeri jeton në këtë botë, por nuk e ka atë qëllim

në vete, mundohet ta shfrytëzojë ai atë dhe jo anasjelltas, mundohet ta ketë në dorë dhe jo në zemër.

Ky njeri e bën të mirën pa u kërkuar njerëzve shpërblim, nuk u bën keq atyre pa kërkuar lavdërim. Ky njeri e di se siç duhet të thërrasë tek e mira, të ndalojë nga e keqja, t'i mësojë njerëzit, po ashtu duhet të gërmohet të heqë pengesën nga rruga e tyre se kjo është feja e tij...

Moral i natyrshëm

Përderisa njeriu është përzierje e baltës dhe shpirtit, bashkim i "tokës" dhe "qiellit", edhe këndvështrimi i moralit të tij duhet bërë në këto kufij.

Islami nuk e sheh njeriun si një krijesë të pagabueshme të ngjashëm me melekët, prandaj nuk ka vënë para tij një sistem moral që vetëm në ëndërr mund të realizohet. Por, nga ana tjetër, nuk e sheh njeriun si një gjallesë tokësore, që t'ia lejojë çdo lloj morali që toka ku jeton mund t'ia kërkojë. Njeriu është një përzierje mesatare dhe prandaj morali islam është mesatar, as ideal por as dhe pragmatist. Në këtë sistem moral ka vend për trupin, ashtu siç ka vend për shpirtin. Por duhet pranuar se ky ekuilibër është i vështirë dhe nuk vjen jashtë fesë së Zotit dhe pa ndihmën e Tij, prandaj ne lutemi pa ndalë: ***"Udhëzoni në rrugën e drejtë"***.

Moral gjithpërfshirës

Ashtu siç është Islami fë gjithpërfshirëse, po ashtu dhe morali i tij është i tillë.

Ai u drejtohet të gjithë njerëzve, pa përjashtim; i drejtohet individit dhe shoqërisë, u drejtohet të gjitha fazave dhe gjendjeve të jetës njerëzore. Ashtu siç flet për marrëdhëniet e njeriut me Zotin, flet për marrëdhëniet e njeriut me njeriun, por edhe të njeriut me veten e tij: "Ki drojën Zotin kudo që të jesh, të keqen pasoje me të mirë që të fshihet dhe me njerëzit sillu mirë".

Qëllimi nuk e justifikon mjetin

Islami nuk bie dakord me parimin makiavelist, se qëllimi i mirë e justifikon mjetin, edhe kur ai mund të bëhet praktikë e përditshme. Nëse qëllimi është i pastër dhe për Zotin, edhe rruga drejt Tij duhet të jetë e tillë: "Zoti është i pastër dhe nuk pranon vetëm se të pastërtën".

Duke qenë të bindur se përveç përpjekjes njerëzore në përmirësimin moral ka dorë patjetër dhe ndihma e Zotit, e mbylli këtë punim me duanë e Profetit që u dërgua model për moralin: "Zoti im, më udhëzo drejt moralit më të mirë, se askush veç Teje nuk më udhëzon më mirë se Ti. Largoje prej meje moralin e keq, se askush veç Teje nuk ma largon atë".

OBJEKTIVAT E SHERIATIT ISLAM (2)

ETAPAT E ZHVILLIMIT

Myslmanët e kanë kuptuar rëndësinë e objektivave të sheriatit islam që në fillimet e historisë së tyre. Për këtë arsye i kushtuan një vëmendje shumë të madhe kësaj dije. Mendojmë se myslimanët me këtë lloj përkushtimi ndaj kësaj dije ia kanë kaluar çdo lloj përkushtimi tjetër ndaj legjislativave tjera njerëzore apo fetare. Ky lloj përkushtimi arriti kulmin e tij me specifikimin e shkencës së objektivave të sheriatit islam dhe trajtimin apo konsiderimin e



Mr. Sabahudin JASHARI

studimit të tyre si shkencë më vete. Kjo shkencë, edhe pse në fillim nisi si e shkrirë me shkencat tjera akademike islame, në veçanti me atë të *usul fik'hut* (bazat argumentuese të jurisprudencës islame), aktualisht pothuajse trajtohet si shkencë më vete për të cilën shkruhen vepra të veçanta, programe të posaçme universitare specifike, si dhe i kushtohet vëmendje nëpërmjet kërkimeve dhe disertacioneve të ndryshme. Prej disa kohësh kësaj disipline i është kushtuar vëmendje akoma dhe më e madhe nga ana e kërkuesve, studiuesve dhe dijetarëve, kështu që ç'do ditë e më shumë pasurohet dhe evoluon në mënyrë konsekuente.

Kërkimi dhe studimi i myslimanëve në këtë fushë ka kaluar nëpër tre etapa qartësisht të dallueshme.

Etapa e parë: Në këtë etapë dijetarët e jurisprudencës islame dhe të *usul fik'hut* (bazave argumentuese të sheriatit islam) kërkonin dhe studionin në fushën e objektivave të sheriatit islam duke mos e emërtuar atë me emrin “objektivat e sheriatit” por me emrin “Kauzat e sheriatit”, “Urtësitë e sheriatit”, “Sekretet e sheriatit” apo emërtime të ngjashme me to. Kërkimi i tyre në këtë disiplinë vinte si rrjedhojë e kërkimit të tyre në çështje të tjera të ndryshme dhe

në formë jo dalluese nga subjektet e tjera. Kjo etapë vazhdoi përreth katër shekuj.

Treguesit e parë të kësaj disipline, nga koha e sahabëve deri në fillim të shkrimit të dijeve (kompozimit), viheshin re në formën e nënkuptimeve dhe deduktiveve të urtësisë së sheriatit, si dhe kauzave të dispozitave specifike të këtij sheriatit. Kur shkrimi (kompozimi) i dijeve përparoi, evoluoi bashkë me të edhe kjo disiplinë, pjesa më e madhe e së cilës u inkor-

porua në disiplinën e *usuli fik'hut*. Në këtë etapë termat “Ilëlu-sheriah” (kauzat e sheriatit), “Esrarush-sheriah” (sekretet e sheriatit), “Mehasinush-sheriah” (bukuritë e sheriatit) filluan të përdoren në librat dhe veprat e kësaj dije, madje u shkruajtën edhe vepra specifike që si tituj të tyre u përdorën këto terma. Mbase nga më të dalluarit e dijetarëve që vepruan kështu janë El-Hakim al-Tirmidhiu (shekulli i tretë), Abu Mensur Al-Maturidiu (333 hixhri), Abu Bekër Al-Abheriu (375hixhri) dhe Abu Bekër Al-Bakil'lanu (403 hixhri).

Etapa e dytë: Në këtë etapë kërkimi në fushën e objektivave të sheriatit evoluoi, duke u studiuar në tema të veçanta të dalluara nga subjektet e tjera të *usuli fik'hut*, por jo të ndara në kapituj apo vepra të veçanta. Në këtë etapë lindi ndarja e shquar, në tre pjesë, e objektivave të sheriatit, objektiva të domosdoshëm, objektiva të nevojshëm dhe objektiva të pëlqyeshëm. Kjo lloj ndarje u bë boshti apo shtylla vertebrale e kësaj disipline dhe e tillë konsiderohet edhe në ditët e sotme. Nga eminentët më të shquar të kësaj etape është Imamul-haremejni Al-Xhuejni (478 hixhri), i cili konsiderohet ideatori i vërtetë i ndarjes së temave të objektivave sheriatike nga

subjektet e tjera të *usuli fik'hut*. Kjo vihet re veçanërisht në librin e tij “Al-burhan”, Imam Abu Hamid Al-Gazaliu (505 hixhri) me librin e tij “Shifaul-Aliil” dhe “Al-Mustasfa”, Imam Fahrudin Raziu (606 hixhri) me librin e tij “Al-Mahsul”, si dhe Imam Sejfuiddiin Al-Aamidij (631 hixhri) me librin e tij “Al-Ihkaam”.

Etapat e tretë: Në këtë etapë dija e objektivave të sheriatit filloi të shkojë drejt dallimit si degë më vete e shkëputur nga degët e tjera të shkencave islame, e lindur nga shkenca e *usuli fik'hut*. Kjo u realizua në mënyrë të përshkallëzuar. Në fillim studimi në këtë fushë realizohej në formë kapitujsh të plotë të dalluar nga kapitujt e tjerë të *usuli fik'hut*, më vonë



duke u veçuar në vepra dhe libra të veçantë, duke u shndërruar kështu në një dije të veçantë si ortak i *usuli fik'hut* dhe jo më si pjesë e tij. Supozohet që kjo etapë të ketë filluar me Imam Izzuddiin Ibn Abdusselaam (660hixhri) me librin e tij “Kauaidul-ihkam fii mesalihil-enaam”. Ky libër thuhet totalisht flet për objektivat e sheriatit islam. Shembullin e Imam Izzudinit e ndoqi edhe nxënësi i tij Shihabbudiin Al-Karafijnë librin e tij “Al-Furuuk”. Më pas erdhi Ibnu Tejmija (727 hixhri) i cili zgjeroi temat e objektivave të sheriatit në librat e tij në përgjithësi, edhe pse nuk i njihet ndonjë vepër e veçantë në këtë fushë. Më pas erdhi nxënësi i Ibnu Tejmijes Ibnul-Kjjim (751 hixhri), i cili zgjeroi edhe me shumë temat e objektivave veçanërisht në librat e tij “Shifaul-Aliil” dhe “I’ilamul Mu’ewekki’iin”.

Kur erdhi Imam Abu Is’haak Ash-Shaatibij (790 hixhri), i bëri një zhvillim cilësor shkencës së objektivave të sheriatit, duke i vënë kësaj dije themelet e një shkence te veçantë. Kësaj çështje ai i kushtoi tërësisht pjesën e dytë të librit të tij të shquar, me titull “Al-Muuafeekat”. Kjo pjesë e këtij libri u konsiderua si një vepër në vete e cila thuhet se bën disiplinën e objektivave të sheriatit një

shkencë të pavarur dhe të dalluar nga shkenca e *usuli fik'hut*. Pas disa shekujsh, në epokën aktuale, vjen Imam Ibnu Ashuuri (1973 e.s.), i cili ftoi për trajtimin dhe studimin e objektivave të sheriatit si shkencë tërësisht më vete. Pra, duke e dalluar atë plotësisht nga dijet tjera. Për këtë ai shkruajti librin e tij të shquar “Mekasidush-sheria el-islamijeh ue mekarimuha”. Sot dija e objektivave të sheriatit është bërë një dije më vete, e pavarur, e cila studiohet në universitete, me programe të posaçme, siç gëzon një preokupim të veçantë nga ana e kërkuesve dhe studiuesve të sheriatit islam.¹

Angazhimi i myslimanëve ndaj shkencës së objektivave të sheriatit ka si qëllim të jenë në dijeni për synimet dhe objektivat që ka All-llahu i Madhëruar nga zbritja e sheriatit në përgjithësi, si dhe nga dispozitat sheriatike specifike në veçanti. Kjo u mundëson myslimanëve konceptim dhe kuptim të drejtë të dispozitave të përfuara nga argumentet e tyre direkte dhe indirekte², kuptim ky i cili përputhet me qëllimin për të cilin janë vënë këto dispozita, siç ju mundëson edhe zbatimin e drejtë dhe të saktë të këtyre dispozitave në aktualitet në atë mënyrë që të çon në realizimin e objektivave të këtyre dispozitave. Sheriati islam dhe dispozitat e tij, me misionin e tij për të orientuar jetën në tokë, është zbritur realisht për të realizuar këto objektiva. Këto objektiva nëse nuk kihen parasysh, mendjet vihen përballë rrezikut të keqkuptimit të dispozitave sheriatike, si dhe vullneti për të aplikuar këto dispozita gabon rrugën. Kësisoj, duke gabuar në të kuptuarit e objektivave të sheriatit, gabojmë edhe në të kuptuarit e sheriatit dhe aplikimin e tij në realitet. Për këtë arsye ky punim ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë nxënësit e dijes në zhvillimin e intuitës së bashkëveprimit me shkencën e objektivave të sheriatit islam, gjë që u mundëson kuptimin e saktë të dispozitave sheriatike dhe aplikimin e drejtë të tyre si tek vetja e tyre dhe në lidhje me prezantimin e njerëzve me këto dispozita.

Fusnota:

1 Shiko për temën e objektivave të sheriatit islam dhe etapat e tij: Muhamed habiib ibn huuxheh-Muhamed Tahir Ibnu Ashur dhe libri i tij Mekasidu Sheria 2/79, Ahmed Raisuni - Nedharijetul-mekasid indel-Imam Shatibij 37, Muhamed Sad Juubij - Mekasidush-sheria el-islamijeh 39,

2 Argumentet direkte: Kur’ani dhe Sunneti. Argumentet indirekte: Ixhmai (konsensusi i dijetarëve) dhe kijasi.

PYETJE DHE PËRGJIGJE (11)

PYETJA: *Hoxhë i nderuar. Ne gjendemi në Perëndim. Vitin e kaluar, pasi u kthyem nga haxhi, një fqinj i jonë jomusliman kërkoi t'i japim ujë zemzemi. Ne i dhamë, sepse nuk patëm guxim ta refuzojmë, që mos të keqkuptohemi. Por pastaj lindi polemika në familje nëse kjo është e lejuar ose jo, ngase në pyetje është uji i zemzemit. A kemi bërë ndonjë mëkat?*



Mr. Bashkim ALIU

të hedhura, të cilat janë sihër-magji. Më kanë thënë se që të ruhem nga sihri duhet të mbajë me vete kokën e gjarprit. A bën të bëj diçka të tillë?

PËRGJIGJA: Fillimisht All-llahu e pranofte haxhin tuaj dhe të gjithë besimtarëve. Ju nuk keni bërë gabim pse i keni dhënë një jomuslimani të pijë ujë zemzemi, sepse Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], para se të ndalohej hyrja e idhujtarëve në Mekë, nuk i ka ndaluar të pinë ujë zemzemi dhe as që ka lënë ndonjë porosi të tillë.

Uji i zemzemit na përkuqton momentet e fillimit të banimit të qytetit të Mekës dhe ditëve të para të Pejgamberit të All-llahut, Ismailit [alejhis-selam], prej pasardhësve të të cilit është edhe Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem]. Po ashtu, Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka folur për vlerën e ujit të zemzemit, duke potencuar se ai është i pastër dhe shërim për njeriun, por e gjithë kjo nuk do të thotë se ky ujë mund të pihet vetëm nga muslimanët.

Është mirë që kur t'i jepet një jomuslimani uji i zemzemit t'i tregohet atij për vlerën e këtij uji, nëse ai nuk ka njohuri, si dhe të bëhet nijet nga muslimani që uji i zemzemit të jetë shërim për zemrën e jomuslimanit nga sëmundja e mosbesimit në të vërtetat islame. All-llahu e di më së miri.

PYETJA: *Unë kam probleme me disa nga të afërmit e mi dhe shpesh gjej në shtëpi gjëra*

serioze në mesin e muslimanëve dhe se akoma muslimanët merren me gjëra të këtilla të liga.

E keqja tjetër është se këto gjëra shpesh ndodhin mes njerëzve të cilët janë në lidhje familjare, që flet se nuk është kuptuar si duhet obligimi ndaj farefisit dhe familjes më të gjerë.

Sido që të jetë, kjo flet se kemi mangësi në kuptimin e drejtë të Islamit dhe në zbatimin e dispozitave islame në jetën tonë.

Po, është e vërtetë se dikush mund të bëjë sihër kundër dikujt tjetër. Me këtë rast duhet pasur parasysh se sihri-magjia është prej mëkateve më të mëdha, që do të thotë se personi që bën sihër ka bërë mëkat nga mëkatet më të mëdha, e në të shumtën e rasteve sihri i çon njerëzit në mosbesim. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] në një hadith të tij na urdhëron që të largohemi prej shtatë mëkateve shkatërruese, e prej tyre e ka përmendur edhe sihrin-magjinë. Së këndejmi, besimtari nuk guxon të mendojë për sihër, e lëre më t'i bëjë dikujt tjetër sihër.

Mirëpo, nëse dikush i bën muslimanit sihër, ai duhet të mbrohet në formë legjitime, gjegjësisht përmes leximit të Kur'anit dhe zbatimit të urdhrave të All-llahut, që janë garancë e dështimit të sihrit. Ndërkaq, format

tjera që i shpikin njerëzit janë jo valide dhe jo të lejuara. Në mesin e këtyre formave të ndaluara janë edhe nuskat, hajmalitë dhe mbajtja e gjërave të këtilla, siç është rast edhe me kokën e gjarprit.

Gjarpri ka qenë simbol adhurimi të disa popujt të vjetër, ndërkaq besimtari nuk guxon të merret me besëtytni të këtilla. Gjarpri nuk mund të sjell as dëm as dobi në kuptim të sihrit dhe mbrojtjes prej tij, andaj nuk duhet kërkuar mbrojtje në kokën e gjarprit, por në Zotin e gjarprit dhe të çdo krijese tjetër, në All-llahun e Madhërishëm.

Thënë shkurt dhe qartë, nuk guxon të mbash kokën e gjarprit me pretekst se mbron prej sihrit. Kjo është e ndaluar-haram. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] ka ndaluar të mbahen dhe të vihen hajmali e nuska, duke potencuar në disa hadithe se kush mban gjëra të këtilla lëshohet prej mbrojtjes së All-llahut dhe u lehet këtyre gjërave. Në një hadith tjetër thekson se njeriu që mban gjëra të këtilla nuk arrin t'i realizojë qëllimet e veta dhe në një mënyrë edhe i bën shok Zotit.

Për atë, duhet ta largosh kokën e gjarprit, t'i drejtohesh All-llahut për mbrojtje, të lexosh Kur'an, t'u përmbahesh rregullave islame dhe të mundohesh të vendosësh raporte të mira me të afërmit, ashtu që t'ua ndërpresësh rrugën për vepra të këtilla të ndaluara.

All-llahu e di më së miri.


PYETJA: *Unë shkova bedel për babain tim vitin e kaluar në haxh, por kur u ktheva disa më thanë se kjo është kotë, sepse njeriut i takon vetëm ajo që e ka bërë vetë. A është e vërtetë se bedeli në haxh nuk ka vlerë?*

PËRGGJIGJA: Fillimisht më duhet të them se Insha'All-llah je shpërblyer për këtë vepër të mirë ndaj prindit tënd, sepse jo vetëm që e ke kryer një obligim që e ka pasur ai obligim ta kryejë, nëse i ka plotësuar kushtet, por kjo është edhe mirësi ndaj tij. Do të thotë se ke sevapin e haxhit dhe sevapin e mirësisë ndaj prindërve.

Bedeli është legjitim. Atë vetë Pejgamberi

[sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e ka legjitimuar, gjegjësisht, duke e bërë haxhin e ka dëgjuar një njeri duke e bërë haxhin për një të afërm të vetin i cili quhej Shubrume. Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] e pyeti se a e ka kryer ky njeri haxhin së pari për vete, kurse ai u përgjigj: jo. Atëherë Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] i tha: "Së pari kryeje haxhin për vete, e pastaj për Shubrumen".

Ky hadith flet qartë se muslimani mund ta bëjë haxhin për tjetrin, pra të shkojë bedel. Dhe ky veprim ka rëndësi e nuk është për kot. Nëse dikush e ka pasur obligim haxhin, por ka vdekur para se ta ketë kryer, e pastaj dikush e bën haxhin për të, personi përkatës lirohet prej obligimit.



Është e vërtetë se njeriut i takon ajo që e ka bërë vetë, por nuk do të thotë se nuk ka shpërblim edhe për atë që e bëjnë tjerët për të. Kështu, nëse lutesh për të, i vdekuri ka dobi; nëse jep lëmoshë për të, ai ka dobi; po ashtu edhe haxhi është adhurim që kryhet me trup dhe me mjete materiale, që do të thotë se mund të kryhet edhe nga ndonjë tjetër dhe personi për të cilin bëhet nijeti ka dobi.

Nuk ka nevojë njeriu të dëgjojë fjalë djathtas e majtas. Për këto çështje duhet drejtuar burimeve islame. Burimet islame e kanë legjitimuar bedelin për haxh, andaj edhe muslimanit nuk i duhet autoritet tjetër.

All-llahu e di më së miri.

SI U NJOFTUAN ME ISLAMIN DY MOTRAT BINJAKE

Dominique Jocelyinne Kaenzig dhe Daniella Storm Kaenzig janë dy binjake identike. Të dyjat besojnë fuqimisht në Zotin, kurse njëra prej tyre është muslimane. Përndryshe njëra-tjetrës i ngjajnë sikur veja-vesë.

Dominique Jocelyinne Kaenzig:

Daniella dhe unë ishim dy fëmijë të gjallë dhe gjithmonë binim në telashe derisa u rritëm. Prindërit u ndanë kur i kishim vetëm dy vjet, kështu që disa vjet ishim vetëm me nënën. Përkundër kësaj, të gjitha kujtimet e mia ishin të mira, madje edhe kur duhej të ndanim problemet dhe vështirësitë. Kur është në pyetje karakteri, unë isha më burrëreshë, kurse Daniella ishte vajzë e vërtetë. Sot është krejtësisht kundërt!

Jemi shumë të lidhura dhe asnjëherë nuk jemi ndarë, deri në fillim të shkollës fillore. Atëherë na ndanë dhe na vendosën në klasa të ndryshme, sepse mësuesit konsideronim se mjaft shihemi në shtëpi. Kjo ishte vështirë për ne dhe në çdo pauzë dhe pushim ne takoheshim njëra me tjetrën dhe qëndronim bashkë aq sa mundeshim. Ashtu siç rriteshim, miqësia jonë shtohet edhe në shtëpi edhe jashtë saj. Secila prej nesh zhvillonte rrethin e vet të shoqërisë.

Telashet tona fëmijërore nganjëherë ishin të rrezikshme, sikur ajo atëherë kur vendosëm të luhatem në kolovajzë në kopsht. Kështu ramë të dyja dhe u alivanosëm. Mua mu kthye vetëdija më parë dhe kisha një vrugë në ballë nga e cila rridhte gjak. Daniella kishte një vrugë edhe më të thellë nga e cila kullonte gjak. Hymë në shtëpi ta kërkojmë nënën dhe më kujtohet se Daniella mernte jastëkët një nga një nga krevati dhe fshinte gjakun nga fytyra. Asnjëherë nuk e kisha të qartë pse e bënte atë. Urgjentisht na dërguan në spital, por ja përjetuam që t'ja rrëfejmë këtë tregim.

Derisa rritesha, gjithnjë bisedoja me Zotin dhe i lutesha Atij. Kur për herë të parë fillova të mësoj për Islamin, lutjet e mia u bënë më intensive. Falë Zotit, në fillim të muajit Ramazan të vitit 2002 u bëra muslimane. Kërkimi im i diturisë

filloi pas bisedës rreth fesë me një shok të shkollës i cili ishte musliman. Gjithçka që thoshte ai kishte kuptim. Vazhdoi të bisedojë me mua, ditë për ditë, ashtu që mundesha të parashtrij pyetje aq sa dëshiroja. Kalova një vit të tërë duke studiuar Islamin dhe duke biseduar me muslimanët para se të vendosi të bëhem muslimane.

Familja ime ishte me të vërtetë diçka e pabesueshme. Një ditë erdha në shtëpi dhe i thashë nënës time se mendoj që Islami është feja e vërtetë, por nuk isha e sigurt. Para se të vazhdoj të flasë, ajo tha: “Ndiqe zemrën tënde”. Dhe kjo ishte pikërisht ajo që bëra. Tri motrat e mia, nëna dhe njerku më dhanë përkrahje të madhe, gjë që më ndihmoi ta kuptoj rëndësinë e dashurisë së pakusht.

Babait tim të vërtetë iu desh më shumë kohë për ta pranuar fenë time. Gruaja e tij është braziliane dhe ka lindur në një familje muslimane, por nuk praktikonte fenë. E dhembshme është se përvojat e saj e kishin kthyer kundër Islamit, por kjo është vetëm argument se të gjithë duhet të fokusohemi te Islami, e jo në sjelljet e myslimanëve.

Unë kisha fatin që shumë njerëz më ndihmuan ta gjej Islamin dhe të mësoj për të. Në fillim gjithçka ishte emocionale dhe kisha dëshirë që brenda natës të bëhem muslimane e përsosur, ashtu që u përpoqa që gjithçka të ndryshoj përnjëherë. Kur kjo u bë e vështirë, isha e tërbuar, por shpejt u lirova dhe fillova t'i bëj punët në mënyrë të arsyeshme.

Asnjëherë nuk kam qenë kaq e lumtur siç jam tani. Çdoherë kur të ndryshoj diç në jetë për shkak të Islamit, ndjehem më afër All-llahut, dhe kjo është një ndjenjë e papërshkrueshme. Kur fillova të fal namazin, u ndjeva aq mirë dhe ndjeva qetësinë dhe kënaqësinë të cilën asnjë lutje më parë nuk ma kishte dhënë.

Daniella dhe unë kalonim shumë kohë duke biseduar për fenë. Kurdo që mundesha, debatoja me të për Islamin, sepse me të vërtetë dëshiroja që edhe ajo ta gjejë atë që e kam unë. Ajo ishte burim i madh për mua dhe përkrahja e saj asnjëherë nuk është dobësuar. Kur vendosa të

mbajë hixhabin ajo më jepte kurajë dhe gjithmonë kur dilnim jashtë sillej në mënyrë mbrojtëse ndaj meje. Veshja e hixhabit ishte një betejë. E dija se duhet ta bëja këtë, por krejt kjo më bënte mjaft nervoze. Atëherë një natë e luta Zotin që të ma lehtësojë. Mëngjesin e ardhshëm u zgjova me ndjenjën e qetësisë dhe thjesht vendosa ta bëj atë. U ndjeva aq e lumtur përbrenda dhe më kujtohet se kam ecur rrugës me buzëqeshje të madhe në fytyrë, e cila vinte nga zemra ime.

Kur u bëra muslimane, Daniella dhe unë u bëmë edhe më të afërta, edhe pse nuk i bënim disa gjëra të cilat ishim mësuar t'i bëjmë deri atëherë. Mendoj se krejt kjo ka kuptim për të, por ajo mendon se ka shumëçka për të lënë nëse bëhet muslimane dhe se ende nuk është e gatshme për këtë.

Unë ende mendoj se çfarë duhet të bëj në të ardhmen. Në mënyrë afatgjate, shpresoj se do të punoj në fushën e mjekësisë dhe mendoj për punën me fëmijët e vegjël. Më së shumti dëshiroj martesë të lumtur dhe të suksesshme me një musliman i cili praktikon fenë dhe i cili do të më kuptojë. Mendoj se Islami është çelësi i jetës së lumtur. Gjithashtu lutem që motra ime ta ndjek rrugën time dhe besoj se kjo edhe do të ndodhë. Para disa kohëve kishte një problem dhe kur biseduam mbi të, ajo tha: "All-llahu do të na ndihmojë". Unë mendoj se Ai veç më është në zemrën e saj.

Daniella Storm Kaenzig:

Të kesh motër binjake domethënë që gjithmonë të kesh mikun më të mirë pranë. Dominique dhe unë gjithmonë kemi qenë të varura njëra prej tjetrës derisa u rritëm, e të tilla jemi edhe sot. Ishim fëmijë tejet të gjallë dhe nëna jonë ishte e dëshpëruar kur bënim gjëra siç janë nxjerrja e të gjitha sendeve nga dollapi dhe shkundja për dysheme e taketukeve. Njëherë ishte aq keq, sa që nëna vetëm shikoi dhe thjeshtë u kthye nëpër shkallë duke qarë. Madje edhe i fotografonte ato pamje, sepse nuk mund të besonte se kemi bërë një gjë të tillë. Tërë kjo duhet të ketë qenë e vështirë për të, por asnjëherë nuk hiqte dorë prej nesh. Nuk u befasona kur Dominique u bë muslimane, sepse e dija se ajo kërkonte të vërtetën dhe prisja që do të ndodhë kjo. Derisa u rritëm, Dominique gjithmonë fliste se si i mungon diçka. Mendoj se e kuptoj se çfarë ndjente. Islami e ka plotësuar atë zbrazëtim në jetën e saj.

Ndërsa Dominique hulumtonte Islamin, u bë tejet emocionale kur kuptoi se krejt kjo ka kuptim. I

thashë se do ta përkrah, pa marrë parasysh të gjithat, dhe e bëra këtë. Për mua nuk është me rëndësi se çfarë feje ka ajo, sepse ajo edhe më tej është motra ime binjake dhe asgjë kjo nuk do të ndryshojë. Nuk mund të mendoj për anët negative, për faktin se e kam motër binjake dhe kjo për mua ka qenë gjithmonë pozitive. Unë jam më e madhe për shtatë minuta dhe gjithmonë veten e kam ndjerë si motër më e madhe. Por qëkur Dominique është muslimane, është bërë shumë serioze dhe e ndjeshme, ashtu që rolet janë ndryshuar pak.

Karakteret tona janë mjaft të ndryshëm. Thonë se unë kam më shumë vetëbesim dhe ndoshta kjo është e saktë. I dua sfidat dhe shkoj përpara. Me të vërtetë shpresoj se do të inkuadrohem në Policinë ushtarake pas disa viteve, e pastaj ndoshta bëhem police e thjeshtë, por dëshiroj të punoj në Departamentin e kriminalitetit.

Fillimisht isha e interesuar të bëhem avokate, por pasi që punova në zyrën e avokatit, ndryshova mendjen. Kishte shumë letra, kurse unë dua diçka që ka më shumë aktivitet. U inkuadrova në kurs për marinsë, gjë që më dha idenë që të forcoj stërvitjet dhe t'i bashkëngjitem ushtrisë. Kjo ishte e vështirë! Duhej të flinin për tokë, në thasë, pa tenda, dhe gjithkrah kishte insekte dhe merimanga. Duhej të flija me dorë në gojë dhe me kokë të mbështjellë që t'i pengoj të më ecin nëpër fytyrë.

Ambiciet e mia janë më ndryshe se ato të motrës, por kjo nuk ndikon në lidhjen tonë. Mendova për Islamin, por nuk iu përkushtova realisht studimit të tij. Zotit i lutem çdo natë dhe besoj në Të. Edhe lutjet e mia janë të ngjashme me ato të motrës. Kohën e fundit fillova të shfrytëzoj një nga sexhadet e motrës dhe i lutesha Zotit në të njëjtën mënyrë siç bën ajo. Kisha edhe një mik të afërt musliman. Edhe pse ai nuk e praktikonte fenë, bisedonim mbi atë se si të mësojmë më shumë për Islamin. Por edhe nuk shkonte në atë mënyrë. I respektoj shumë muslimanët dhe motrën time, dhe jam shumë krenare për shkak të guximit të saj, sidomos qëkur vendosi të mbajë hixhabin. E respektojnë mjaft të gjithë miqtë e saj. Ka shpirtkëqij të cilët mendojnë se ajo është e çmendur, por të tillët vetëm duhet injoruar dhe nuk duhet t'u lejohet të ndikojnë te ne. Mendoj se pengesa më e madhe për kalimin tim në Islam janë të gjithë ato rregulla që duhet zbatuar. Nuk jam e sigurt se a do të mund t'u përmbahesha atyre.

KUR'ANI BURIM I UDHËZIMIT

All-llahu nuk i ka krijuar njerëzit shkel e shko, e as që i ka lënë mbi tokë të pa udhëzuar. I mençur është ai i cili e kupton urtësinë e ekzistencës së vet, e vazhdon dhe zhvillon jetën me mendjehollësi, e lë këtë botë pas vete pa u nënshtuar e përbuzur.

Qysh herët në histori njerëzit i kanë munduar këto pyetje: Nga kemi ardhur? Si jetojmë? Ku do të shkojmë?

Kur'ani është zëri i të vërtetës më të cilin janë ndërtuar toka e qiejt. Kuptimet e tij janë rreze në të cilat reflektohen kuptimet e Shpalljes së lartë hyjnore. Më këtë Shpallje u ballafaquan të parët dhe të fundit. Përmes këtyre kuptimeve, të gjithë ata që deshën të dinë të vërtetën, arritën të kuptojnë se prej nga erdhën, si jetojnë dhe ku do të shkojnë.

Kur'ani është Libri gjithëpërfshirës i legjislacionit më të madh Hyjnor, për zbatuesin e të cilit Zbritësi i tij ka garantuar lumturi në të dyja jetët, ndërsa atij që i kthen shpinën i është kërcënuar me mjerim në të dyja botët. Ai është Libri i vetëm për të cilin All-llahu ka garantuar paprekshmërinë, ruajtjen nga të shtuarit apo të pakësuarit prej tij, ndryshimin apo shtrembërimin e tij dhe mbetjen e tij në tokë deri sa ta ngrejë atë në fund të jetës në këtë botë. Kur'ani, mrekullia e përhershme e Zotit të Plotfuqishëm, i ka zbritur Pejgamberit të nderuar të Islamit në periudha dhe kohëra të ndryshme, sipas nevojës së njerëzimit. Ajetet e Kur'anit, ashtu siç tërhiqnin zemrat drejt vetes, e pastronin pluhurin e paditurisë (injurancës) dhe i njihnin njerëzit me mëshirën dhe të mirën.

Shumica dëshirojnë të njihen me shkaqet e shpalljes së ajeteve kur'anore dhe të informohen me ngjarjet të cilat u bënë shkak i shpalljes së ajeteve në sfera të ndryshme. Kur'ani i ndershëm përmban shkenca të ndryshme brenda tij,



Hasan BAFTIJARI

“E kur fillova ta dëgjoj Kur'anin, thashë: ‘Sa fjalë e bukur dhe bujare qenka kjo’. Zemra m'u zbut e sytë më rridhnin rrëke. Kjo edhe më shtyu ta pranoj Islamin”.

Omer ibnul Hatab [radijall-llahu anhu]

megjithëse njeriu të cilit ai iu shpall ishte analfabet i cili nuk dinte shkrim e lexim dhe as që kishte shkuar ndonjëherë te ndonjë mësues apo në shkollë. Në Kur'an gjejmë shkenca: Astronomi, Mjekësi, Histori, Gjeografi, Legjislacion dhe Drejtësi, Politikë dhe Strategji luftarake etj. Përmbajtja e Kur'anit këto shkenca të ndryshme është argument i fortë se ai

është Fjalë e All-llahut të Lartësuar dhe shpallje nga Ai, pasi që është absurde që të gjitha këto shkenca të burojnë nga një njeri analfabet i cili nuk di shkrim e këndim. Sikur që edhe ka sfiduar Kur'ani oratorët dhe gjuhëtarët arab për të përpiluar dhjetë sure sikur ai, apo madje të një sureje të vetme, ata nuk arritën ta bënin një gjë të tillë. Ky ishte argumenti më i madh dhe prova më e fortë se Kur'ani është

Fjalë e All-llahut dhe në asnjë mënyrë nuk është fjalë e njeriut.

Sot mediat në botë, me propagandat e tyre të shumta, përpiqen të prishin pamjen e Islamit dhe ta paraqesin Kur'anin si një libër të vjetër. Fuqitë e mëdha, duke përdorur mjetet më moderne, përpiqen të dobësojnë muslimanët dhe të ulin ndikimin dhe përhapjen e Islamit në botë. Në këtë mes ne shikojmë se Kur'ani i shenjtë, duke qenë si një dritë e madhe e Zotit të Vetëm, në mënyrë shumë të qartë paraqet të vërtetën e tij. Kur'ani tërheq pas vetes mendjet dhe kjo është vetëm një nga veçoritë e tij. Kur'ani është një udhëzues që të fton për tek e vërteta, një Libër lutje e përmendje të shpeshta të Krijuesit, emrit të Zotit. Ai ka karakter konstruktiv, sepse ndikon mbi botën ndiesore të njeriut. Kur'ani ndërron dhe rregullon vlerësimin e gabuar të njerëzimit të zhytur në errësirën e mohimit dhe herezisë mbi gjithësinë, jetën dhe njeriun, duke realizuar kështu transformimin më të madh. Kur'ani i magjeps

arabët që nga çasti i parë, pa marrë parasysh a ishin prej atyre që All-llahu ua zgjeroi gjokset për Islamit apo ata në zemrat e të cilëve vuri perde. Nëse e lëmë anash grupin e vogël në fillim të paraqitjes së kësaj feje, te të cilët shkak i besimit të tyre ishte vetë personaliteti i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si bashkëshortja e tij Hadixheja, shoku i tij Ebu Bekri, djali i axhës

dhe mbi të retë në qiell.” (Kur’an, En-Nur: 40) nuk mund të vijë nga një person që vetëm do të kishte imagjinuar stuhinë në det; kjo patjetër ishte shkruar nga dikush që e dinte se çdo të thotë një stuhi në det.

Ky është vetëm një shembull i cili tregon atë se Kur’ani në fakt nuk është i lidhur me një vend apo kohë të caktuar. Pa dyshim, idetë shkencore të

shprehura në të, gjithashtu, nuk e kanë origjinën nga shkretëtirat e 14 shekujve më parë. Kur’ani nuk është quajtur i mrekullueshëm vetëm nga muslimanët të cilët e vlerësojnë, e besojnë dhe janë të kënaqur me të, por ai është quajtur i habitshëm edhe nga jomuslimanët. Çudia më e madhe për ata jomuslimanë të cilët e kanë parë Kur’anin me një sy kritik, ka qenë se Kur’ani nuk ka qenë kurrë ashtu sikurse ata kanë menduar. Ata mendojnë se Kur’ani është një libër i vjetër, i cili e ka origjinën rreth 14 shekuj më parë nga shkretëtirat arabe; kështu ata presin që libri të ketë një pamje të tillë, një libër i vjetër nga shkretëtirat. Më vonë zbulojnë që libri nuk i ngjan aspak



قال تعالى :
(وَقَالَ الرَّسُولُ يَا رَبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ
مَهْجُورًا)

أنواع هجر القرآن : هجر تلاوته ، هجر حفظه ، هجر تدبره ،
هجر التحاكم إليه ، هجر العمل به ، هجر الإستشفاء به .

NANA.COM

Aliu, shërbëtori i tij Zejdi e të ngjashmit me ta, do të shohim se Kur’ani është faktori vendimtar ose njëri prej faktorëve vendimtarë për pranimin e besimit të atyre që besuan në ditët e para të da’ves (thirrjes islamike), atëherë kur Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] nuk kishte krah as pozitë, kurse Islami nuk kishte pushtet e as aleatë. Disa vite më parë, në Toronto tregohej historia e një njeriu i cili punonte në marinën tregtare për të siguruar jetesën. Një musliman i dha atij një kopje të përkthimit të Kur’anit për ta lexuar. Tregtari i detit nuk dinte asgjë për Islamit, megjithatë ishte shumë i interesuar në leximin e Kur’anit. Kur ai e mbaroi atë se lexuari, ia ktheu librin muslimanit dhe pyeti: “A ishte Muhammedi detar?” Ai kishte ngelur i mahnitur nga mënyra se si Kur’ani përshkruante një shtrëngatë në mes të detit. Kur atij iu tha “Jo, në fakt Muhammedi ka jetuar vetëm në shkretëtirë”, kjo ishte më se e mjaftueshme për të. Ai e pranoi Islamit menjëherë. Ky njeri ishte mahnitur me përshkrimin e shtrëngatës në Kur’an, sepse vetë e kishte provuar një diçka të tillë. Ai e dinte se përshkrimi “... një dallgë, mbi të një tjetër dallgë

atij që ata kishin pritur. Për më tepër, nga mendimet e para që disa njerëz kanë është që, përderisa ai është një libër i vjetër që vjen nga shkretëtira, ai duhet të flasë për shkretëtirat vetëm. Në fakt, është e vërtetë që Kur’ani flet edhe për shkretëtirat, imagjinata e tij përshkruan edhe shkretëtirat, por ai gjithashtu flet edhe për detin - apo ç’do të thotë të jesh në një shtrëngatë në mes të detit. Hulumtuesi anglez Kenet Grejk, metodën e lehtë të kuptuarit të ajeteve të Kur’anit e cilëson si shkakun kryesor të depërtimit të tij në zemra dhe thotë: “Në qoftë se Pejgamberi i Islamit do të ishte një filozof sikur Hegeli dhe për përhapjen e Fesë Islame, në vend të rregullave të thjeshta dhe të buta, të parashtronte në Kur’an teori filozofike si ato të Hegelit, do të ishte e pamundur që Islami në botën e para 14 shekujve të krijonte rrënjë dhe të përhapet kaq shumë nëpër botë”. Por, ja, natyra butë e Kur’anit bën që edhe Velid bin Mugire, mohues i Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe i Kur’anit, të detyrohet ta shfaqë dashurinë e tij ose besnikërinë, ku thotë: “Pasha All-llahun, fjala e tij ka ëmbëlsi, në të qëndron një mrekulli, s’ka bukuri mbi të, afër tij çdo fjalë

shkrihet, andaj edhe s'ka fjalë më të lartë dhe asgjë nuk mund t'ia kalojë”.

Ky Kur'an përshkruan përshtypjen që e lë në shpirtrat e atyre që i besojnë dhe në shpirtrat e atyre që u erdhi dituria më parë (Libri i shenjtë) dhe se atyre: **“Prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurët e atyre që i kanë dronë Zotit të tyre, e pastaj me përkujtim të All-llahut u qetësohen lëkurët dhe zemrat e tyre.”** (Zumer: 23) ; **“Kur u lexohet atyre, ata hedhen me fytyra (për dhë) duke i bërë sexhde. Dhe thonë: ‘I lartësuar qoftë Zoti ynë, premtimi i Zotit tonë është i realizuar’. Dhe duke qarë bien me fytyra (kur dëgjojnë Kur'anin) dhe ai ua shton edhe më tepër përruljen (ndaj All-llahut).”** (Isra: 107-109)

Ky Kur'an i siguroi Rilindjes Islame elemente të ekzistencës dhe kompletimit, në atë mënyrë që nuk do arrinin ta formonin njëmijë ministri të propagandës që do të rreshtoheshin për të ushqyer ndjenjat e emocionet dhe mendimet me mijëra filma dhe oratorë vigjilentë të rangut të lartë. Ky Kur'an ishte për Lëvizjen Islame gazetë, radio, libër dhe oratori e saj. Nga ajetet e tij u lëkundën e dridhën breza e breza të stagnuar, më ndihmën e tij i thyen prangat e injorancës së parë dhe ndërtuan një renesancë të re e cila u karakterizua më të vërtetat e veta. Kjo rilindje dhe ky rizgjim nuk u nis dhe ngrit vetëm nga një njeri, në mënyrë që të vdesë bashkë me të, por buron nga thellësitë e shpirtrave të cilët besuan fuqimisht dhe me bindje.

Kur'ani arriti të ketë këtë ndikim tek miqtë dhe



armiqtë përmes sekreteve e mrekullive të cilat i prezantuan dijetarët nga Libri i Zotit dhe sekreteve të amshueshmërisë të cilën ia dha Zoti ajeleve të tij. Adhuresit e mrekullive materiale nuk i pëlqenin këto konsekuenca të ndikimit të tij. Ata thonin duke shpresuar: **“Sikur të ishte ndonjë Kur'an që me të do të ecnin malet, që më të do të plasej toka, që më të do të flisin të vdekurit.”** (Er-Rra'd: 31) Por, JO u themi atyre. Më këtë Kur'an ecin burrat (njerëzit), më të rregullohet toka, më të flasin të gjallët. Ky Libër riformon jetën në modele të reja; shpirtrave ua kthen shikimin e shëndoshë; njerëzit i mbron nga e keqja e djajve, ndyrësitë e të marrëve dhe traditat e injorantëve dhe mohuesve. Ky është Libri i ekzistencës, atë e njuh kush njuh vetveten dhe kush di qëllimin e jetës së vet që nga fillimi e deri në mbarim, përderisa mohuesit do ta kuptojnë të vërtetën nesër nëse nuk e kuptojnë sot: **“... Jo, (ata nuk besojnë) se e tërë çështja i takon vetëm All-llahut. A nuk e kanë të qartë ata që besuan se, sikur të donte All-llahu do t'i drejtonte në rrugë të drejtë të gjithë njerëzit; por ata që nuk besuan, e për shkak të asaj që bënë, do t'i godasë vazhdimisht fatkeqësi e kohës ose do ta rrethojë (fatkeqësia) vendin e tyre deri sa të vijë urdhri i All-llahut. All-llahu nuk e thyen premtimin.”** (Er-Rra'd: 31)

Kur'ani është burim i dritës, mëshirës dhe behar i zemrave. Kjo mrekulli e madhe e Profetit është fjala e shpalljes Hyjnore e cila me ligjet humane dhe të plota e çon njeriun drejt së vërtetës. Kur'ani është i ngjashëm me drurin Tuba (një dru në Xhennet), i cili origjinën dhe rrënjët i ka në Xhennet, ndërsa degët i ka të lëshuara në gjithësi. Pra, njeriu i cili arrin të kapet në njërën prej degëve të këtij druri, vetë do të bëhet një lulishte me dritë dhe gëzim, si dhe në trupin e tij mëshira dhe dashuria do të lëshojnë rrënjë. Ajetet e Kur'anit janë degët e drurit Tuba, kurse një nga këto degë thotë: **“Me njerëzit flisni me të mirë”.** Kur'ani është si një lum që rrjedh nëpër kohë dhe çdokush që e shfrytëzon atë fiton jetë dhe lumturi. Kur lexohet Kur'ani, nga qielli bie shiu i mëshirës dhe bereqeti Hyjnor mbi shpirtin e njeriut. Leximi i Kur'anit duhet të jete me ide dhe logjikë, sepse Kur'ani është recitali më i bukur i jetës dhe përjetësisë. Sado që të përparojë dija dhe shkenca e njerëzimit, njeriu i paraqiten pamje dhe recitale të reja nga ky dokument qiellor.

Secili në Kur'an do të gjejë aq sa vlen ai në të vërtetë.

SFIDAT NË RRUGË

Jetojmë në një kohë të pakohë, siç quhet shpesh në zhargonin

Rrahman B. FERIZI

mbisundim ndaj prirjes egoiste dhe unitalitariste), vetëm atëherë

popullor. Apo më mirë të themi, në një kohë të “pa njerëz” (a nuk ka njerëz të mjaftueshëm sot në botë?!), të pa njerëzi, pa kompetencën themelore të sistemit dhe fenomenit jetësor (vlerat, kriteret, nderi, devotshmëria janë struktur nën ombrellën e fatit absurd).

Dinamika adoleshente dhe euforia aventuriere janë plasuar edhe në kthinat më të errëta aty ku veç imagjinata hyjë...!

Dhe përse të jetojmë, të punojmë, të studiojmë, pyet sot njeriu?

Kur “të gjitha i kanë në dorë” dhe i posedojnë ata që nuk jetojnë virtytshëm, nuk punojnë dhe nuk studiojnë me nderë.

Gjendemi para një udhëkryqi fat(zi)lum dhe ende përgjigje si kemi gjetur vetes, prandaj vuajmë dhe nuk e dimë pse vuajmë, sakrifikojmë kohën dhe jetën në iluzionet që as në ëndërr nuk realizohen...

Dhe prapë nuk e dimë as dhe (si) pse jetojmë, pse jemi ardhur në këtë botë dhe për ku përgatitet fati ynë, si personalitet dhe si tretman njerëzor.

A nuk është sot ky koncept i një pjese të madhe të njerëzve?

Vallë, a ka kështu kuptim rinia, studimi, jeta... e aq më shumë vizioni i së ardhmes?

Patjetër para nesh (si njohës dhe bartës të misionit të së vërtetës dhe revelatës hyjnore) sfidohen dy alternativa:

E para, të ballafaqohemi me amullinë që mbretëron në mënyrë institucionale, ekipore dhe të organizuar, duke u përpjekur të ndryshojmë për të mirë realitetin e tillë.

E dyta, ose të sfidojmë vetveten tonë në raport me blasfeminë kaotike që mbretëron.

Padyshim se ky proces jetësor kërkon një koncept, plan program, metodologji dhe konceptcion shumëdimensional dhe bashkëkohor, kërkon madje edhe njohjen e mirë të natyrës njerëzore, me qëllim të realizimit të misionit tonë si krijesa më sublime e Universit.

Do të arrijmë me sukses të ballafaqohemi vetëm atëherë kur të ngadhënjëjmë ndaj vetvetes (në

do të ndryshojë pozitivisht ambienti që na rrethon, mentaliteti që plasohet dhe filozofia e jetës që interpretohet dhe në pasqyrën e shpirtit tonë do të shëmbëllejë dëlirësia, zemërgjerësia, optimizmi dhe vullneti e kurajoja e çelikusur në manifestimin e përmirësimit kohor e jetësor.

Pas përpjekjes madhështore dhe durimit në sukses do të jemi, me lejen e Zotit, ata për çka u krijuam, kultivues të (vet)besimit, humanitetit dhe aftësisë e shkathtësisë së ndërgjegjes njerëzore.

Nëse çdo njeri e arrin këtë pjekuri në veten e tij, fiton këtë duel në arenën e jetës dhe diplomon në këtë Institucion të edukatës dhe moralit të lartë, atëherë le ta plasojë në familjen, rrethin, shoqërinë dhe tërë njerëzinë; misioni i tij duhet të jetë projektion universal.

Nëse çdonjëri e merr këtë mision me seriozitet, kuptim të thellë dhe kontinuitet koherent, implementuar dhe menaxhuar nga Institucione, ekspertë (ekspertizë) dhe profesionist shkencorë, të sinqertë, sakrifikues dhe vetëmohues, të besuar dhe brumosur me ideale të larta, të armatosur dhe fisnikëruar me dinjitetin hyjnor, do të ndahet barra, do të lehtësohen sirtarët e intelektit të sotëm njerëzor mbushur injorancë, hipokrizi, egoizëm, vullgaritet dhe defetizëm jonjerëzor.

Përkundër tërë asaj që ka kaluar dhe po kalojmë (pasojat fragjile të gjenocidit shtetëror serb, konfuzioni rreth statusit të padefinuar, papunësia dhe perspektiva e zymtë, varfëria ekstreme, dezoorientimi përballë dinamikës së tranzicionit etj.), kemi besim të thellë në Zotin e Madhërishtëm se rinia e jonë do të vetëdijësohet rreth rolit të vet, do të ruhet dhe orientohet drejt udhëzimit të vërtetë, kriterit në moralin fetar dhe traditën fisnike, në origjinalitet e jo huazim të verbër dhe tjetërsim, drejtë vetëbesimit për jetë, studim dhe lumturi në praktikën konstante të elementeve fundamentale dhe absolute të besimit islam, këtij nektari të kopshtit të jetës për të cilin është i etur shpirti njerëzor.

AHMEDITË DHE QELLIMET E TYRE

Megjithëse në trevat tona kultivohet dhe praktikohet

Mr. Shaqir FETAHU

Islami në formë të pastër, viteve të fundit tentohet me të madhe të priset pastërtia e traditës islame të muslimanëve të këtyre trevave, traditë kjo e cila është kultivuar me shekuj të tërë. Këtë mundohen ta bëjnë sekte të ashtuquajtura islame të cilat nuk zgjedhin mjete, duke filluar prej atyre materiale e deri te ato fetaro-politike, me qëllim të shkatërimit të parimeve kryesore të besimit islam, të unitetit fetar të popullatës muslimane, këtu dhe më gjerë, si dhe me qëllim të institucionalizimit të tyre për të vepruar në mënyrë legjitime.

Ndër sektet më të rrezikshme, me destruktive dhe më të deformatuara, e cila me të madhe dëshiron të depërtojë në Ballkan, e në veçanti në trevat ku jetojmë, është sekti Ahmedian, ose siç e quajnë ithtarët e tij “Xhemati musliman Ahmedian”.

Andaj, nisur nga qëllimet perfide dhe destruktive të këtij sektit, si dhe rrezikun që paraqet ky për muslimanët në përgjithësi, nevojitet një kujdes i veçantë dhe një veprimtari mirë e planifikuar me qëllim të njoftimit të opinionit me këtë sekt, duke zbuluar idetë e tij të prishura dhe të devijuara, si dhe qëllimet që fshihen pas tyre.


Formimi i sektit ahmedian

Sekti Ahmedian formohet në nënkontinentin indian në vitin 1889 nga Mirza Gulam Ahmedi, i cili u lind në vitin 1835 në fshatin Kadijan të krahinës Penxhab të Indisë. Emrin e mori në bazë të themeluesit të këtij sektit Mirza Gulam Ahmedi, por në të shumtën e rasteve ky sekt emërtohet edhe me emrin sektit i kadijanëve, sipas vendit ku ka lindur Mirza Gulam Ahmedi.

Ideja për formimin e këtij sektit lind në Londër nga ideologët e kolonializmit të atëhershëm anglez. Idealistët, strategët dhe ideologët e kolonializmit anglez, gjatë përpilimit të planeve dhe strategjisë për pushtimin e vendeve muslimane në botë dhe

për mbajtjen nën pushtimin e tyre, ishin të vetëdijshëm se

muslimanët megjithatë kanë një fuqi lëvizëse e cila është në gjendje t’i bashkojë ata dhe t’i vë në lëvizje kundër çfarëdo force okupuese. Ajo forcë duhet të shkatërrohet me të gjitha mjetet. Kjo mund të arrihet vetëm me një metodë jashtëzakonisht perfide dhe me strategji mirë të planifikuar. Andaj vendosën që në nënkontinentin indian të formohet sektit i cili do të deklarohet si drejtë islam, por që në të vërtetë do të veprojë në deformimin e parimeve akaidologjike dhe juridike-morale të Islamit, duke iu përshtatur mësimëve të kolonializmit anglezo-krishterë. Sipas tyre, vetëm në këtë mënyrë mund të dobësohen dhe të përçahen muslimanët, e me këtë do të mundësohej okupimi i muslimanëve dhe shkatërrimi i ndjenjave të tyre për fenë dhe traditën e tyre. Sekti i



këtuillë duhej të formohej përbrenda muslimanëve dhe bartës të tij duhet të jenë vet muslimanët.

Andaj, për nënkontinentin indian zgjodhën Mirza Gulam Ahmedin, familja e të cilit njihej mirë në krahinën e Penxhabit si proangleze dhe tradhëtare e interesave të muslimanëve. Vet babai i Mirza Gulam Ahmedit, Mirza Gulam Murtedi, njihej si shok më i ngushtë i pushtuesve anglez, i cili drejtëpërdrejtë iu ndihmoi atyre që ta pushtojnë Penxhabin - Indi. Këtë e konfirmon vet djali i tij Gulam Ahmedi, i cili sjelljet e këtilla të babait të vet i vlerëson si të ndershme. Pra, Mirza Gulam Ahmedi u josh nga premtimet e anglezëve dhe sipas skenarit anglez shpall luftë kundër Islamit. Nënshtronte popullin duke iu thënë se i ka ardhur Shpallja dhe si i tillë është peygamber. Filloi të përdorë fjalë të Kur'anit duke i komentuar ato në bazë të interesit të tij personal dhe në shërbim të interesave të kolonizatorit anglez. Vdiq në vitin 1908 pas një sëmundje të rëndë në stomak. Qendra prej ku ahmeditë zhvillojnë aktivitetet e tyre është Londra. Ithtarët e tyre më tepër janë të përjashtuar dhe të ndaluar. Numri i anëtarëve të tyre është afër një milion.

Vërtetësinë e gjithë kësaj që u tha më lartë e vërtetojnë vet fjalët e Mirza Gulam Ahmedit, i cili gjatë përhapjes së mësimave të veta të shpikura ka thënë: “E kam parë melekun (Xhibrilin) në formën e anglezit të ri, i cili ishte në vitet e 20-ta të jetës së tij, u ul në karigë, e unë i thashë: “Ti me të vërtetë je personifikim i bukurisë”. Ai tha: “Po”. “Nuk i lejohet muslimanit të ngrit armët kundër anglezëve, për shkak se xihadi është ngritë. Anglezët janë mëkëmbësit e All-llahut në tokë dhe nuk lejohet kryengritja kundër tyre”.

Mësimet e sektit ahmedian

Si çdo sekt tjetër edhe Ahmeditë mundohen të paraqiten si drejtim serioz, duke u munduar të kenë metodën dhe mësimet e tyre. Megjithatë, sado që mundohen të kenë mësimet të bazuara në Islam. qëllimet e tyre antiislame lexohen shumë lehtë dhe shumë shpejt del në shesh destruktiviteti i tyre, për arsye se idetë, e mos të themi mësimet e tyre, bazohen në ide të shpikura nga vet Mirza Gulam Ahmedi, në ide të mësimave krishtere dhe në gënjeshtër të ndryshme që nuk kanë kurrfarë baze fetare e logjike.

Për shembull, disa nga mësimet e Ahmedive janë si vijon:

1. Zoti është ai i cili falet dhe agjëron, flenë dhe zgjohet, gabon dhe ka fëmijë, shndërrohet apo personifikohet në forma të ndryshme. Këtë e shohim nga fjalët e vet Mirza Gulam Ahmedit, i cili ka thënë: “Më thotë Zoti: unë falem dhe agjëroj, flejë dhe zgjohem...” (El Bushra, vëll. II, f. 97).

Pasiqë Zoti ka fëmijë, atëherë vet Gulam Ahmedi është djalë i Zotit. Këtë ata mundohen ta vërtetojnë me fjalët kur'anore ku flitet për Isaun [alejhis-selam]. Sipas zahmedive, këtu është fjala për Gulam Ahmedin. Vet Gulam Ahmedi thotë se e ka thirrur Zoti dhe i ka thënë: “Dëgjo o djali im... ti je prej meje e unë prej teje, shpina ime është ytja”.

Nga ky mësim qartë shihet ndikimi rrënjësor i filozofisë antropomorfiste greke dhe mësimet krishtere mbi Zotin dhe Isaun [alejhis-selam] si djalë i Zotit.

2. Misioni i peygamberisë nuk ka mbaruar, ai vazhdon deri në Ditën e Kijametit, pasi që ekzistojnë probleme dhe turbullira në tokë. E gjithë kjo kërkon të vijnë kohë pas kohe edhe peygamber tjerë. Andaj Muhammedi [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] nuk është peygamber i fundit dhe Mirza Gulam Ahmedi është peygamber që ka ardhë pas Isaut dhe Muhmmedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem]. Ahmeditë shkojnë edhe më larg dhe thonë se Zoti i ka shpallur atij shpallje me emrin “El Kitabul mubin”, i cili sipas disa ahmedive është me i vlefshëm se Teurati, Inxhili dhe Kur’ani.

3. Përveç Mekës dhe Medines, edhe Kadijani, vendi ku është lindur Gulam Ahmedi, është i



shenjtë, bile edhe më i vlefshëm se ato dyja. Prandaj edhe Haxhxi duhet të kryhet në Kadijan, edhe atë madje njëherë në vit.

4. Gjithë njerëzimi do të shkojnë në Xhennet, pa marrë parasysh a janë muslimanë, të krishterë apo jehudë.

5. Xhiahadi - lufta në rrugën e All-llahut është ngritur dhe nuk është obligim për muslimanët. Armiku (anglezët) duhet të respektohen dhe t'u shërbehet atyre, sepse ata janë të zgjedhur nga Zoti për të sunduar dhe qeverisur. Me këtë mësim ahmeditë dëshirojnë të zbusin çdo tentim të muslimanëve për të zhvilluar fenë dhe traditën e tyre dhe për të çliruar vendin nga pushtuesit apo armiku, duke e vënë popullatën muslimane në shërbim të okupesve kush do që të jetë ai.

6. Mësimet ahmediane janë të shenjta të cilave duhet patjetër besuar, sepse janë të frymëzuara nga Zoti përmes Mirza Gulam Ahmedit. Kush nuk beson në këtë ai nuk është besimtarë.

Nga këto dhe shumë mësimet tjera të ahmedive shihet qartë se ata, me qëllim të përhapjes së ideve të tyre të prishura dhe destruktive, shërbehen me hamendje dhe gënjeshtër, me ndikim të mësimëve të huaja, si dhe me devijimin dhe shpjegimin me hamendje të ajeteve dhe haditheve të Pejgamberit Muhammed [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], e në të shumtën e rasteve edhe përmes mohimit të ajeteve kur'anore dhe haditheve të Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] dhe me shpikjen e haditheve të rrejshme. Për ta vërtetuar këtë po sjellim një shembull që shihet nga vet fjalët e Mirza Gulam Ahmedit, të shënuara në veprën e tij me emrin "Izaletul euhan", ku mes tjerash thotë: "E kanë pyetur të Dërguarin e All-llahut për Dtën e Kijametit se kur do të ndodhë ajo. I Dërguari i All-llahut ka thënë: Dita e Kijametit do të ndodhë 100 vjet pas kësaj dite për gjithë njerëzit".

Nga kjo shihet mohimi i ajeteve kur'anore dhe haditheve të Pejgamberit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], si dhe të shërbyerit e tyre me gënjeshtër dhe me shpikjen e haditheve të rrejshme, kur dihet mirë se fjalët kur'anore dhe hadithet e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem] vërtetojnë se kohën e ndodhjes së Ditës së Kijametit e di vetëm All-llahu i Madhërishëm e askush tjetër, e madje as pejgamberi i fundit Muhammedi [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem].

Qëllimet e sektit Ahmedian

Mëgjithëse udhëheqësit dhe ithtarët e sektit Ahmedian janë shumë perfidë në veprimtarinë e

tyre dhe fshihen nën petkun e Islamit dhe deklarohen si muslimanë, qëllimet e tyre shumë lehtë zbulohen.

Qëllimet destruktive të tyre janë të shumta. Marrë parasysh rrezikun e madh që paraqesin ata sot, është me rëndësi të cekën ato që janë më me rëndësi dhe që duhet patjetër t'i dijë çdo musliman. E gjithë veprimtaria e sektit Ahmedian në tërë botën, në të kaluarën dhe sot, bëhet për këto qëllime kryesore:

1. Deformimi dhe devijimi i parimeve akaidologjike (besimore) të Islamit përmes të ideve të reja të cilat burimin e kanë nga mësimet e ndryshme, e në veçanti nga mësimi krishterë dhe mitologjia greke;

2. Dobësimi i natyrës dhe frymës së pastër dhe të fuqishme të parimeve islame në përgjithësi, duke filluar prej atyre të fushës akaidologjike e deri te ato juridike, morale etj.;

3. Futja e ideve të huaja në mesin e muslimanëve dhe përshtatja e Islamit ideve kolonialiste krishtere me qëllim që t'i ndihmohet strategjisë dhe realizimit të platformës krishtere kundër Islamit dhe muslimanëve në përgjithësi;

4. Shkatërrimi i unitetit të muslimanëve dhe përçarja e tyre me qëllim të realizimit sa më të lehtë të strategjive kolonialiste në të kaluarën për mbajtjen nën okupim të vendeve muslimane, ndërsa sot për degjenerimin e tyre në fushën fetaro-morale me qëllim të shkatërimit të muslimanëve dhe Islamit si forcë lëvizëse;

5. Dobësimi i forcës së muslimanëve dhe shkatërrimi i tyre nga brendia e tyre në mënyrë perfide dhe me metoda të ndryshme.

Mënyra e veprimit të sektit ahmedian

Pa marrë parasysh se sa arrin sukses në veprimtarinë e tij, sektit ahmedian vepron pandërprerë në mesin e muslimanëve në tërë botën. Gjatë veprimit të tyre ata përdorin strategji të veçantë, duke i marrë parasysh rrethanat e mesit dhe vendit ku duhet të veprojnë dhe të realizojnë strategjinë e tyre. Kështu, në vendet ku Islami është thellë i rrënjësuar dhe ku vetëdija e muslimanëve është në nivel të lartë ata fshehin idetë e tyre të vërteta, duke përgaditur terrenin për zbulimin e qëllimeve dhe ideve të tyre në masë. Analizojnë mirë terrenin dhe kohën se ku duhet dhe kur duhet të veprojnë. Përgaditja e tyre bëhet në atë mënyrë siç kërkon mesi ku duhet të veprojnë. Propagandën e tyre e zhvillojnë me një demagogji të pa parë, duke përdorur mjete të ndryshme si pasuria,

dhënia e bursave për shkollim, aftësimi i misio- narëve, botimi i literaturës në gjuhë të ndryshme, mjetet informative etj. Në Londër ata realizojnë edhe programin e tyre satelitor përmes të cilit përhapin propagandën e tyre. Kjo tregon se ata kanë pasuri të madhe dhe finansohen nga qarqet perëndimore, e ne veçanti nga anglezët.

Ndikimin e tyre mundohen ta ushtrojnë në:

- rininë e cila është e papjekur dhe e dobët në njohjen e Islamit. Këtë e bëjnë duke përdorur mjete financiare dhe duke iu premtuar të rinjëve bursa për shkollim dhe karrierë në jetën e tyre;
- vendet ekonomikisht të dobëta dhe të varfëra ku njerëzit janë të nevojshëm për kafshatën e gojës dhe për mirëmbajtjen e familjeve të tyre. Përmes të mirave materiale arrijnë t'i blejnë një numër të konsideruar të njerëzve për qëllimet e tyre. Andaj nuk është çudi ajo se suksesin më të madh e kanë arritur në Afrikën Veriore dhe në nënkontinentin indian ku njerëzit më tepër vuajnë nga varfëria;
- në vendet ku emigrojnë njerëzit dhe në mjediset ku më tepër janë prezent refugjatët;
- në vendet ku ekziston zbrazëti shpirtërore, sidomos në vendet e Evropës Lindore ku ka sunduar ideologjia komuniste;

Kohëve të fundit ka tentime të depërtimit të këtij sektit edhe në trevat tona, në mesin e besimtarëve tanë ku vetëdija islame është e dobët. Mirëpo, falë aktivitetit dhe vetëdijes së teologëve-udhëheqësve fetar islam dhe besimtarëve në përgjithësi ata nuk mund të gjejnë fushë veprim në këto treva.

Qëndrimi Islam ndaj sektit ahmedian

Në bazë të ideve të proklamuar nga sektit ahmedian është shumë lehtë të definohen dhe të identifikohen ata. Duke marrë parasysh se ato mohojnë ajetet kur'anore ose i përkthejnë me hamendje, apo marrë parasysh se ata përgënjeshtrojnë hadithet e Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem] dhe merren me genjeshtra, pa dyshim se ky sekt është antiislam dhe ithtarët e tij janë jobesimtarë.

Këtë definim e dhanë edhe dijetarët e kohës kur u paraqitën për herë të parë Ahmeditë me mësimet e tyre. Posa paraqiten në skenë, kategorikisht u sulmuan nga dijetarët e mëdhenj të asaj kohe si: Shejh Senaul-llahu, Muhamed Ikbali, më vonë Ebu Hasan En Nedeviu, Abul A'la Meududiu etj. I njëjti qëndrim ndaj këtij sektit ekziston edhe në kohën e sodit, kur dijetarët islamë janë unanimitë mendimin se ky sekt është jo islam.

Kjo u pa edhe me rastin kur shkrimtari Sallman

Rushdi, përndryshe ithtar i sektit ahmedian, u paraqit me librin "Vargjet satanike", përmes të cilit thellë sulmohen parimet islame dhe fyhet personaliteti pejgamberik i Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-lem].




Pra, sektit Ahmedian është sekt antiislam i formuar nga qarqet angleze me qëllim të shkatërrimit të mësimet të pastër islam dhe të muslimanëve në përgjithësi. Marrë parasysh veprimin e tyre perfid dhe strategjinë e tyre demagogjike, besimtarët muslimanë maksimalisht duhet të kenë kujdes që mos të binë në kurthën e mësimet të tyre të prishur. Për këtë duhet të kenë gjithmonë parasysh fjalët e All-llahut të Madhërishëm i cili në Kur'anin famëlartë thotë:

"Feja e pranueshme tek All-llahu është Islami."
(Ali Imran:185)

"E kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, atij kursesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpruarit." (Ali Imran: 85)

"Ata përpiqen që me gojë të tyre ta shuajnë dritën e All-llahut, e All-llahu nuk do tjetër, pos ta përsos dritën e tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë." (Et Teube: 32)

EBU'L ALA EL- MEVDUDI [1903 - 1979]



Hasan BAFTIJARI

Nëse gjendet ndokund ndonjë personalitet i rrallë i cili meriton të udhëheqë me tërë muslimanët në rruzullin tokësorë dhe i posedon të gjitha elementet e një udhëheqësi në këto kohëra të vështira pas humbjes së Hilafetit, ata do të ishin Hasan el-Benna dhe Ebu ala el-Mevdudi

Omer Telmisani

Ebu'l ala el-Mevdudi është njëri nga thirrësit islam i cili e sakrifikoi tërë jetën e vet në ngritjen e fjalës së All-llahut. Tërë koha i kalonte duke u munduar që të fusë në zemrat e njerëzve dashurinë për All-llahun, Fenë Islame dhe Muhammedin [sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem], duke u munduar që jetën e tyre ta bëjë vetëm për hir të All-llahut dhe Fesë Islame, duke u munduar të vendosë ligjin e All-llahut të sundojë në tokë. Ishte i sinqertë në thirrjen e tij, andaj edhe kishte ndikim të madh tek ata të cilët e dëgjonin dhe përcillnin rrugën e tij. Kishte një ëmbëlsi kur fliste, një shprehje tërheqëse kur shkruante. Ai nuk ishte vetëm që fliste dhe shkruante, por ishte edhe shembull i rrallë kur vepronte. Të gjithë e emëronin si mendimtar islam dhe themelues të Lëvizjes islame. Qëllimi final i tij ishte që të vendosë ligjin e All-llahut të Madhërishëm të sundojë në tokë.

Lindja dhe prejardhja

Ebu'l ala el-Mevdudi u lind më 25 shtator të vitit 1903 në Ornekabad, një zonë kjo e cila është e

lidhur me krahinën Hajdarabat. Familja e tij ishte e njohur me nofkën “fisi Mevdudijeh”. Ata gjithashtu ishin të njohur edhe për nga dituria madhe që e posedonin dhe për shërbimin që e bënin për Fenë Islame. Prejardhja e tij arrin deri te Shejh Kutbuddin el-Mevdudi. Ky i fundit ka jetuar në Indi në vitin 527 hixhrij dhe është shejh i tarikatit Xheshitije. Babai i Mevdudit, Sejid Ahmed Hasan el-Mevdudi, i cili u lind në Dahli të Indisë në vitin 1266 hixhri (1850 m.) përfundoi Universitetin “AL IKRA”, punoi si profesor, e pastaj edhe si avokat. Me 25 shtator të vitit 1903 All-llahu i dhuroi atij një fëmijë të cilin e emërtoi EBUL ALA.

Babai filloi t’i kushtonte një kohë edhe birit të tij për mësim në shtëpi, duke e ruajtur që mos të ndikojnë te Mevdudi i vogël gjërat negative dhe mësimet e huaja. Për këtë arsye ai birin e tij nuk e dërgoi në shkollat angleze por i jepte mësim në shtëpi, duke ia mësuar jetën e Profetit Muhammed, jetën e sahabëve, historinë islame, gjuhën arabe dhe atë persiane, fik’hun islam dhe hadithin e profetit Muhammed. Ai po ashtu e merrte nëpër mexhliset e ndryshme kur takohej me shokët e vet, në mënyrë që edhe Mevdudi i vogël të përfitojë nga këto takime.

Mevdudi u regjistrua në një nga shkollat e mesme dhe përfundoi shkollimin për një kohë të shkurtër. Babai i tij ndërroi jetë sikur i ri, akoma pa arritur t’i ndajë mjaft kohë djalit të tij në dije. Kështu, Mevdudi u detyrua që të marrë përsipër përgjegjësitë e familjes që në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare. Megjithatë ai kurrë nuk u largua nga mësimi i shkencave islame. Nga njëra anë i mësonte këto dije nga burime origjinale, kurse në anën tjetër ndiqte ndodhitë e kohës. Kështu ai e arsimonte veten edhe në fushën islame edhe në fushën e problemeve të kohës.

Mevdudi si gazetar

Mevdudi e filloi veprimtarinë e tij si gazetar islam që në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare, duke e zgjedhur këtë si një nga rrugët e mundshme për shërbimin e Fesë Islame. Në fillim ishte kryeredaktor i gazetës “Taxh”, e pastaj i gazetës “Muslim”, të cilat botoheshin në qytetin Xhebelbur, kurse me vonë filloi edhe veprimtarinë e tij në gazetën “Xhemijeh”, ku edhe ishte një nga themeluesit e saj, e pastaj edhe kryeredaktor në qytetin Delhi. Gjithashtu posedonte edhe një revistë në bashkëpunim me Shoqatën e dijetarëve të Indisë, të cilën e botoi një herë në muaj, me titullin “Terxhuman el-Kur’an”, e cila filloi të botohet në vitin 1923. Kjo revistë e ndihmoi shumë Lëvizjen islame në gadishullin indian dhe vazhdoi të botohet edhe disa vite pasi që ndërroi jetë Mevdudi, duke u njohur si një nga revistat islame më me vlerë në gjithë botën.

Mevdudi kundër shpifjeve të Mahatma Gandit

Mevdudi bëri një angazhim të madh kundër shpifjeve që bënte Mahtama Gandi. Gandi, me këto shpifje, kishte për qëllim që të nxjerrë dyshime kundër Islamit, por Mevdudi në librin e tij të njohur “Diskutimi në Islam” nxori në pah se këto shpifje nuk janë të vërteta. Mevdudi u përpoq shumë kundër kulturës imperialiste të Perëndimit. Ai e vazhdoi këtë përpjekje me dijen dhe besimin e fortë të tij. Gjithë jetën e tij e kaloi duke mësuar shkencat islame dhe për të zgjidhur problemet e asaj kohe. Ai përdori gjithë kohën dhe potencialin e vet për rregullimin e çështjeve politike, ekonomike dhe sociale. Ai dha shumë përpjekje

serioze kundër armiqtë të Islamit, grupeve që kishin mendime të devijuara dhe ndaj grupit Kadijanist; i nxori në pah humbjen dhe jokonsekuencën e tyre dhe i qortoi dijetarët muslimanë për pasivitetin e tyre. Mevdudi ishte shumë i pasur nga dituria që e posedonte dhe njihej për mënyrën e bukur se si e shpjegonte fenë islame në momentet kur ligjëronte dhe kur e shprehte idenë e tij në letër të shkruar. Kishte një respekt të madh nga të gjithë dijetarët dhe mendimtarët islam dhe ata perëndimorë për idetë dhe mendimet të cilat i posedonte.

Dijetarët e asaj kohe ishin shumë të ndikuar nga mendimet e Mevdudit dhe mënyra se si ai vepronte për fenë islame. Omer Tilmisani thoshte: “Nëse gjendet ndokund ndonjë personalitet i rrallë i cili meriton të udhëheqë me tërë muslimanët në rruzullin tokësor dhe i posedon të gjithë elementet e një udhëheqësi në këto kohëra të vështira pas humbjes së Hilafetit, ata do të ishin Hasan el-Benna dhe Ebu ala el-Mevdudi.

Ky mendimtar islam meriton një vend të lartë në mesin e personaliteteve islame, i cili dha një mund të madh në shërbim të fesë islame dhe të muslimanëve, duke u njohur si organizator, ligjërues i rrallë dhe shkrimtar i dalluar.

Ebu ala el-Mevdudi dhe poeti islam Muhammed Ikbali

Në vitin 1932, revista “Terxhuman el-Kur’an” botoi një artikull me titullin “Barteni o ju musliman thirrjen e Kur’anit dhe ngjituni me të mbi gjithë botën”. Ndikimi i Mevdudit me revistën e tij ishte shumë i madh në Indi dhe kjo ishte njëra nga rrugët e cila më së shumti i ndihmoi Mevdudit të përhapë mendimin islam në gjithë Indinë, duke kurorëzuar këtë Lëvizje dhe këto mendime që demonstruoheshin në këtë revistë në fund me partinë politike “Lidhja Islame”. Ndikimi i këtyre ideve u vërejt kur iu bë ftesa që të merr pjesë në Kongresin i cili u mbajt në Linko në vitin 1937, me timitin për të bërë një shkëputje të vendeve me shumicë muslimane.



Pas kongresit vërehej ndikimi i mendimit të Mevdudit te shumica e njerëzve në botën islame. Mevdudi i bëri ftesë poetit dhe mendimtarit të njohur islam, Muhammed Ikbali, në vitin 1937 në Lahore që t'i bashkëngjitet veprimtarisë islame dhe të vazhdojnë së bashku këtë mision. Muhammed Ikbali e pranoi me zemërgjerësi ftesën dhe bëri marrëveshje me Mevdudin për të ndihmuar njëri-tjetrin, ashtu që Islamin ta bënin udhëheqës të jetës. Megjithatë Ikbali ndërroi jetë akoma pa marrë formën e fundit të tij ky punim, duke lënë një zbrazëti të madhe në arenën e mendimit dhe thirrjes islame, andaj edhe këtë shtresë u mundua ta plotësojë Mevdudi.

Themelimi i “Xhema’a Islamije” (Shoqëria Islame) në Lahore

Filloi Mevdudi Lëvizjen islame e cila kishte për qëllim thellimin e fesë tek elita e shoqërisë, siç ishin mendimtarët, filozofët dhe elita islame, duke iu bërë ftesë të bashkëveprojnë në themelimin e kësaj Lëvizje, përderisa edhe e themeluan në Lahore më 26 gusht 1941. Ebu’l ala el-Mevdudi u zgjodh kryetar i saj. Në vitin 1943 qendra e Lëvizjes u transferua nga qyteti Lahore në Daru Selam. Gjatë tërë kësaj kohe Mevdudi aspak nuk u ndal duke shkruar dhe botuar punimet dhe librat e tij, duke vepruar në fushën e thirrjes islame, kur edhe botoi librat që ishin shumë të lexuar: “Katër termet themelore në Kur’an”, “Islami dhe injoranca”, “Feja e vërtetë”, “Bazat e karakterit islam” dhe të tjera.

Me lajmërimin e ngritjes së shtetit pakistanez më 28 gusht 1947, Mevdudi u transferua në Lahore, ku edhe e vendosi qendrën e “Xhema’a Islamije” me shokët e tij. Në janar të vitit 1948, pesë muaj pas themelimit të shtetit pakistanez, Mevdudi e mbajti edhe fjalimin e parë në Fakultetin e drejtësisë dhe kërkoi që ligji pakistanez të vendoset sipas ligjit islam. Në mars të vitit 1948, në Kartashi, mbajti edhe fjalimin e dytë me temën “Kriteri islam për rregullim (ligj) islam”.

Burgimet e Mevdudit dhe gjykimi me vdekje

Xhema’a Islamije në Pakistan filloi t’i bëjë shtypje qeverisë së Pakistanit, duke kërkuar që ligji kryesor i Pakistanit të jetë Sheriati dhe që qeveria pakistaneze të gjykojë sipas ligjit shariatik.

Me 4 tetor të vitit 1948 qeveria filloj t’i kundërshtojë kërkesat e Mevdudit duke e burgosur atë dhe udhëheqësinë e Xhemitit

Islamik. Mirëpo kjo aspak nuk e ndaloi Mevdudin dhe pjesën tjetër të udhëheqësisë nga kërkesat e tyre për një udhëheqësi islame në Pakistan. Pastaj u ngrit edhe populli duke i përkrahur idetë e Mevdudit dhe xhemitit të tij, që Pakistani të udhëhiqet nga njerëz islamistë dhe me ligj islam, duke e detyruar qeverinë që të pranojë kërkesat e Xhemitit Islamik më 12 mars të vitit 1949. Pas një viti, me 28 maj të vitit 1950, qeveria pakistaneze e liroi Mevdudin dhe shokët e tij nga burgu dhe iu dha liri absolute në veprim.

Pas kësaj, më 21 janar 1951, në qytetin Kertashi, Mevdudi i tuboi 31 dijetarë nga lëmi të ndryshme që të diskutojnë për çështjen e qeverisjes së Pakistanit. Me këtë rast ata vendosën disa pika të cilat duhet t’i posedojë qeveria pakistaneze. Megjithatë, qeveria nuk iu dha asnjë përgjigje pozitive, prej nga u kuptua se ajo nuk i ka pranuar kërkesat e Xhemitit Islamik dhe të dijetarëve pakistanez, por ka qenë thjeshtë një lojë për ta qetësuar popullin nga përkrahja e Mevdudit dhe shokëve të tij. Mevdudi nuk u ndal së vepruari për t’i arritur qëllimet e veta në të mirë të Islamit dhe muslimanëve, duke filluar të realizojë takime me popullatën. Mevdudi burgoset përsëri në vitin 1953 dhe dënohet nga gjyqi me dënim për vdekje. Kjo ngjalli reagime të mëdha në tërë botën islame. E gjetur para një presioni të tillë, qeveria pakistaneze e ndërroi dënimin me vdekje për burg të përjetshëm. Por populli pakistanez u ngrit edhe kundër një vendimi të tillë, duke kërkuar që Mevdudi të lihet i lirë. Në vitin 1955 Mevdudi u lirua nga burgu. Ai u burgos përsëri në vitin 1963, për t’u liruuar prapë në vitin 1964.

Përsëritja e fundit

Me 22 shtator të vitit 1979 Mevdudi ishte në Njujork të SHBA-ve për vizitë të të birit. Atje edhe e dha amanetin e fundit.

U fik edhe kjo dritë e cila ndriçonte rrugën e udhëzimit të drejtë për shumë muslimanë, u këput edhe kjo lule në kopshtin e dijetarëve, mendimtarëve dhe themeluesve të mëdhenj, ndaloi të valavitet penda e cila thurte mendime dhe ide për një shoqëri të pastër islame.

Ai me të vërtetë vdiq, por punimet, idetë dhe veprimtaria madhështore e tij është gjallë dhe ende jeton me ne, na mëson rrugën e veprimit islam, na mëson vlerën e të gjykuarit me ligjin e All-llahut.

EUTANAZIA - VDEKJA E MËSHIRSHME

Hyrje

Eutanazia është temë e cila në vazhdimësi gjatë historisë ka nxitur diskutime kontraverze. Çështjet mbi vdekjen ecin paralelisht me çështjet mbi jetën. Vdekja është fakt jetësor dhe nuk paraqet asgjë më shumë se sa fundi i jetës. Medicina bashkëkohore dhe potencialet e saj (madje edhe) të manipulimit me jetën rezultojnë me pyetjet dhe problemet e reja të eutanazisë. Sociologjia dhe shkencat e afërme me sociologjinë vetëm para pak kohe kanë filluar të preokupohen me përcjelljen e veprimtarisë medicinale, e me këtë edhe me problemin e eutanazisë. Eutanazia dhe problemet që vijnë me të ishin në vetë periferinë e ndodhive dhe të intereseve shoqërore.¹

Në vendet evropërendimore rreth eutanazisë me dekada zhvillohen diskutime të ashpra, deri sa te ne në trojet shqiptare kjo temë nuk ka tërhequr vëmendjen dhe interesimin, si të ekspertëve të fushave drejtpërdrejt të interesuara, ashtu edhe të intelektualëve dhe të opinionit të përgjithshëm. Mbi eutanazinë dhe problemet tjera bashkëkohore të civilizimit bashkëkohor duhet diskutuar shkencërisht e intelektualisht dhe nuk duhet heshtur para problemeve të këtilla. Polemikata dhe diskutimet e deritashme zhvillohen rreth tendencave dhe kërkesave konkrete për ligjësimin e eutanazisë dhe të atyre që janë rigorozisht kundër saj dhe atë e konsiderojnë si akt kundërnjerëzor dhe kundërfetar, dhe paraqet pikëpamjen “që e dëmton konceptimin për ruajtjen e shëndetit”.²



Nexhat S. IBRAHIMI

‘Eutanazia’ gjatë historisë

Shprehja ‘eutanazia’³ në përkthimin e fjalëpërfjalshëm do të thotë ‘vdekje e lehtë, e mirë’. Nocioni i eutanazisë, nga paraqitja e saj në histori e deri më sot, është konceptuar dhe trajtuar llojllojshëm, varësisht nga këndvështrimi dhe bindjet e individit, grupit apo të shoqërisë në përgjithësi.

Enciklopedia prestigjioze amerikane për mjekësi dhe shëndet eutanazinë e përkufizon si “metodë apo akt me të cilën te individi që pëson vuajtje të vazhdueshme dhe dhëmbje që pëson nga sëmundja terminale, realizohet vdekja pa dhëmbje”.⁴

Në kuptimin burimor eutanazia përcakton dëshirën dhe lutjen e njeriut për vdekje të mirë, d.m.th. të lehtë, të shpejtë dhe pa dhëmbje. Kuptimi vijues i eutanazisë është kujdesi pozitiv, angazhimi, si dhe kurrimi që vdekja, sa është e mundur, të jetohet pa dhëmbje trupore dhe ngushtësi shpirtërore - duke e respektuar edhe jetën edhe ardhjen natyrore të vdekjes. Kuptimi i tretë i eutanazisë është bashkëkohor dhe krahas dy kuptimeve të para përfshinë edhe kuptimin agresiv, ‘marrjen e qëllimtë dhe të dhunshme të jetës së njeriut.’⁵ Sipas kuptimit të fundit, të tretë, që e përveçton edhe Kisha katolike në dokumentet e veta, mund të lexohet se “me shprehjen eutanazi mendohet në aktin apo në lëshimin i cili, sipas natyrës së vet apo me qëllimin e vet, shkakton vdekjen në mënyrë që kësajsoji të mënjanohet çdo dhëmbje...”⁶

Në kulturën heleniste eutanazia kishte

kuptimin e vdekjes së bukur e të lumtur, kurse në atë greko-romake eutanazia kishte kuptimin e vdekjes fisnike e të guximshme. Në Romën e vjetër nocioni i eutanazisë kishte domethënie praktike duke përcaktuar qëndrimin e njeriut kundrejt vdekjes.⁷

Eutanazia, përkatësisht diç e ngjashme me eutanazinë, është e njofshme edhe në kohën e Muhammedit [sal-lall-llahu alejhi ve sellem], të as'habëve (p.sh. Ibn Ka'bi dhe Ebu Dherri), të Imam el-Gazaliut, të Ibn Tejmijes, të Ibn Kajjim el-Xhevziut e të tjerë.⁸

Në kuptimin modern, emërtimin 'eutanazi' i pari e përdori Frensis Bekoni (1561-1626) në veprën e tij *Organoni i ri*, në vitin 1620. Mirëpo, eutanazinë në njëfarë mënyre e trajtuan dhe kishin mendim të tyre edhe filozofi Monteskie (1689-1755), i cili më 1721 botërisht u angazhua për të drejtën e vetëvrasjes së njerëzve të cilët i kanë kapluar dhembjet; pastaj Tomas Mor (1480-1535), në veprën e tij *Utopia*, i cili propozoi që të sëmurëve të pashërim t'u këshillohet që sa më shpejtë ta lënë këtë botë, d.m.th. të vdesin; si dhe De Montenje e Shekspiri, të cilët mbështetën eutanazinë.⁹ Sipas mendimit të autorëve tjerë 'termin *eutanazi* për herë të parë e futën në përdorim në SHBA në vitin 1872'.¹⁰

Në shekullin XIX nocioni 'eutanazi' radikalisht pëson ndryshim, duke nënkuptuar 'ndihmën atij që është duke vdekur dhe lehtësimi atij që është duke vdekur me ndihmën e personelit mjekësor'.

Disa qarqe, duke u gjetur para kërkesave gjithnjë e më të mëdha të eutanazistëve, pohojnë se "eutanazia, për t'iu shmangur cilësimit si vepër penale e mbytjes/vrasjes, duhet t'i plotësojë së paku dy kushte:

1. Që të privohet nga jeta personi që gjendet në shkallën e vdekjes pa gjasa për shërim dhe

që ky person të ketë vuajtje të tilla të cilat i kapërcejnë vuajtjet që e përcjellin vdekjen e njeriut. Mirëpo, këtë vendim e merr Komisioni i ekspertëve - mjekë, të mbështetur në rregullat dhe në të arriturat e shkencës së medicinës;

2. Për aprovimin e eutanazisë nevojitet edhe kërkesa e qartë e të sëmurit të pashërueshëm që të privohet nga jeta".¹¹

Disa kundërshtarë të eutanazisë thonë se për t'u aprovuar eutanazia duhet të plotësohen tri kushte:

1. Kurrë me siguri nuk mund të mohohet mundësia e shërimit të të sëmurit, sidomos në kushtet gjithnjë e më të mëdha të njohurive medicinale dhe të aparaturës së medicinës moderne;

2. Përkundër masave preventive, nuk mund të evitohen abuzimet në praktikë;

3. E drejta për të jetuar është e drejtë e pacesueshme e njeriut, e cila nuk mund të shkelet në kurrfarë kushte, dhe së cilës nuk mund t'i ikë as bartësi i kësaj të drejteje, sidomos në kushtet kur vendimi i tij është marrë nën ndikimin e dhembjeve të mëdha që i pëson.¹²





Gjatë historisë hasim edhe në rezistencën kundrejt eutanazisë. Betimi i Hipokratit është kundër eutanazisë. Aty pohohet: “... Nuk do t’i jap askujt medikament vdekjeprurës nëse e kërkon, as do t’i jap këshillë në këtë veprim...”¹³

vijon -

Fusnota:

1. Shfletimi i librave sociologjik apo i revistave që trajtojnë punime sociologjike të ne dëfton se eutanazia nuk trajtohet thajse fare. Kohëve të fundit kemi një interesim sipërfaqësor edhe në Kosovë. Shih: Naser Ramadani, Bioetika - Qasjet etike në mjekësinë moderne, Prishtinë, 2002, fq. 134-138 dhe një përkthim: Shahid Athar, Euthanasia - Vdekja e Ndhimuar nga Mjeku, në revistën elektronike “Horizonti”. Shih: www.horizonti.com/artikulli_2002_10_3_0053.php 02-12-25, fq. 3-8.
2. Shih gjerësisht: Esmina Avdibegovic - Osman Sinanovic, Religjisko-eticko-pravni pogled na ljekarsku pomoc u samoubistvu i eutanaziji, në: Grup autorësh, Duhovnost i mentalno zdravlje (më tej: E. Avdibegovic - O. Sinanovic, REPP, DMZ), Sarajevë, 2002, fq. 1. Është indikative se tendencat eutanaziste i mbështesin më së shumti njerëzit jofetarë, sekularistë. Shih: E. Avdibegovic - O. Sinanovic, REPP, DMZ, op. cit., fq. 97-98.
3. Greqisht: ‘eu’ = e lehtë, e mirë dhe ‘thantos’ = vdekja. Letica S. (1985), Medicinska sociologija, Zagreb, sipas: Sipas: Valentin Pozaic, Eutanazija pred zakonom, në: www.ftidi.hr/WPozaic, fq. 1. Milan Vujaklija pohon se fjala “eutanazi” (nga greq, euthanasia) d.m.th. vdekje e lehtë dhe e butë; fikje e jetës pa dhembje të vdekjes; zbutje e vdekjes duke i dhënë të sëmurit narkotikë (që ia jep mjeku vetëm për t’ia lehtësuar, e assesi për t’ia përshpejtuar”. (M. Vujaklija, Leksikon stranih reci i

izraza, Beograd, 1980, fq. 305).

Muslimanët eutanazinë e përkufizojnë si: “Lehtësimi i vdekjes për personin pa shkakim të dhembjes e për arsye të zvogëlimit të vuajtjeve të pacientit, në mënyrë aktive apo pasive.” (Jusuf el-Karadavi, Suvremene fetve (Izbor), Tuzla, 1997, fq. 77).

M. Klaić, Rjecnik stranih rjeci i izraza, Zagreb, dallon tri kuptime thelbësore: 1. vdekja e lehtë, 2. lehtësimi i mundimit dhe dhembjes së vdekjes me anë të narkotikëve e të ngjashme dhe 3. mbytja e të sëmurëve të pashërueshëm. Sipas: Donat Math, Eutanazija, në: www.ffzg.hr, fq. 2.

Sintagmat më të shpeshta lidhur me eutanazinë në literaturën e huaj dhe tonën, sidomos në anglishte, janë si vijon:

- Mercy killing (mbytja nga mëshira) - rëndom ka të bëjë me eutanazinë e bërë nga ana e kushërirëve apo miqëve që t’i lehtësohen dhembjet e të sëmurit;
 - Helping someone to die (ndihmesa dikujt që të vdesë);
 - Assisted suicide (ndihmë gjatë suicidit) - sigurimi i dozës vdekjeprurëse të ilaçeve dikujt kush dëshiron ta përfundojë jetën e tij;
 - D. N. R. - Do not resuscitate (të mos shpëtohet);
 - Palliative care apo hospice approach (kurimi zbutës) - lidhet me lëvizjen Hospice përndryshe të përhapur në Evropën Perëndimore. Mjekët dhe motrat orientohen në zbutjen e vuajtjes së pacientit duke kërkuar rrugë të qetë dhe të thjeshtë deri në vdekjen natyrore.
4. Medical and Health Encyclopaedia, New York, (1972 ?), fq. 359.
 5. Sipas: Valentin Pozaic, Eutanazija pred zakonom, në: www.ftidi.hr/WPozaic, fq. 1.
 6. Shih: Sveti zbor za nauk vjere, Deklaracija o eutanaziji, br. II, në: Pozaic, V., Zivot dostojan zivota. Eutanazija u prosudbi medicinske etike, FTI, Zagreb, fq. 102-103, sipas: Valentin Pozaic, Eutanazija pred zakonom, në: www.ftidi.hr, fq. 2.
 7. Eutanazinë e hasim edhe në shoqëritë primitive, kurse Eskimët edhe sot pleqtë e pafuqishëm i lënë të vdesin në borë. Është interesant se filozofi i njohur grek para e. r., Platoni, mendon se të sëmurët nuk bënë t’i bëhen barrë shoqërisë, ndaj ata nuk duhet shëruar, por duhet lënë të vdesin, që do të thotë se është angazhuar për një lloj eutanazie pasive për shkaqe pragmatike. Shih: Donat Math, Eutanazija, në: www.ffzg.hr, fq. 2.
 8. Buhariu dhe Muslimi (Muttefekun alejh); Ibn Tejmijje, El-Fetava el-kubra li Ibn Tejmijje; Imam el-Gazaliu, Ihjau ulumi’d-din; Ibn Kajjim el-Xhevziz, Zad’ul-meal, pjesa e tretë, sipas: Jusuf el-Karadavi, Suvremene fetve, op. cit., fq. 79 – 80.
 9. Sipas: Donat Math, Eutanazija, në: www.ffzg.hr, fq. 2.
 10. E. Avdibegovic - O. Sinanovic, REPP, DMZ, Sarajevë, 2002, fq. 96.
 11. Sipas: Pravna enciklopedija, 1, Beograd, 1989, fq. 355 - 356.
 12. Pravna enciklopedija, op. cit., fq. 356. Shih: E. Avdibegovic - O. Sinanovic, REPP, DMZ, op. cit., fq. 96.
 13. Përkthimi sipas: Abdul Fadl Muhsin Ibrahim, Biomedicina – islamski pogledi, Sarajevë, 2001/1422, fq. 159. Tërësinë e Betimit të Hipokratit lexojë edhe në: Naser Ramadani, op. cit., fq. 3.

Mbikëqyrje në të gjitha drejtimet

Future Creation Laboratory, pjesë e Olympus-it, prezantoi prototipin e kamerës e cila mund të incizojë video 360 shkallë horizontalisht dhe 50 shkallë vertikalisht në rezolucion të plotë 1080i HD. Projektori përkatës mund të projektojë incizime me këtë kamerë. Kamera është bazuar në thjerrëzat e Olympus-it të cilat avancojnë rezolucionin dhe këndin e incizimit.

Projektori përkatës përmes këtyre thjerrëzave projekton fotografi në sipërfaqe të cilindrit. Kamerat e pajisura me këtë sistem të thjerrëzave janë destinuar për shfrytëzimin për qëllime sigurimi për mbikëqyrje në të gjitha drejtimet.



Transcend 16 GB SDHC

Transcend ka prezantuar kartelën memorike me kapacitet më të madh në treg. Bëhet fjalë për SDHC Class 6 kartelë memorike me kapacitet prej 16 GB. Kartela ka funksionalitet të plotë Class 6, gjegjësisht shpejtësi të garantuar të bartjes së të dhënave prej 6 MB/s. Transcendi përmend se në kartelë është e mundur të ruhen rreth 7.000 JPEG fotografi me rezolucion prej shtatë megapikselë, njëmijë video inserte, madje edhe filma të tërë me rezolucion të lartë. Kartela ka funksionalitet ECC (*error correcting code*) për detektim automatik dhe korrigjimin e gabimeve gjatë bartjes së të dhënave.



Së shpejti SP3 për Windows XP

Testuesit Beta kanë fituar qasjen RC (*release candidate*) të versionit të Service Pack 3 për Windows XP. Megjithatë, shfrytëzuesit do të duhet edhe pak të presin përderisa SP3 të jetë në disponim për *download*. Microsoft-i ka paralajmëruar *service pack*-un e fundit për sistemin operativ gjashtë vjet të vjetër për gjysmën e parë të vitit 2008, me siguri pasi që të jetë i kapshëm SP1 për Windows Vista.

Momentalisht në SP kanë qasje 15.000 testues. Edhe pse SP3 për Windows XP në thelb është grumbull i *hotfix*-ëve në një vend dhe do të duhej të jetë i gatshëm para SP1 për Windows Vista, Microsoft-i me siguri do që të zgjasë publikimin ashtu që t'i detyrojë shfrytëzuesit e XP të kalojnë në Vista.



Gigabyte M704

Gigabyte tajvanez ka prezantuar PC *tablet*in ultrabartës me emrin M704.

Kompjuteri është ngritur me procesorin kursyes të VIA-s me takt C7 1,2 GHz, të cilit i bën shoqëri memoria 768 MB DDR2, e cila nuk është e mundur të zgjerohet.

Ekrani i ndjeshëm në prekje ka diagonalë prej 7 inçeve dhe rezolucion 1024 x 600 pikselë me LED ndriçim nga mbrapa, e këtua është ndërtuar edhe kamera prej 1,3 megapikselë.


Grafika është VIA VX 700 UniChrome Pro e integruar, i instaluar është edhe rrjeti pa tel dhe lexuesi i kartelave memorike, kurse blerësit mund të zgjedhin ndërmjet kapacitetit të disqeve prej 40, gjegjësisht 60 gigabajtëve.

Pesha e aparatit me gjithë bateri rëndon 780 gramë.



Hibridi i desktopit dhe lap topit

NEC ka prezantuar modelin Powermate P5010 - kompjuterin hibrid i dizajnuar që të shfrytëzojë përparësitë e kompjuterit desktop dhe atij lap top. Komponentët e kompjuterit janë të vendosura në shtëpizën e hollë të bardhë e cila në mënyrë optimale shfrytëzon hapësirën, kurse dorëza në majë mundëson bartjen e lehtë. Kompjuteri peshon katër kilogramë, kurse është bazuar në konceptin e një kabloje, gjegjësisht prej kabllave i pranishëm është vetëm kabloja e rrymës. Nga komponentët e instaluar mund të veçohet procesori i AMD-së Turion 64 X2, 2 GB DDR2 memorie, disk prej 200 gigabajtë, si dhe tastiera dhe miu pa tel. Diagonalja e monitorit është 17 inç me



rezolucion prej 1.440 x 900 pikselë me llamba të dyfishta dhe me shkëlqimin NEC Super Shine View. Powermate P5010 i NEC-it paraprakisht është menduar vetëm për tregun japonez, por momentalisht mund të gjendet edhe në Australi me çmim rekomandues të shitjes prej 1.800 dollarë.

USB memoria luksoze

Për të gjithë ata të cilët i duan inovacionet teknike, por në paketim pak më luksoz, ZaNa Design ka prezantuar serinë e USB memorive shtëpizat e të cilave janë ndërtuar prej drurit të posaçëm dhe argjendit, kurse janë zbukuruar edhe me gur të çmuar. Këto memorie të zbukuruara në dorë natyrisht se kanë edhe mundësi standarde - janë kompatible me USB 2.0 Hi-Speed, nuk kërkojnë burim plotësues të mbushjes e as instalim të driverëve, kurse punojnë edhe me Mac dhe Linux. Prej mundësive të posaçme të tyre janë teknologjitë Ultra Safe dhe Ultra Stable, të cilat japin siguri më të madhe të të dhënave të ruajtura dhe i mbrojnë në rast të ndërprerjes së konektimit me kompjuterin.

Memoritë e ZaNa Design vijnë në zgjedhje prej dhjetë modeleve në tre ngjyra të ndryshme. Çmimet në tregun evropian sillen prej 50 euro për modelin prej 1 GB dhe rreth 60 euro për versionin me kapacitet prej 2 GB.

Përgatiti: Agim ABAZI


Magneti nxjerr depresionin

Zbulimi i ri do të mund t'u interesonte 20 deri 40 për qind të pacientëve të cilët nuk janë arritur rezultate të kënaqshme gjatë mjekimit me zbatimin e kombinimit të antidepressivëve dhe psikoterapisë, apo tek ata të cilët refuzojnë marrjen e barnave gjatë mjekimit nga kjo sëmundje.

Stimulimi i qelizave trunore me ndihmën e impulseve të shpejta magnetike nuk është veprim i rrezikshëm dhe do të mund të ndihmojë në luftën kundër depresionit, është rezultati i hulumtimeve të publikuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Ky hulumtim është argument i ri i efektshmërisë së stimulimit transkranial magnetik në mjekimin e depresionit”, mendon kryeredaktori dhe redaktori përgjegjës i revistës *Biological Psychiatry* John Krystal.

Teknika e stimulimit transkranial magnetik përbëhet në stimulimin e korteksit trunor me kalem të posaçëm magnetik i cili vihet në kafkën e pacientit dhe formon fushë magnetike. Më herët është argumentuar se magnetet mund të forcojnë aftësitë mentale. Hulumtimi është zhvilluar gjatë nëntë javëve në 325 pacientë në Kanada, Australi dhe SHBA.



Japonia blen gazrat kristalorë

Për të mbajtur kuotën e cila imponohet nga Protokollin e Kjosos, Japonia nga Hungaria do ta blejë të drejtën e lirim të gazrave të cilat ndotin ajrin. Negociohet me disa vende evropiane.

Kjo blerje e “lejes për ndotje” do të jetë e para në të cilën lëshohet shteti japonez. Ndërmarrjet japoneze, nga ana e tyre, tashmë janë blerës të mëdha të të drejtave për lirim e gazrave që ndotin ajrin.

“Negociojmë me disa vende të zhvilluara në Evropën e Mesme dhe Lindore, sidomos me Hungarinë, Poloninë dhe Çekinë”, ka thënë funksionari i ministrisë së mjedisit Jasuo Takahashi.

“Negociatat tona me Hungarinë janë në fazën përfundimtare. Dëshirojmë ta lidhim kontratën deri në fund të vitit”, ka shtuar ai.

Protokollin e Kjosos, i nënshkruar në vitin 1997, Japonisë i imponon zvogëlim për gjashtë përqind, ndërmjet viteve 2008 dhe 2012, lirim e gazrave me efekte

kristalorë në raport me nivelin e vitit 1990. Por, për shkak të zhvillimit ekonomik, Tokio ka vështirësi në respektimin këtij qëllimi.

Sistemi i paramenduar nga Protokollin e Kjosos kompanive dhe vendeve ndotëse u imponon kuota, por u mundëson edhe blerjen e të drejtës për lirim e gazrave prej atyre të cilët ndotin më pak. Ideja do të arrijë kontrollin, e pastaj edhe të zvogëlojë vëllimin botëror për lirim e gazrave të dëmshme.




U deshifrua kanceri i mushkërive

Strategjia e re e mjekimit është në sipërfaqe. Shkencëtarët kanë identifikuar më tepër se 50 anomali gjenetike të tumorit malinj të mushkërive dhe kanë hapur rrugën e deshifrimit të sëmundjes e cila gjatë vitit vret me miliona njerëz.

Duke analizuar ADN-në në 528 tumore kanceroze, shkencëtarët kanë zbuluar se në të merr pjesë gjeni NKX2-1, për të cilin deri tani nuk kanë dyshuar. Ky gjen gjendet në kromozomin 14 dhe në numër më të madh të adenokarcinomi i mushkërive.

Në SHBA ky lloj kanceri, i cili ka qenë lëndë e hulumtimit, është diagnostifikuar në më shumë se 30 për qind kancerë të mushkërive, sipas të dhënave të Instituteve nacionale të shëndetësisë.



Për të analizuar ADN-në të çdo tumori të keq, shkencëtarët kanë marrë qindra mijëra variacione minimale të cilat kanë të bëjnë me vetëm një “shkronjë” apo nukleotid. Rendi me të cilin në zinxhirin e gjatë të ADN-së ndryshojnë katër “shkronja” (G për guaninë, A për adeninë, C për citozinë, T për timidinë) përcakton programin gjenetik.

“Analizat të cilat i kanë bërë shkencëtarët japin pamje pa presedan të gjenomit të kancerit të mushkërive”, ka thënë Matthew Meyerson, njëri nga autorët e studimit nga Broad Instituti i lidhur me Universitetin amerikan Harvard.

Meyerson është i bindur se identifikimi i 57 alterimeve gjenetike të cilat shpesh janë hasur te pacientët e sëmurë nga kanceri i mushkërive do të mundësojë “përpunimin e strategjisë së re për diagnostifikim të kancerit



dhe për mjekimin e tij”.

Më shumë se 40 alteracione janë të ndërlidhura me gjenet të cilat deri tani nuk kanë qenë të ndërlidhur me adenokarcinomet. Kanceri i mushkërive, sikur edhe pjesa më e madhe e tipave të kancerëve, del nga ndryshimi i ADN-së të ndonjë personi gjatë jetës së tij, por “natyra e atyre ndryshimeve dhe pasojat biologjike edhe më tej mbeten kryesisht të panjohura”, theksojnë Institutet nacionale të shëndetësisë.

Francis Collins, drejtor i Institutit amerikan për hulumtim të gjenomit njerëzor, pohon se zbulimi i publikuar në revistën *Nature* “do të shkojë edhe më tej se kanceri i mushkërive dhe përmend se numër të madh të gjeneve të ndërlidhur me kancerin akoma duhet zbuluar”.

“Harta gjenome e kancerit na jep përshkrim sistematik të kësaj sëmundje të keqe, vërteton gjërat që i dimë, por thekson edhe të panjohura të shumta”, ka vlerësuar Eric Lander, autori i dytë i studimit.

Kanceri i mushkërive është shkaktar i vdekshmërisë nga kanceri për më shumë se një milionë vdekje në botë.

Përgatiti: Jusuf SALIU

Rritja e nivelit të detit kërcënim për bregun afrikan

Infrastrukturës së bregut afrikan i kërcënohet rreziku gjithnjë e më i madh nga erozioni për shkak të rritjes së nivelit të detit shkaktuar nga ndryshimi i klimës, ka tërhequr vërejtjen udhëheqësi i Programit për mjedisin jetësor të Kombeve të Bashkuara.

Achim Steiner, drejtor ekzekutiv i UNEP-it, në një konferencë për shtyp në Johannesburg ka thënë se makinat e porteve, rafineritë dhe pronat private janë të rrezikuara nga ngrohja globale.

“Disa projeksione të IPCC-së (Grupi ndërqeveritar për ndryshime klimatike) flasin se ngrohja globale mund të godasë një të tretën e infrastrukturës së bregut afrikan deri në fund të shekullit, sepse e dimë se niveli i detit ngrihet ndërmjet 20 dhe 60 centimetra në këtë shekull”, ka thënë Steiner.

IPCC-ja në vitin 2007 ka prezantuar raportin me të cilin ka treguar se aktivitetet njerëzore janë fajtores për ngrohjen globale, si dhe ka nxjerrë vlerësimet për ardhmërinë.

Nëse bota nuk arrin të ndalë ngrohjen globale,



shkencëtarët tërheqin vërejtjen se dëmet më të mëdha do t'i pësojë Afrika.

Pjesë të Afrikës më janë bërë të pavolitshme për bujqësi dhe jetesë.

Më tej, ndryshimet klimatike në Afrikë do t'i përkeqësojnë thatësitë, e njëkohësisht do të shkaktojnë vërshime në bregdet, ka prognozuar këshilltari shkencor i qeverisë britanike David King.

King ka vlerësuar se deri në vitin 2080 uria do të përfshijë edhe 70 milionë afrikanë si rezultat i ngrohjes globale.

Në Johannesburg Steiner ka tërhequr vërejtjen se ekspertët vështirë mund të përcjellin se si me të vërtetë ngrohja globale

mbahet në Afrikë, sepse ai kontinent edhe “nuk e di se çfarë po ndodh në mjedisin e tij”.

“Shumë qytete afrikane nuk kanë instrumente për matjen e ndyrësirave”, u tha në Johannesburg.

Organizata botërore meteorologjike ka konstatuar se Afrika ka një të tetën e infrastrukturës kritike minimale të nevojshme për përcjelljen e klimës.

Vaksinat e kontaminuara tërhiqen nga përdorimi


Rreth 1,2 milion doza të vaksinave për foshnje të tërhequra nga përdorimi në SHBA për shkak të kontaminimit. Bëhet fjalë për vaksinën Hib kundër bakteries e cila mund të shkaktojë meningjitis, ndezje të mushkërive dhe infektim të ngjashme, gjegjësisht për vaksinën e kombinuar kundër Hib-it dhe hepatitis B. Këto vakcina u jepen fëmijëve pasi të kenë mbushur dy muaj.

Prodhuesi i vaksinës, Merck&Co. ka paralajmëruar tërheqjen e vaksinave pasi është vërejtur kontaminimi në fabrikën në Pennsylvania. Tani për tani nuk dihet nëse vakcina është e kontaminuar me bakterie apo virus.

Edhe pse përgjegjësit thonë se nuk ka vend për panik, ata pranojnë se infektimet e fëmijëve të cilët kanë pranuar prej këtyre vaksinave janë të mundshme.

Prindërit këshillohen që gjithsesi të konsultohen me mjekët.

Prodhuesi Merck&Co. gjatë vitit 2004 e kishte patjetër të tërheqë nga tregu ilaçin kundër dhembjeve Vioxx, pasi që ishte zbuluar se ai ilaç e shton rrezikun për infarktin e zemrës dhe goditjen në tru. Kompania pati sukses të arrijë marrëveshjen sipas të cilës me 4,85 miliardë dollarë pagoi 50.000 paditë që ishin ngritur për shkak të ilaçit Vioxx.



Fujimori u dënua me gjashtë vjet burg

Kryetari i dikurshëm peruan Alberto Fujimori u dënua me gjashtë vjet burg për arsye se në vitin 2000 kishte miratuar kërkimin ilegal në banesën e këshilltarit të dikurshëm për siguri, Vlladimir Montesinos.

Ky është dënimi i parë shqiptuar Fujimorit i cili ka 69 vjet, ndërsa u ekstradua nga Çile në muajin shtator dhe e presin disa padi në gjyqet peruane.

Mund të ankohet edhe kryetari i dikurshëm i cili në atë funksion ka qenë prej vitit 1990 deri më 2000, ka nënshtetësi japoneze dhe peruane, kurse mundet edhe prokurori shtetëror i cili ka kërkuar dënim me burg prej shtatë vjetësh.

Aktgjykimi nga Fujimori kërkon që shtetit peruan t'i paguajë 130 mijë dollarë, kurse dy vjet nuk guxon të kryejë kurrfarë funksioni shtetëror.

Përderisa dëgjonte leximin tre orësh të aktgjykimit, Fujimori linte përshtypje si i qetë, në momente edhe si i përgjumur.

Gjykatësi e shpalli fajtor, sepse i nxiste të tjerët në keqpërdorimin e funksionit, pse kishte urdhëruar kërkimet edhe pse nuk guxonte ta bëjë atë dhe përmes prokurorit të rrejshëm ka dëshiruar që ta shfaq si legal.

Në mëngjesin e hershëm të 7 nëntorit të vitit 2000 përderisa Montesinos ishte jashtë, policët me prokurorin e rrejshëm hynë në banesë në Lima, e cila i takon këshilltarit të ish-kryetarit dhe prej atje me kërkim ilegal gjetën dhe morën gjësende dhe dokumente.



Parashkollorët japonezë gjithnjë e më shumë luajnë lojëra kompjuterike

Numri i fëmijëve japonezë të moshës parashkollore të cilët rregullisht luajnë lojëra kompjuterike vitin

e kaluar është dyfishuar, ka treguar hulumtimi i bërë nga Ministria japoneze e shëndetësisë.

Sipas hulumtimit të bërë në mostrën prej 218.535 fëmijë, 51 për qind prej tyre rregullisht luajnë me ndihmën e kompjuterit, përderisa në vitin 2005 ai numër ishte 28 për qind.

Shkencëtarët thonë se për rezultat të tillë përgjegjës është ndikimi i moshatarëve, shikimi i shpeshtuar i programeve televizive dhe fakti se nënat duhet shkuar në punë dhe se fëmijët i ruajnë farefisët apo dadot.



Përgatiti: Fevzi MUSLIU



Rrahman B. FERIZI

EZANI

Pranë bregdetit të trazuar
Shpërthen si vullkan i ndjenjave
Dridh si tërmeti imanin e zgjuar
Si himni i marsheve para betejave

Ezani, shakullinë e shpirtit altruist

Habinë monotone, dinamikën e azdisur
Ndalë orën e kohës në oazë amshimi
Refreni i tij drejt qiellit të harlisur
Pushon shpirtin si rimë bilbili

Ezani, valë e zemrës me besim

Kur hutohemi nga bota, sfidat e saj
Fton të kthehemi në përkushtim
Na ndriçon rrugën drejt idealit të lartë
Pluhurin e injorancës nga zemra e fshinë

Ezani, simfoni e shpirti fisnik

Në katër anët e Tokës gufon zëri i tij
Pandërprerë, qetë tronditë injorancën
Thërret t'i përkulemi Madhështisë së Tij
Miraxhit ditor pedestalit të largët

Ezani, madhështi plot urtësi-trumbetim

Himn i ushtrisë së besimit
Thirrje për nënshtrim pa hezitim
Dëlirësi e shpirtit me ujin e pendimit
A ka madhështi më me simbolikë

Ezani trumbetë për amshim

Stamboll, 2007